



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIC OF KOSOVA-
KOMUNA E FERIZAJT • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN

2021

TABELA E PËRMBAJTJES:

- Fjala e Kryetarit të Komunës.....fq.02-03
- 01 Zyra e Kryetarit të Komunës.....fq.04-37
- 02 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.....fq.38-47
- 03 Drejtoria e Financave.....fq.48-69
- 04 Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.....fq.70-75
- 05 Drejtoria e Infrastrukturës.....fq.76-82
- 06 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.....fq.83-87
- 07 Drejtoria e Arsimit.....fq.88-98
- 08 Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....fq.99-120
- 09 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....fq.121-202
- 10 Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastritfq.203-214
- 11 Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.....fq.215-222
- 12 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.....fq.223-238

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Viti 2021, ishte vit ku kulmuan sukseset e qeverisjes sonë 4 vjeçare, me vepra madhore publike të cilat tashmë i gëzojnë bashkëqytetarët tanë. Ndonëse, vit me vështirësitë e përcjellura nga pandemia COVID-19, megjithatë, ishte dashuria për qytetin, vullneti e pasioni për më të mirën për Ferizajin e ferizajasit, që na bëri të shënojmë rezultate të çdoditshme në punën tonë.

Ferizaj i vitit 2021, është fare larg nga Ferizaj i viteve të mëparshme në pikëpamje të ndryshimeve pozitive, kjo si rezultat i ritmit të lartë të punës dhe përkushtimit për transformimin tërësor të qytetit e fshatrave tona. Janë projekte të panumërta, realizimi i së cilave, i ka dhënë cilësi të re jete e shërbimi, bashkëqytetarëve tanë.

Edhe në pikëpamje të investimeve publike, ndonëse pandemia prodhoi vështirësi të caktuara, shënuam suksese domethënëse siç do të rendisim shkurtimisht më poshtë.

Përfunduam rregullimin e rrugës me tre shirita qarkullimi dhe rindërtuam trotuarin në rrugën “Ramadan Rexhepi”, përfunduam punët në rregullimin e rrethrotullimit që lidh rrugët “Ramadan Rexhepi” (te Cosmo) me rrugën “Bifurkacioni”, përfunduam projektin unik të ndërtimit të nënkalimit për vetura dhe këmbësorë tek Plus Marketi, përruam kryeveprën infrastrukturore e identitare të Ferizajt – nënkalimin për vetura dhe këmbësorë “Bashkimi i Qytetit”, intensifikuam punimet në rregullimin e shëtitorës mbi nënkalimin kryesor të qytetit, përfunduam punimet në vazhdimin e nënkalimit për këmbësorë me dalje në rrugën “Emin Duraku”, përfunduam parkingun nëntokësor në qendër të qytetit me kapacitet prej afro 200 vendparkingje, nisëm dhe avancoam në stad përfundimtar në ndërtimin e nënkalimit në Nikadin, nisëm punimet në projektin madhor infrastrukturor, atë të rregullimit të vijës rrugore 5.6 kilometërshe me 4 korsi nga Fshati i Vjetër deri në Prelez të Jerlive dhe rikonstruktimin e urës në Bibaj – investim 13.4 milionë euro, nisëm së zbatuari projektin për ndërtimin e Bulevardit të Ri të Qytetit në rrugën “Agim Ramadani”, kryem punimet në asfaltimin e një nga arterieve kryesore rrugore në qytet, rruga “Cen Dugolli”, investuam rreth 700,000.00€ për ndërtimin e mbi 50 kilometrave rrjet të ujësjellësit për fshatrat Sojevë, Dardani, Zllatar, nisëm punët fillestare për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza – projekt prej 40 milionësh euro, përfunduam punimet në objektin e Fabrikës së Ujit në Talinoc të Muhaxherëve, avancoam punimet në ndërtimin e Stacionit të Ri të Autobusëve në Ferizaj, avancoam punimet në ndërtimin e objektit të ri të KRM “Pastërtia”, asfaltuam rrugën kryesore dhe rrugicat në Kompleksin e Varrezave të Reja të Qytetit, riparuam në tërësi gjithë vijën rrugore të rrugës “12 Qershori” në qendër të qytetit, u asfaltua segmenti rrugor Bablak-Babush një pritje e kërkesë e gjatë e banorëve, rregulluam trotuarin 4 kilometërsh në Mirosalë, nisëm projektin për hapjen e pusit të ri në Kosinë me qëllim të furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm, vendosëm sinjalistikë moderne rrugore për të rritur sigurinë në trafik, vendosëm pritoret në disa rrugë të qytetit dhe fshatrave, asfaltuam rrugë dhe rregulluam trotuare në të gjitha fshatrat dhe zonat e qytetit, trotuaret ia kthyem qytetarëve përmes pengesave që vendosëm, në bashkëpunim me organizatën “Qatar Charity” nisëm dhe e përfunduam ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Softaj, nisëm ndërtimin e shtëpive të reja dhe krijuam zgjidhje banimi për 50 familje në nevojë në Ferizaj,

ndihmuam veçanërisht 25 biznese të udhëhequra nga gratë, përmes programit “Gratë ndërmarrëse në Energji” në bashkëpunim me organizatën “HELP” dhe dhjetëra biznese tjera prodhuese përmes skemës së mbështetjes nga Fondi i Punësimit, për Parkun e Pishave në Rahovicë-Mirosalë, nënshkruam Memorandumin për ta kompletuar me këndë lojërash, shtigje ecje, fusha sportive e shporta mbeturinash, investuam në kënde lojërash e rekreacioni për fëmijët dhe të rinjtë, mbollëm drunj dekorativ e lule për t’i dhënë pamjen e merituar panoramës së Ferizajt, nisëm punimet për rregullimin e Qendrës së Trajtimit të Qenve Endacak dhe Tregut të Kafshëve, ndihmuam bujqit dhe fermerët me makineri, pajisje pune e subvencionime të shumta të veprimtarisë së tyre, përfituam shkollën përballë Stacionit të Ri të Autobusëve, investim mbi 3 milionë euro nga Bashkimi Evropian, nisëm ndërtimin e shkollës së re moderne në Neredime të Epërme, nisëm punimet për ndërtimin e Sallës së Sporteve në Fshat të Vjetër, të parët në të gjithë Republikën krijuam dhe lansuam Ditarin Digjital Shkollor, ndamë bursa për të gjithë studentët që aplikuan në konkursin vjetor të bursave për studentë, avancuam punimet në ndërtimin e shkollave në Talinoc të Muhaxherëve dhe Zaskok, avancuam punimet në ndërtimin e Qendrës së Sporteve dhe Panairëve në Greme, rregulluam fushën sportive model në Lloshkobare, përruam pikën 1 në Parkun Memorial të UÇK-së më Jezerc, intensifikuam punimet në ndërtimin e Pallatit të Kulturës, përfunduam punimet në ndërtimin e terrenit sportiv në Pleshinë, bashkërenduam forcat me FFK-në për nisjen e ndërtimit të fushës ndihmëse të futbollit, ishim pranë me punë e projekte, pranë të vegjëleve, të rinjve, të moshuarve e qytetarëve të çdo moshe e profesioni, për më të mirën për Ferizajn e ferizajasit.

Nga sa më sipër, të përmbledhura shkurtazi, Ferizaj edhe në vitin 2021, përjetoi investime si asnjëherë më parë, vizion e vullnet që karakterizon punën tonë të përditshme për Ferizajn siç e meritojnë ferizajasit.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Agim Aliu

Kryetar i Komunës së Ferizajt



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA LIGJORE

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2021

Për periudhën kohore 04.01.2021 e deri më 31.12.2021, Zyra Ligjore ka kryer punët si në vijim:

1. Janë pranuar dhe evidentuar si kërkesa nëpërmjet zyrës pritëse 611 lëndë të qytetarëve të cilat janë drejtuar Kabinetin të Kryetarit, të cilat janë proceduar.
2. Janë mbajtur gjithsej 831seanca në çështje kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë, Gjykatën Themelore në Prishtinë - Divizioni për Konteste Administrative.
3. Janë ushtruar 93 ankesa kundër aktvendimeve – aktgjykimeve për shkallën e dytë të gjykatës kompetente.
4. Janë ushtruar 10 prapësime për përmbarrim në gjykatën përmbarrimore.
5. Janë ushtruar 1008 përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Ferizaj.
6. Janë përgatitur gjithsej 611 shkresa të ndryshme (vendime, njoftime, formime të komisioneve të ndryshme që kanë rrjedhë nga Kabineti i Kryetarit).
7. Janë pranuar dhe janë shqyrtuar me vendim gjithsej 807 kërkesa të ndryshme zyrtare. Për detyrimet kontingjente është raportuar në Drejtorinë e Financave.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKI

Shënim: Niveli i 2021 është raport i parësor dhe mund të ndryshojë nëse do të ktheheshin të dhënat nga kompanitë kontraktuese.

Data e përgatitjes së raportit: 30.12.2021

Viti i referencës: 2021

PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri i autorit Kontraktues	Komuna Ferizaj	Komunë
Liqi i Autorit Kontraktues (logotipa dhe/ose)	Kompani Publike	
Kodi buxhetor	656	
Adresa	Rr. "Dëshmorët e Kombit"	
Kodi postar - Qyteti	70000	
Tel./fax/Celulari/Faksi	038/200-46045	
Emili menaxherit të prokurimit	z. Ardit Azemi	
E-mail adresa	postapublike@kz-ferizaj.com	
Adresa e vëllit të AK	www.kz-ferizaj.com	

PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Lloji i Buxhetit	Lloji i Prokurimit					7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24		
	1	2	3	4	5																				
Buxheti i shtetit	Tirimi i aktivitetit të prokurimit																								
	001	1	2	1	50	Furnizim me material mjekësorë për periudhën tre vjeçare për QKMF-në	29.03.2020	11.11.2020	25.01.2021	26.07.2021	31.05.2021 27.05.2023	Në realizim	180.000.00	180.121.48					N.SHT "MADE-KOS"	1	34	6	0	1	1
	002	2	1	1	93	Sigurimi i llojit të Komunitetit dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në Kuadër të Komunitetit të Ferizajt	09.12.2020	11.12.2020	25.01.2021	27.01.2021	31.05.2021 27.05.2024	Në realizim	180.000.00	147.626.50					"SKY FTERAJT-LIVE" SH.P.K	1	18	1	0	2	1
	003	2	1	1	93	Dikualifikimi i të dhënave shkollore dhe ditari shkollor	25.03.2020	02.10.2020	26.01.2021	27.01.2021	30.07.2021 30.07.2022	Në realizim	130.000.00	125.375.00					"Data-Pog" Një SH.P.K	1	68	6	1	2	1
	004	1	2	1	18	Furnizim me uniforma për personelin e QKMF-së	23.11.2020	16.12.2020	28.01.2021	29.01.2021	30.07.2021 06.08.2021	05.08.2021	1985.00	1985.00					"Sankos" Sh.p.k	1	26	6	0	2	1
	005	2	1	1	93	Harmoni i projekteve deriale - projekt dy vjeçar, Objekti LOT1	23.03.2020	30.03.2020	28.01.2021	29.01.2021	30.04.2021 31.05.2021	31.05.2021	1339.419.50					PRIO-ART-ING" SH.P.K	1	58	9	1	1	1	
	006	1	2	1	28	Furnizimi me materiale për aktivitetet kulturore dhe sportive	15.10.2020	10.11.2020	02.02.2021	03.02.2021	30.04.2021 03.08.2021	27.05.2021	110.000.00	17.175.00					N.P SH "Star Graf"	1	26	6	0	1	1
007	1	2	1	30	Vendosja e kamerave në QKMF, QKMF 1, QKMF 2, QKMF 3, QKMF 4, QKMF 5, QKMF 6, QKMF 7, QKMF 8, si dhe në njësi tjera të QKMF-së	03.03.2020	07.10.2020	02.02.2021	03.02.2021	29.04.2021 28.04.2023	Në realizim	180.000.00	188.796.50					"Syni Shqiponjës" Sh.p.k	1	41	8	0	1	1	

008	1	4	7	1	Vlerë Minimale - Furnizim me tonerë (ingjira për printer) për nevojat e Administratës Komunalë, Shkollave, QJmë, Bc dhe QPS në Ferizaj	27.01.2021	/	/	10.02.2021	29.04.2021 28.04.2022	Ne realizim	110,000.00	19,955.00					1	3	3	0	1	1		N.P "Rilinda Comercio"
009	2	1	1	93	Pastimi dhe mirëmbajtja teknike e objekteve të Komunitetit Ferizaj dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunitetit Ferizaj	17.11.2020	04.12.2020	11.02.2021	12.02.2021	29.04.2021 12.05.2021	12.05.2021	139,955.60						1	37	3	1	2	1		"SKYFERRAT-LINE" SH.P.K
010	2	3	6	93	Shërbime artistike për realizimin e manifestimit nacional kulturor "17 Shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës 2021"	18.01.2021	22.01.2021	15.02.2021	16.02.2021	29.01.2021 29.03.2021	29.03.2021	112,000.00	110,829.00					1	25	2	0	1	1		"AMC CORPORATION" SH.P.K
011	2	3	7	1	Vlerë Minimale - Montimi i aparatëve për akses-kontrol me kartel, si dhe instalimin, konfigurimin dhe regjistrimin e personelit në QJ/KF.	15.01.2021	/	/	16.02.2021	29.01.2021 29.01.2023	Ne realizim	1160,000.00	184,871.00					1	3	3	0	1	1		"N.P.SH" Eling-Electronics"
012	2	1	1	93	Riparimi i trotuarëve me kubeta	18.11.2020	02.12.2020	23.02.2021	01.03.2021	28.07.2021 16.08.2021	12.08.2021	111,000.00	1990.00					1	56	7	0	1	1		"Compania Eshtarcon" SH.P.K & "Best Company" SH.P.K
013	2	3	6	93	Barja e ndërësive me nevojat e vegjantë në relacionin Ferizaj - Fushinë dhe anasjelltas për çdo ditë të punës në vitin kalendarak	22.01.2021	27.01.2021	23.02.2021	01.03.2021	28.07.2021 10.08.2021	01.03.2021	11,000.00	1990.00					1	13	1	0	1	1		"MINIBUS XHAHUT OSMANI"
014	5	2	1	45	Zgjedhimi i rugës "Fletëpër Blatini" prej metali dhe të luthë - projekt dhe veçor	14.10.2020	03.11.2020	02.03.2021	03.03.2021	28.05.2021 28.07.2021	20.08.2021	1220,000.00	1219,953.33					1	35	2	0	1	1		"Company Mursel" SH.P.K
015	5	2	1	45	Rregullimi i Kanalizimit në Ishtrim Zaštok dhe Adalimi i rrugës në Doganaj	11.02.2021	23.02.2021	16.03.2021	17.03.2021	28.05.2021 04.06.2021	09.06.2021	1995.00	1985.50					1	50	1	0	2	1		"E.Dm" SH.P.K & "APLINDI" SH.P.K & "Intra-Plus"
016	2	3	7	1	Vlerë Minimale - Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve të Komunitetit Ferizaj	25.01.2021	/	/	19.03.2021	28.05.2021 03.06.2021	28.05.2021	1500.00	1495.00					1	3	3	0	1	1		"Mind E Beutisha Bll"
017	2	1	1	93	Trajtimi i qenve endacak	08.02.2021	10.02.2021	11.03.2021	22.03.2021	27.07.2021 25.08.2021	25.08.2021	136,852.72						1	29	1	0	2	1		"Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Gori"
018	1	4	7	1	Vlerë Minimale - Furnizim me makinë për numërim të monedhave, detektim dhe material shpërzues	18.02.2021	/	/	08.03.2021	27.07.2021 03.08.2021	05.08.2021	1990.00	1990.00					1	3	3	0	1	1		N.T "Rilinda Comercio"
019	5	2	5	45	Anëks Kontrata - Ndërtimi i Palestrës Sportive - projekt dhe veçor	22.02.2021	/	19.03.2021	22.03.2021	27.07.2021 03.08.2021	05.08.2021	1990.00	125,733.60					1	8	1	0	1	1		"SHEMA" SH.P.K & "Linda" SH.P.K
020	1	3	6	33	Furnizim me barna mjekësore për Shërbimin e Komunitetit për personat me aftësi kulturore mendore	15.03.2021	19.03.2021	30.03.2021	08.04.2021	27.01.2021 27.01.2022	18.11.2021	1150,000.00	185,432.00					1	12	1	0	1	1		"Egada Bakoll Bll"
021	5	2	1	45	Ndërtimi i sallës sportive në Fshatin e Vjetër Elbas	05.10.2020	06.11.2020	30.03.2021	08.04.2021	27.01.2021 26.01.2022	28.01.2022	1340,000.00	1340,000.00					1	81	5	0	2	1		N.P.P "ATC COM" SH.P.K
022	1	3	6	31	Furnizim me generator industrial për objektet e Dejtosisë së Arsimit në Ferizaj	22.01.2021	24.02.2021	30.03.2021	12.04.2021	26.07.2021 26.07.2024	Ne realizim	1150,000.00	1113,320.00					1	27	6	0	1	1		"Eco Group" SH.P.K

022	1	3	6	31	Functim me generator industrial per objektin e Djeprorje se Azimi ne Fetzaj	22.01.2021	24.02.2021	30.03.2021	12.04.2021	26.07.2021 26.07.2024	Ne realizim	1'50,000.00	1'10,320.00						1	27	6	0	1	1
023	1	4	7	1	Vlere Minmale - Functim me dokumentacion mjedisor per QKMF	15.03.2021	/	/	16.04.2021	26.01.2021 26.01.2024	Ne realizim	1'07,000.00	188,753.60						1	3	3	0	1	1
024	2	2	1	28	Mirëmbajtja e kontenerëve nëntokësorë	24.02.2021	04.03.2021	21.04.2021	23.04.2021	24.06.2021 24.06.2024	Ne realizim	1'230,000.00	1'69,897.25						1	14	1	0	1	1
025	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - Ndërtimi i kolektorit vertikal për përshprirje në kanalim të Ishariave Koshare, Shirove dhe Kosinë - projekt tre vjeçar	25.03.2021	/	20.04.2021	29.04.2021	24.05.2021 20.05.2024	Ne realizim	1'130,000.00	126,641.00	139,965.60					1	7	1	0	1	1
026	5	2	1	45	Ndërtimi i rruarut në Isharin Doganaj - projekt dy vjeçar	05.06.2020	03.03.2020	14.04.2021	29.04.2021	24.05.2021 03.06.2021	03.06.2021	177,726.95							1	60	12	0	1	1
027	1	2	1	18	Functim me veshtirësi për punëtorët vullnetarë të EZ-së	02.03.2021	15.03.2021	22.04.2021	30.04.2021	23.07.2021 23.07.2022	Ne realizim	1'15,535.00	12,040.00						1	23	3	0	1	1
028	1	4	7	1	Vlere Minmale - Ngjyra për printer për Qendrën për Punë Sociale - Fetzaj	02.03.2021	/	/	05.05.2021	22.06.2021 30.06.2021	29.06.2021	1'995.00							1	3	3	0	1	1
029	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - Bashkimi Qytet - projekt dy vjeçar	06.04.2021	/	29.04.2021	30.04.2021	22.06.2021 22.08.2021	16.06.2021	1'14,000.00	13,946.00	139,499.50					1	13	1	0	1	1
030	5	2	1	45	Rregullimi i rrugave të kalshëve dhe ndërtimi i strehimore për qerret endacak - projekt tre vjeçar	15.09.2021	25.09.2020	29.04.2021	06.05.2021	22.03.2021 22.01.2022	Ne realizim	1'90,000.00	189,960.00						1	84	11	1	1	1
031	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - LOT II - Ndërtimi i nënkallmit për rrugën "Ferri Agani" dhe në rrugën "Liman Roka" - projekt dy vjeçar	06.04.2021	/	06.05.2021	11.05.2021	22.03.2021 12.04.2021	12.04.2021	125,733.60	172,303.76						1	5	1	0	1	1
032	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - Asfaltimi i rrugës Soljeve - Miroslav - Pojale - Sotiaj - projekt tre vjeçar	14.04.2021	/	06.05.2021	11.05.2021	21.05.2021 20.07.2021	05.06.2021	183,443.75	182,000.00	178,143.51					1	7	1	0	1	1
033	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - LOT I - Ndërtimi i nënkallmit në Isharin Varosh - projekt dy vjeçar	06.04.2021	/	06.05.2021	11.05.2021	20.06.2021 20.09.2021	20.09.2021	192,972.06	174,604.52						1	9	1	0	1	1
034	1	2	1	31	Pjesëmarrje në ngjarje dhe zhvillim të Buresëve	19.10.2020	18.02.2021	20.05.2021	21.05.2021	19.03.2021 19.04.2021	16.04.2021	1'100.00	1970.10						1	39	4	0	1	1
035	5	2	5	45	Aneks Kontrakt - Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe asfaltimi i rrugave në qytet - faza II	27.04.2021	/	21.05.2021	24.05.2021	17.03.2021 17.03.2024	Ne realizim	1'200,000.00	1'58,968.08	177,726.95					1	6	1	0	1	1
036	5	2	1	45	Ndërtimi i murave mbrojtëse në Ish. Gjene, Gaspë dhe ndërtimi i rrugave të ujërave në Ish. Balaj - projekt tre vjeçar	08.03.2021	19.03.2021	20.05.2021	24.05.2021	16.06.2021 16.08.2023	Ne realizim	1'75,000.00	175,000.00						1	61	4	1	1	1
037	1	4	7	29	Vlere Minmale - Functim dhe vendosja e Kemerave Vëzhgues për Shërbim e Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara Mëdore në Fetzaj	07.04.2021	/	/	28.05.2021	16.07.2021 19.09.2021	Eshtë zgatur afat deri më 30.05.2022		1'14,754.00						1	3	3	0	1	1

038	5	2	5	45	Regullimi i kanalizimit në Ishatin Kosinë	12.05.2021	/	27.05.2021	28.05.2021	16.04.2021 24.04.2021	16.04.2021	11,000.00	1990.00					Linda	1	12	1	0	1	1
039	2	4	7	1	Vlera Minimale - Transportimi me autobus i punëtorëve të Komunës së Fierçajt	17.05.2021	/	/	28.05.2021	16.02.2021 26.02.2021	16.02.2021	1500.00	1450.00					'Ardit Tours' SH.P.K	1	3	3	0	1	1
040	5	2	1	45	Asfaltimi i rrugëve në Ishatin Mirath - projekt dy vjeçar	19.02.2021	23.02.2021	27.05.2021	31.06.2021	16.02.2021 20.02.2021	17.02.2021	19,000.00	17,990.00					'GËRLICA - COMPANY" SH.P.K	1	44	10	1	1	1
041	5	2	1	45	Regullimi i trashëgimisë në muzeun kryesor në Ishatin Mossaj dhe rrugëve në ish. Dardania - projekt tre vjeçar	16.02.2021	23.02.2021	27.05.2021	31.05.2021	15.07.2021 15.12.2021	07.12.2021	146,666.67	1205,930.00					'GËRLICA - COMPANY" SH.P.K	1	54	7	0	1	1
042	5	1	1	45	Asfaltimi i rrugës kryesore me trotuar dhe i rrugëve në Ishatin Derrallë - projekt dy vjeçar	19.02.2021	24.02.2021	27.05.2021	03.06.2021	15.07.2021 15.07.2022	Në realizim	12,500.00	11,467.00					'Kema - Company" Sh.p.k	1	56	17	0	2	1
043	1	4	7		Vlera Minimale - Furnizimi me material hulumtar për IP "Ardmëria Jonë"	19.05.2021	/	/	04.06.2021	14.07.2021 14.10.2021	30.09.2021	100,000.00	188,200.00					N.T.P."Lorena"	1	3	3	0	1	1
044	2	4	7	93	Vlera Minimale - Regjistrimi i automjeteve të Komunës së Fierçajt	27.05.2021	/	/	04.06.2021	14.06.2021 21.06.2021	21.06.2021	11,000.00	1973.00					'SIGMA INTERALBAMIANI VIENNA INSURANCE GROUP" S.H.A.	1	3	3	0	1	1
045	1	4	7	36	Vlera Minimale - Furnizimi me dokumentacion administrativ	27.05.2021	/	/	07.06.2021	13.07.2021 20.07.2021	15.07.2021	11,000.00	1990.00					'INTERGRAF" L.L.C.	1	3	3	0	1	1
046	2	4	7	93	Vlera minimale - Mienbajtja e Autoambulancës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare	23.02.2021	/	/	14.06.2021	13.07.2021 13.08.2021	13.08.2021	134,800.00						'DASHIMI" SH.P.K	1	3	3	0	1	1
047	2	2	1	93	Manifestimi i Kulturës në Komunën e Fierçajt	23.03.2021	08.04.2021	08.06.2021	09.06.2021	13.07.2021 13.07.2022	Në realizim	121,000.00	120,530.60					'Asmit B. Mustafa B.I"	1	20	3	0	2	1
048	2	2	1	1	Rregullimi i gjedhëve llojëvë të quajshmit mëshkierave dhe vëgjetës	23.03.2021	30.03.2021	11.06.2021	22.06.2021	12.08.2021 12.08.2024	Në realizim	1750,000.00	1750,000.00					'Diton S. Sylejmani B.I" & N.S.H Ambulanca Veterinare "INDRIT"	1	9	1	0	1	1
049	2	4	7	72	Vlera Minimale - Implementimi i dashboard-it interaktiv të Power BI	26.05.2021	/	/	22.06.2021	12.07.2021 12.10.2021	08.10.2021	160,000.00	158,000.00					'BIDARAJAB" L.L.C	1	3	3	0	1	1
050	5	2	1	45	Asfaltimi i rrugëve në Rahovë dhe Tahirio në Muharrehë - projekt tre vjeçar	04.03.2021	09.03.2021	06.05.2021	24.06.2021	12.07.2021 12.08.2021	16.08.2021	110,000.00	19,984.00					'GËRLICA-COMPANY" SH.P.K	1	42	14	0	1	1
051	5	2	1	45	Ndërtimi i infrastrukturës në zona turistike - Parku i Pishave	13.04.2021	19.04.2021	30.06.2021	01.07.2021	12.07.2021 12.08.2021	10.08.2021	110,000.00	19,991.00					'Beisha Company" S.H.A	1	54	10	3	1	1
052	5	2	1	45	Ndërtimi i laborave për prirje të udhëtarëve në vendqëndrimet e autobusëve	02.03.2021	05.05.2021	30.06.2021	01.07.2021	12.07.2021 12.07.2024	Në realizim	155,000.00	199,996.00					N.T.P."AR-SIMI"	1	53	10	0	1	1
053	5	2	1	45	Ndërtimi i konstruksioneve për vendosjen e hidrantëve	02.03.2021	12.04.2021	30.06.2021	02.07.2021	12.07.2021 12.07.2023	Në realizim	112,000.00	11,998.80					'Beisha Company" S.H.A	1	46	3	1	1	1

083	1	4	7	1	Vlere Minimale - Furnizim me lule per kabine dhe Kuyetait	27.07.2021	/	/	30.07.2021	02.07.2021 02.09.2021	02.09.2021	15,000.00	113,387.00				"IDEAL" SH.P.K	1	3	3	0	1	1
084	5	2	1	45	Ndërtimi i fushave të ping pongut dhe tabelave të shikut	04.02.2021		23.07.2021	02.08.2021	01.07.2021 01.10.2021	29.09.2021	125,000.00	116,340.00				"TANDEM CO" SH.P.K & "Linda"	1	40	4	0	1	1
085	2	1	1	14	Shtuaja e ngrënie me zhavor - hapja e ngrënie të reja dhe ngrënie të arave me zhavor - LOT I - Shtuaja e ngrënie me zhavor - Hapja e ngrënie të reja	24.05.2021	02.06.2021	11.08.2021	12.08.2021	01.07.2021 01.09.2021	01.07.2021 01.09.2021	175,553.40	164,236.40				"ARLIND" SH.P.K & "Hira-Plus" SH.P.K	1	70	6	2	2	1
086	2	2	1	90	Mëmbajtja e lumënieve, kanaleve - eliminimi i vërshimeve	24.02.2021	19.03.2021	13.08.2021	16.08.2021	01.03.2021 01.03.2024	Në realizim	1250,000.00	250,000.00				"Berisha Company" SH.A	1	45	13	1	1	1
087	5	2	5	45	Anëks Kontrast - Infrastrukturë rëndësore dhe asfaltimi i rrugëve të mbetura në qytet - projekt dy vijëqar LOT I - Rrugë për pjesa lindore nga hekurudha	15.06.2021	/	19.08.2021	20.08.2021	01.03.2021 01.03.2022	Në realizim	16,000.00	17,920.00	192,972.08			"Bujar Shaban" EIT	1	8	1	0	1	1
088	2	2	1	24	Shtetë me zerrim, zerrim ndiqim dhe LED	12.07.2021	27.07.2021	24.08.2021	25.08.2021	25.08.2021 25.08.2024	Në realizim	160,000.00	141,360.00				"GRAMOFON" SH.P.K	1	20	4	2	2	1
089	5	2	5	45	Anëks Kontrast - Infrastrukturë rëndësore dhe asfaltimi i rrugëve të mbetura në qytet - projekt dy vijëqar LOT II - Rrugë për pjesa perendimore nga hekurudha	15.06.2021	/	24.08.2021	24.08.2021	24.08.2021 25.09.2021	08.09.2021	167,987.80	167,987.80				"Rakovica Comercio" SH.P.K	1	70	1	0	1	1
090	5	2	5	45	Anëks Kontrast - Asfaltimi i rrugëve që lëshojnë dritë në lagjen Spahiaj në Gjene dhe rrugëve të mbetura në lagjen Gjene - projekt tre vijëqar	09.07.2021	/	24.08.2021	25.08.2021	25.08.2021 25.09.2021	25.09.2021	154,333.41	154,333.41				"Quality Asphalt" SH.P.K	1	7	1	0	1	1
091	1	3	6	24	Furnizim me material hulumtim në shërbime dhe Komunikat në Ferizaj	29.06.2021	16.07.2021	25.08.2021	26.08.2021	26.08.2021 26.07.2022	Në realizim	15,000.00	14,228.75				"Shap Mustafa" EIT	1	25	4	0	1	1
092	2	2	3	74	Haritimi i projektit Ndërtimi i mobilimit në Ferizaj (për hekurudha - afër stacionit policor në Ferizaj)	16.04.2021	24.05.2021	13.07.2021	01.09.2021	01.09.2021 01.01.2022	01.01.2022	150,000.00	148,888.00				N.P.SH "Hidropojekt"	1	25	2	1	1	1
093	2	2	3	74	Haritimi i projektit Ndërtimi i mobilimit në Ferizaj (për hekurudha - afër stacionit policor në Ferizaj) (të gjitha dytë)	16.04.2021	24.05.2021	13.07.2021	01.09.2021	01.09.2021 16.08.2021	/	13,000.00	13,000.00				"URBAN PRO" SH.P.K	1	1	0	1	1	1
094	2	1	1	14	Shtuaja e ngrënie me zhavor - hapja e ngrënie të reja dhe ngrënie të arave me zhavor - LOT I - Rrugë për pjesa lindore nga hekurudha	24.05.2021	02.06.2021	02.09.2021	03.09.2021	03.09.2021 03.09.2024	Në realizim	1896,274.18	1896,274.18				"Quality Asphalt" SH.P.K & "Hira-Plus" SH.P.K & "Havha Kom" SH.P.K & "N.N.SH" "WORLD MEDIAN"	1	70	3	1	2	1
095	2	2	1	93	Rëndësim - Mëmbajtja dhe shërbime të automjetëve të Komunitetit në Ferizaj	27.05.2021	04.06.2021	08.09.2021	09.09.2021	09.09.2021 09.09.2023	Në realizim	198,000.00	127,294.25				D.P.Z AUTO-INGENIEROSSES "ECLIPS"	1	15	2	0	2	1
096	1	2	1	33	Vendosja e kamerave në qytet - projekt dy vijëqar	16.07.2021	03.08.2021	09.09.2021	14.09.2021	14.09.2021 14.09.2023	Në realizim	140,000.00	138,888.88				"MART Group" SH.P.K	1	30	2	0	1	1

097	5	2	1	45	Përbashkëtim dhe ndërtim i infrastrukturës në zonën turistike	09.07.2021	13.07.2021	15.09.2021	16.09.2021	16.09.2021	16.12.2021	Eshë zgjidhur afat derime 30.07.2022	120,000.00	115,800.00				1	21	4	1	2	1	E-Dm" SH.P.K & "LUNARI COMPANY" SH.P.K
098	5	2	1	45	Ndërtimi i shkollës Korandri Kristofidhi në ish. Verodime, Ferizaj	02.08.2021	24.05.2021	03.09.2021	16.09.2021	16.09.2021	16.09.2024	Në realizim	1340,000.00	1332,525.75				1	85	3	2	1	1	PRG" SH.P.K & "TODESIGN" SH.P.K
099	5	2	5	45	Aneks Kontrate - Përmirësimi i projektit me donator, ulësjellësi në Ishatin Sojeve, Dardani - projekt i tre vjeçar - Komunë e Ferizaj	16.06.2021	/	16.09.2021	16.09.2021	16.09.2021	25.08.2021	24.09.2021	169,130.39		169,130.39			1	1	1	0	1	1	Beisha Company" SH.A
100	1	2	1	1	Subvencionimi i fëmijëve për ngjyjen e pemshive me arra	05.08.2021	10.08.2021	17.09.2021	20.09.2021	20.09.2021	19.11.2021	18.11.2021	120,000.00	112,536.40				1	10	3	0	1	1	"SHEMIFARINA" SH.P.K
101	1	2	1	1	Fundimi i fëmijëve kultivues të grurit me impule bujqësore - pëllë artificial	10.08.2021	11.08.2021	20.09.2021	22.09.2021	22.09.2021	08.10.2021	Kontrata e përfunduar	160,000.00	159,976.00				1	13	1	0	1	1	"Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Gori"
102	1	2	1	28	Montimi dhe furnizimi me vhamë për nevojat e Administratës Komunalet, shkollat dhe institucione tjera vartëse të Komunës së Ferizaj	19.05.2021	10.06.2021	23.09.2021	24.09.2021	24.09.2021	24.09.2023	Në realizim	125,000.00	125,120.00				1	17	2	1	1	1	N.T.P."Velban"
103	5	3	5	45	Aneks Kontrate - Ndërtimi i shkollës fillore në Ishatin Komogllavë - projekt i tre vjeçar	20.08.2021	/	23.09.2021	24.09.2021	24.09.2021	01.10.2021	01.10.2021	14,347.10		14,347.10			1	6	1	0	1	1	N.N.P."Beioni"
104	2	2	1	93	Mirëmbajtja e objekteve Kulturore, Sportive dhe Rinore	20.05.2021	24.06.2021	22.07.2021	30.09.2021	30.09.2021	30.09.2024	Në realizim	100,000.00	100,000.00				1	41	1	0	2	1	N.T.P."Diamant"&N.Sh."Besa"&"ELEKTRO-VALLI" SH.P.K
105	2	3	6	93	Organizimi i trajnimeve për fermerët në lëmi të ndryshme	30.08.2021	15.09.2021	06.10.2021	07.10.2021	07.10.2021	05.01.2022	05.01.2022	19,950.00	19,950.00				1	23	1	0	1	1	Management and Information Technology Consulting MBIT LLC
106	1	3	5	1	Aneks Kontrate - Përbashkëtim dhe fëmijëve me mekanizim bujqësor	12.10.2021	/	13.10.2021	13.10.2021	13.10.2021	14.10.2021	14.10.2021	18,690.00		18,690.00			1	6	1	0	1	1	N.P.T."Havijaka" Sh.p.k
107	1	3	6	24	Fundimi me material hidhënk për nevojat e QKMF-së Ferizaj	03.09.2021	15.09.2021	13.10.2021	14.10.2021	14.10.2021	14.04.2022	Në realizim	16,000.00	12,942.85				1	36	12	1	1	1	"Dauil Komerc" SH.P.K
108	2	3	6	93	Shërbime të Akomodimit dhe fjetjes për rezidentët në Shqipëri dhe Komunën e Ferizaj	23.08.2021	06.10.2021	25.10.2021	25.10.2021	25.10.2021	15.11.2021	03.11.2021	15,500.00	15,257.00				1	10	1	0	1	1	Management and Information Technology Consulting MBIT LLC
109	5	3	5	45	Aneks Kontrate - Adhalmimi i rrugëve në Ishatin Wajsh - Ferizaj - projekt i dy vjeçar	21.03.2021	/	03.11.2021	04.11.2021	04.11.2021	04.12.2021	22.12.2021	17,897.74		17,897.74			1	4	1	0	1	1	"GERLICA-COMPANY" SH.P.K
110	2	1	1	93	Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror, LOTI - Pjesa Lindore e Qytetit nga ana e Helkurudhës	23.08.2021	13.09.2021	24.11.2021	26.11.2021	26.11.2021	26.11.2024	Në realizim	120,000.00	187,888.00				1	62	9	0	2	1	"Quality Asphal" SH.P.K & "DARDANIA" SH.P.K & "Company Zuka Commerce" Sh.p.k
111	2	1	1	93	Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror, LOTI - Pjesa Perëndimore e Qytetit nga ana e Helkurudhës	23.08.2021	13.09.2021	24.11.2021	26.11.2021	26.11.2021	26.11.2024	Në realizim	135,000.00	132,246.69				1	62	9	3	2	1	Rahovica Commerce" SH.P.K & "Pro & Co Group" SH.P.K & "Dashtrim Jashari" B.T

TOTA
LI
(15+16+17)

plotësi Te hyrat vetanake = 1 (nëse buqim/financim të projektit janë të hyrat vetanake, shënimin: 1 (E plotësojnë vetëm Kompania Publike)
Bunëti i Konsoliduar i Kosovës = 2 (nëse buqim/financim të projektit është nga donatorët, shënimin: 2)
Donacion = 3 (nëse buqim/financim të projektit është nga donatorët, shënimin: 3)
Nëse projekti financohet nga dy apo tri burime, shëno përburimet me numra të veçantë, pra duhet përfshirur të gjitha shënimet.
(Numri renditor i prokurimit) shënohet numri i rastit të prokurimit (cilili fillon për përburim fiskal prej 001). Nëse Kompania ka qenë në Plassë, dhe i është dhënë më pas se një DE, atëherë shëno përburim fiskal me numër të veçantë.
Lloji i prokurimit (shënohet vetëm një kod që paraqet llojin e prokurimit. Kodet janë këto:)

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

- Te kolona 2
- Te kolona 3
- Te kolona 4
- Te kolona 5
- Te kolona 6
- Te kolona 7
- Te kolona 8
- Te kolona 9
- Te kolona 10
- Te kolona 11
- Te kolona 12
- Te kolona 13
- Te kolona 14
- Te kolona 15
- Te kolona 16
- Te kolona 17
- Te kolona 18
- Te kolona 19
- Te kolona 20
- Te kolona 21
- Te kolona 22
- Te kolona 23
- Te kolona 24

Vërejtje: Raporti duhet të përfshijë të gjitha llojet e kontratave me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale.



ZYRA E PERSONELIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Në Zyrën e Personelit gjatë periudhës 1 vjeçare Janar – Dhjetor 2021 janë kryer këto punë dhe detyra:

- Zyra e Personelit ka mbajtur evidencë dhe ka nxjerrë raporte të vijueshmërisë së nëpunësve civil;
- Gjatë muajit Janar 2021, Zyra e Personelit kryesisht është marrë me procesin e pranimit të formularëve të vlerësimit të shërbyesve civil nga ana e Drejtorëve të Drejtorive dhe udhëheqësve të sektorëve;
- Janë përgatitur kërkesa për rivlerësimin e titujve të punës gjegjësisht për ndryshimin e koeficientëve të pagave për shërbyes civil dhe janë përcjellur në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Janë përgatitur materiale me aktpërcjellës për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, sa herë që kemi pranuar kërkesa nga KPMSHCK (të gjitha brenda afateve ligjore);
- Janë përgatitur përgjigje rreth kërkesave të ndryshme që kemi pranuar përgjatë vitit;
- Me kërkesa të ish të punësuarve janë fotokopjuar dokumente të ndryshme nga dosjet pasive të zyrtarëve që nuk janë më në marrëdhënie pune;
- Janë lëshuar vërtetime siç janë përvoja e punës, referenca etj.
- Janë përgatitur 64 kërkesa të pushimit për shërbyes civil;
- Janë larguar 14 punëtorë nga listat e pagave ku kemi pasur 3 raste të vdekjes dhe 11 punëtorë janë pensionuar gjatë vitit 2021 dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi;

- Gjatë vitit 2021 janë përgatitur 7 vendime për pushim të lehonisë;
- Janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plani vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2022;
 - Plani i Personelit për vitin 2022 (përmes SIMBNJ);
 - Janë ndjekur trajnime online rreth legjislacionit të ri për shërbyesit civil dhe publik si dhe rreth përdorimit të SIMBNJ (versionit të ri të sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore);
- Janë përgatitur formularët për paga dhe janë dërguar në MEF në formë elektronike si dhe për pagat e anëtarëve të Asamblesë dhe të Komiteteve për seancat e tërë vitit;
- Është dërguar në MAP raporti për strukturën e të punësuarve në Shëndetësi, Arsim dhe Administratë për periudhat tre mujore Janar-Mars, Prill-Qershor, Korrik – Shtator, Tetor – Dhjetor 2021;
- Është plotësuar raporti statistikor për vitin 2021;
- Janë skanuar dhe janë vendosur në dosje dokumente shtesë të punëtorëve që kanë sjellë në Zyrën e Personelit. Këto janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerrë vërtetime për punëtorë dhe për praktikantë;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët që kanë sjellë dëshmi shtesë të përvojës;
- Për çdo muaj janë plotësuar formular të ndryshëm për paga të punëtorëve.
- Janë nxjerrë nga sistemi regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2021 të cilat janë kompletuar dhe janë dërguar për nënshkrimin e pagave nga ana e të të punësuarve;
- Janë kontaktuar vazhdimisht përmes postës elektronike zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe janë dërguar shkresa të ndryshme për ndryshim të koeficientëve të punëtorëve për pagesën e beneficioneve tjera;
- Urdhër pagesat për pagat ose (CPO-të), për të gjitha kodet buxhetore janë dërguar të nënshkruhen nga të gjithë Drejtorët e Drejtorive dhe pas nënshkrimit origjinalet janë dërguar në MEF;

Zyra e Personelit gjatë muajit Dhjetor përpos punëve të përditshme është marrë si me konsultime të ndryshme me nëpunësit civil lidhur me të drejtat e tyre edhe me procesin e vlerësimit të shërbyesve civil përkatësisht janë udhëzuar për këtë proces.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Gjatë vitit që lamë pas, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Agim Aliu, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitete e Komunës së Ferizajt.

Për një vit kalendarik, kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Ferizajt.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj qindra komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqës dhe faqes zyrtare të Komunës së Ferizajt në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi rrethanat e pandemisë, menaxhimin e saj si dhe aktivitete të përditshme të Komunës sonë.

Uebajti i Komunës sonë çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në Komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në Komunë, por edhe jashtë Komunës. Vlen të theksohet se në ueb-in e Komunës së Ferizajt, janë bërë edhe ndryshime të shumta të cilat shkojnë në të mirë të Komunës sonë, në mënyrë që qytetarët tanë të kenë njohuri të shumta lidhur me atë se çfarë punohet konkretisht në Komunën e Ferizajt.

Në mënyrë që Komuna e Ferizajt të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe proceverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për Komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në uebfaqën e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. E gjithë kjo bëhet në të mirë të të gjithëve, përfshirë aty edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Zyra për Informim po ashtu ka funksionuar në bazën edhe të Planit të Transparencës, por edhe udhëzimeve të reja administrative të transparencës.

Po ashtu vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës ku janë të publikuar afro 200 vendime, si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyre. Në kuadër të projektit të USAID-it “Komunë Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse”, është punuar mjaft shumë ku jemi renditur si njëra ndër komunat e para sa i përket transparencës në publikimin e dokumenteve të cilat janë të qasshme për publikun.

Përparësi e uebfaqes së Komunës së Ferizajt është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në uebfaqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnit të uebfaqës komunale nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, zyra jonë për informim nuk ka pasur asnjë problem sa i përket plasimit të informacioneve, por edhe publikimeve të ndryshme sepse këtë e ka bërë edhe përmes rrjetit social Facebook, ku aty shikueshmëria por edhe përcjellja e informacioneve ka qenë dukshëm më e përcjellur se sa në faqen zyrtare të Komunës.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për Qasje në Dokumente Publike. Gjate vitit 2021 janë pranuar 50 kërkesa, ku 49 prej tyre i është lejuar qasja ndërsa vetëm një kërkesë është refuzuara dhe të gjitha këto kërkesa janë përfunduar në afatin e paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Veç tjerash, presim që të vazhdojmë me realizimin e objektivave dhe me po të njëjtin ritëm të punës, në mënyrë që ueb faqja e Komunës së Ferizajt, çdo here të jetë e freskët me lajmet më të reja dhe në mënyrë që secili qytetar të ketë qasje në informata dhe të dijë saktë se ç’ndodh e zhvillohet në Komunën tonë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2021, Inspektorati Komunal i Komunës së Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe planit të punës të parashikuar për periudhën një vjeçare, si dhe duke i tejkaluar edhe objektivat për shkak të kërkesave të ndryshme dhe pandemisë Covid 19.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
- Inspektimi dhe monitorimi i deponive ilegale të mbeturinave në kuadër të Komunës së Ferizajt;
- Inspektimi i subjekteve për pajisje me LMK (Leje Mjedisore Komunale);
- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për shqiptimin e Gjobave Mandatore;
- Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
- Monitorimi i rrugëve të qytetit;
- Inspektimi dhe monitorimi i të gjitha shkollave, për plotësimin e kushteve higjienike - sanitare;
- Inspektimi dhe monitorimi i furrave të bukës për nivelin higjieniko – sanitar;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja me pëlqim për plotësimin e kushteve sanitare;
- Aksione me Policinë e Kosovës – Njësi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Monitorimi i subjekteve të cilat janë mbyllur për shkak të zhvillimit të veprimtarive devijante;
- Monitorimi dhe largimi i shitësve ambulantë nga bulevardi i qytetit;
- Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
- Lirimi i hapësirave publike në vend punishte;

- Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;
- Kontrollimi dhe monitorimi i thertoreve në baza ditore.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Spektori i Tregut:

Në kuadër të Sektorit të Inspeksionit funksionon edhe njësia e Inspektoratit të Tregut.

Gjatë kësaj periudhe:

- Janë kryer 249 kontrollime të rregullta me procesverbale të hartuar dhe një mori kontrollimesh vizuale.
- Janë lëshuar 206 vendime për dhënien e pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore për subjektet afariste.
- Janë konfiskuar mallra të ndryshme në 6 raste.
- Janë proceduar 6 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Ferizaj.
- Është bërë ndalimi i përkohshëm i veprimtarisë për subjekte afariste në 20 (njëzet raste).
- Janë shqiptuar 39 gjoba ndaj subjekteve afariste për shkelje të Ligjeve që janë në kompetenca të Inspeksionit të Tregut.
- Është punuar gjatë pandemisë që prej fillimit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Regjioni i Ferizajt, Inspektorët e Punës, Inspektorët e ATK-së, pas orarit të rregullt të punës, vikendeve dhe festive.

Spektori Sanitar:

Nga Shtatori 2021, 4 inspektorë sanitar në marrëdhënie të rregullt pune kanë kaluar në kompetencë të AUV (Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë).

- Janë realizuar 827 kontrolle të rregullta.
- Janë pranuar 321 kërkesa për pranimin e objektetve afariste në lidhje me kushtet minimale teknike – sanitare të mbrojtjes dhe sigurisë në punë.
- Janë realizuar 12 kërkesa për asgjësim të produkteve ushqimore të skaduara dhe të dëmtuara në një vlerë prej 211,000.00 euro dhe të gjitha këto produkte ushqimore janë asgjësuar në mënyrë të kontrolluar.
- Janë mbyllur 7 lokale.

- Janë bërë 42 kontrolle të jashtëzakonshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës -Njësia Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, aksione të përbashkëta për kontrollimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e hotelierisë.
- Janë shqiptuar 42 gjoba administrative si dhe për disa është iniciuar procedura në Gjykatën Themelore - Departamenti për Kundërvajtje.
- Kemi marr pjesë në ekshumimin e 6 rasteve të personave të vdekur sipas kërkesave të palëve.
- Janë bërë kontrolle të rregullta të ujësjes së qytetit si dhe ujësjesve lokal, në mënyrë permanente nga IKSHP-ja është bërë analiza e ujit të pijes.
- Janë inspektuar të gjitha objektet shkollore në Komunën tonë duke dhënë vërejtje për eliminimin e parregullsive të konstatuara në ato objekte, si dhe gjatë kësaj periudhe të pandemisë për zbatimin e masave kundër Covid-19.
- Nga fillimi i pandemisë janë bërë inspektime të shumta në lidhje me respektimin e masave anticovid.
- Janë marrë 10,110 vendime për izolimin e personave të infektuar me Covid-19 si dhe shfuqizim të vendimeve të njëjta pas shërimit të tyre.
- Për mos zbatimin e masave anticovid janë iniciuar 3624 lëndë në Gjykatën Themelore - Departamenti për Kundërvajtjeje.
- Në bashkëpunim me IKPSH-në rajoni i Ferizajt janë marrë mostrat e ushqimit dhe strishot për përcaktimin e nivelit të higjienës.

Sektori i Ndërtimit:

Inspektorati i ndërtimtarisë gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2021 ka realizuar një varg inspektimesh të rregullta dhe të jashtëzakonshme në territorin e qytetit të Ferizajt. Të gjitha këto veprime Inspektorati i Ndërtimtarisë i ndërmori duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit 04/L-110, Ligjit të Inspektoratit të Ndërtimit 04/L-175 dhe udhëzimeve administrative të aprovuara. Bazuar në ligjet dhe aktet e lartëcekura, si dhe inspektimet e kryera, janë ndërmarrë këto veprime. Gjatë kësaj periudhe kanë punuar vetëm 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

- Janë pranuar gjithsej 29 lëndë nga arkiva.
- Nga lëndët e pranuar është 1 ankesë, e cila është zgjidhur.
- Kërkesa kanë qenë 27, të gjitha janë zgjidhur.
- Nga këto lëndë ka qenë 1 njoftim.
- Janë realizuar 260 inspektime.
- Janë hartuar 106 procesverbale.
- Janë marrë 27 vendime për ndërprerje të punimeve.

- Janë bërë 27 mbyllje të punishteve (vendosje të shiritit dhe shenjës)
- Janë shqiptuar 27 gjoba mandatore.
- Janë bërë 13 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.
- Janë bërë 8 shkresa për organe dhe institucione tjera.
- Janë proceduar 5 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Ferizaj
- Janë marrë 5 vendime për rrënim.
- Përveç punëve të lartcekura, janë realizuar edhe punë në bashkëpunim me inspektorët tjerë, përafërsisht 90 inspektive.

Spektori Veterinar:

Inspektorët e veterinarisë gjatë kryerjes së punës bazohen në Ligjin e Veterinarisë 2004/21, Ligjin e Ushqimit 03/L-016, udhëzime administrative dhe në rregullore komunale.

Nga Shtatori 2021, 3 inspektorë veterinar në marrëdhënie të rregullt pune kanë kaluar në kompetencë të AUK (Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë).

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar numër i konsiderueshëm të kontrolleve veterinare, janë kontrolluar 1255 therje të kafshëve, gjedheve para therjes, gjatë therjes dhe pas therjes. Të gjitha kontrollet e kafshëve, gjedheve, pas therjes kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore të përdoren për konsum human, pastaj janë damkosur dhe pajisur me çertifikata shëndetësore të therjes. Prej këtyre therreve janë inkasuar $1255 \times 5 = 6275$ euro.

Në Inspektoriatin veterinar janë realizuar këto aktivitete:

- Janë konfiskuar dhe asgjësuar 1730 kg mushkri gjedhi.
- Janë konfiskuar dhe asgjësuar 692 kg mëlçi gjedhi, të cilat ishin të prekura nga nekroza dhe parazitë të ndryshëm si: Fasciola, Hepatica, Dicrocelioza, Abscese, tumore, nekroza hepatike etj.
- Janë konfiskuar dhe asgjësuar 960 kg mish gjedhi, mish të bluar, mish pule, qumësht dhe produkte të qumështit.
- Janë hartuar 245 procesverbale të rregullta në terren.
- Janë proceduar 10 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Ferizaj.
- Janë kontrolluar ambulancat veterinare.
- Është kontrolluar Tregu i Kafshëve dhe Tregu i Gjellbërt.
- Kanë bashkëpunuar me inspektor sanitar gjatë kontrolleve në terren.
- Janë realizuar edhe punë të tjera me palë në zyrë.

Sektori i Ambientit:

Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar numër i madh i bizneseve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Numri më i madh i këtyre bizneseve merren me përgatitje të ushqimeve të shpejta, përgatitje të bukës dhe pjekurinave tjera nga mielli, mishtore, përpunues të drurit (mobilerive) etj. Të gjitha këto inspektime janë bërë në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, ku saktësisht precizohet se cilat aktivitete i nënshtrohen LMK-s. Nga këto subjekte afariste është kërkuar që t'i plotësojnë kushtet për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Një numër i këtyre subjekteve afariste janë pajisur me LMK, ndërsa tjerat janë në procedurë të pajisjes me LMK.

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe mbajtjes pastër së qytetit. Janë realizuar disa takime me K.R.M."Pastërtia", N.P.L."Ambienti" SH.A. dhe me Drejtorinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave për bashkëpunimin që duhet ta kemi lidhur me mbajtjen sa më të pastër të qytetit.

- Janë shqiptuar 212 gjoba mandatore duke filluar nga 20 deri në 100 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promocionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me Udhëzimin Administrativ në fuqi 06/2018.
- Të gjitha gjobat e papaguara do të përcillen tek përmbaruesi për ekzekutim të mjeteve monetare.
- Përveç gjobave janë dhënë edhe shumë vërejtje gojore të mos hedhen mbeturina në hapësira të cilat është e ndaluar hedhja e tyre. Po ashtu përmes një njoftimi të protokolluar i kemi njoftuar qytetarët për orarin e hedhjes së mbeturinave në çdo pjesë të qytetit.
- Janë pranuar 20 ankesa me shkrim të cilave i jemi përgjigjur në afat të duhur por ka akoma të cilave do i përgjigjemi brenda afatit të paraparë për shqyrtimin e tyre.
- Janë pranuar po ashtu rreth 30 ankesa gojore nga qytetarët të cilave i jemi përgjigjur menjëherë si dhe efekti ka qenë pozitiv.
- Gjithashtu gjatë inspektimit në terren janë hartuar 36 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecurinë e mëtutjeshme.
- Poashtu janë realizuar 30 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminim të deponive ilegale.
- Vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjes së pandemisë me virusin Covid-19, me ç'rast kemi qenë të angazhuar lidhur me ecurinë e zhvillimeve dhe implementimin e udhëzuesve të dal nga Qeveria që nga dalja e rasteve të para me këtë virus.
- Janë realizuar inspektime të kohë pas kohëshme së bashku me Inspektorët e MMPH-së lidhur me Planin Operativ "PARANDALIMI DHE NDALIMI I AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË SEKTORIN MINERAR".
- Shënimi i Ditës Botërore të Tokës është realizuar me aktivitete simbolike ku pjesëmarrësit kanë qenë të shumtë.

Sektori Komunal:

Gjatë periudhës njëvjeçare, Inspektorët Komunal janë angazhuar për zbatimin dhe implementimin e Rregullores për Rregullin dhe Shërbimet Komunale me nr. 01. Nr. 114 e datës 30/09/2019 të Komunës së Ferizajt. Zbatimi i Rregullores konsiston në mirëmbajtjen e rregullt të hapësirës publike, trotuareve, rrugëve etj.

Vëmendje e veçantë gjatë kësaj kohe i është kushtuar trotuareve, parqeve, rrjetit të ujësllësit të kanalizimit dhe dukurive të tjera negative. Në këtë raport do të veçojmë se si dukuri më negative kanë qenë tregtarët ambulant me tezgat e tyre lëvizëse të vendosura në sheshin e qytetit.

Janë ndërmarrë disa aksione për pastrimin e trotuareve dhe rrugëve të qytetit nga tezgat, reklammat dhe gjësendet të ndryshme për lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve. Këto aksione janë realizuar me sukses me ndihmën e Ndërmarrjes K.R.M. "Pastërtia", K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A. dhe mbështetjen e Policisë së Kosovës – Stacioni Policor - Ferizaj.

Vlen të theksohet se këtë vit për shkak të shtrirjes së rrjetit nëntokësor elektrik nga kompanitë të kontraktuara nga KEDS-i, ka marrë kohë të konsiderueshme kthimi i rrugëve në gjendjen e mëparshme.

Një nga aksionet që është ndërmarrë ndaj të gjitha subjekteve është urdhëresa që të rregullojnë trotuaret nga gjendja e pjerrët në gjendje të rrafshët në mënyrë që të lehtësohet siguria gjatë ecjes së qytetarëve në trotuare dhe kështu të eliminohet mundësia e lëndimeve të ndryshme gjatë kohëve të vështira atmosferike (borë, shi).

- Janë hartuar 60 procesverbale.
- Është proceduar 1 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje.
- Janë pranuar dhe shqyrtuar 67 kërkesa dhe ankesa.
- Janë proceduar 4 lëndë për Kallëzime Penale.
- Janë marrë 11 vendime.
- Janë realizuar 25 njoftime.

Gjatë kësaj periudhe kohore është punuar edhe jashtë orarit të punës si dhe në terren gjatë fundjavës gjegjësisht të shtunave dhe të dielave për shkak të respektimit të rregullave të vendosura gjatë kohës së pandemisë.

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Tregu:

- Kontrollimi i të gjitha subjekteve afariste nga Inspektorët e Tregut në kuadër të autorizimeve ligjore;
- Procedimi i lëndëve për procedurën përmbartimore;

Ndërtimi:

- Monitorimi sistematik i objekteve të pajisura me leje ndërtimi;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

Ambient:

- Monitorimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i shitëseve ambulant të thëngjillit;
- Njoftimi në vazhdimësi për ruajtjen e ambientit;

Komunal:

- Monitorimi i bulevardit të qytetit;
- Inspektimi në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve;
- Monitorimi dhe lirim i hapësirave publike.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E NJËSISË SË AUDITORIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Raporti i punës është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, i cili përmbledh punët dhe shërbimet e auditimit të brendshëm të kryera gjatë vitit kalendarik 2021.

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2021. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2021 ka përgatitur Planin Strategjik 2021/2023, si dhe Planin Vjetor 2021 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2021, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2021-2023 janë të përfshira të gjitha drejtorit-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2021, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej shtatë (7) auditme të brendshme, që janë: pesë (5) me rrezik të lartë, dy (2) me rrezik të mesme dhe zero (0) me rrezik të ulët. Për vitin 2021 janë kryer këto auditime:

- Grumbullimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve të mallrave, shërbimeve, komunal, subvencione dhe kapitale - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave;
- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventari, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në DA - Drejtoria e Arsimit

- Procedurat e menaxhimit të prokurimit - Zyra e Prokurimi
- Grumbullimi i të hyrave vetanake - Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat e bizneseve dhe qirave, Drejtoria e Finacave

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2021, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej shtatë (7) auditime të brendshme nga shtatë të planifikuar.

Pra, gjatë vitit 2021, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme dhe t'i hartoj raportet e t'i dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej shtatë (7) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzetën (21) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitet dhe efektivitet gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatit planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzetën (21) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara tre (3)
- Proces trembëdhjetë (13)
- Të pazbatuara pesë (5)

Trembëdhjetë (13) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2022, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmuorët e vitit 2021 dhe përmbledhjen e vitit 2021 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në drejtoritë e audituara në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Zyra për Integrime Evropiane funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyre ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me integrime evropiane. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Integrimit Evropian (MIE).

Gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore, respektivisht Janar - Dhjetor 2021, ne kemi kryer në përpikëri obligimet të cilat i kemi të përcaktuara sipas detyrës zyrtare, pra koordinimin, monitorimin dhe raportimin në Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat merren me integrime evropiane.

Zyrtari për Integrime Evropiane ka qenë i përfshirë në ekipin e Kryetarit të Komunës së Ferizajt për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian dhe ka mbajtur kontakt të rregullt me organizata të jashtme, ato të Këshillit të Evropës dhe të tjera të cilat operojnë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu vazhdojnë këto ekipe të përbashkëta të jenë aktiv edhe për thirrjet e reja të BE-së.

Kemi bërë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar. Poashtu kemi kompletuar dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Kemi kryer edhe punë të tjera të arsyeshme zyrtare në kuadër të zyrës.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integrime Evropiane ka bërë raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane për vitin 2021. Kemi plotësuar pytësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL, MIE dhe AKK.

Janë ndërrmarr të gjitha ato veprime me prioritet për integrimet evropiane, me të cilën synohet të jetë krijimi i një klime të volitshme për përmirsimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarëve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Në periudhën njëvjeçare Janar – Dhjetor 2021 kemi mbajtur kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara qoftë përmes telefonit apo përmes postës elektronike me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së, Ministrinë për Integritet Evropian dhe Ministrinë e linjave.

Në të gjitha takimet konsultative apo tryezat e punës, jemi përgjigjur pozitivisht thirrjeve të Ministrive përkatëse, duke dhënë kontributin tonë për çështjet në fjalë.



ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Aktivitetet

Gjatë këtijë viti kemi kthyer përgjigje në 18 kërkesat e Gjykatës Themelore, për mosnjohjen e adresave të vendbanimit për komunitetin serb të palëve ndërgjyqësore.

OJQ BRAN në bashkëpunim me USAID dhe ZKKK ka mbajtur trajnime me nxënës të drejtimit juridik, zgjatja e këtij trajnimi është 4 muaj, dhe do të merren me probleme të ligjit me dokumente dhe ndihma juridike.

Vlen të ceket se nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë ndihmuar 37 familje të komuniteteve me lëndë djegëse (dru zjarri për ngrohje).

Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve ka aprovuar kërkesën e komunitetit serb për transportin në relacionin Ferizaj-Graçanicë dhe anasjelltas dy herë në muaj.

Në zyret vendore të komuniteteve në fshatin Dubravë dhe në lagjen Sallahane janë mbajtur takime me popullatën me temën: “Legalizimi i pronave të komuniteteve rom, ashkanli, egjiptian” me OJQ VO RAE.

Vlen të ceket se gjatë muajit Mars janë vaksinuar 250 persona në lokacionet ku jetojnë komunitetet rom, ashkali, egjiptas.

UNMK-u ka bërë shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike ku janë përfshirë mbi 130 familje të komunitetit ashkanli.

Vlen të ceket se Ministri i Shëndetësisë vizitoi fshatin Dubravë me delegacionin qeveritar dhe me struktura udhëheqëse të Komunës ku edhe shpërndau maska mbrojtëse për qytetarët dhe nxënësit.

Kthimi dhe riintegrimi

Gjatë këtij viti kemi pasur persona të riatdhesuar të cilët kanë kërkuar nga ZKKK-ja që të futen në SMR dhe kanë aplikuar për grante si dhe për banim me qera.

Vlen të ceket se koordinatorja ka marrë pjesë në takimet e grupit punues për shqyrtimin e kërkesave për personat e riatdhesuar të cilit kanë bërë kërkesë për subvencione apo banim dhe për pako ushqimore.

Njëherit kemi dalur në terren së bashku me zyrtarin e lartë për ri-integrim nga MPB ku së bashku janë vizituar familjet e të riatdhesuarve dhe jemi njoftuar më hollësisht mbi gjendjen e tyre materiale e shëndetësore si dhe i kemi mbështetur me pako ushqimore e higjienike, familjet në nevojë në nder të Festës së Bajramit.

Takimet në cilësi të trajnimit ose informimit

Kemi pasur takime të ndryshme me organizata të ndryshme, vlen të ceket se kemi marrë pjesë në takimet të cilit ka organizuar OSCE, VOA RAE, Roma Sted, Balkan Sunflower, Advancing Together dhe shumë organizata të tjera si dhe kemi pasur takime virtuale me përfaqësues të Zyrës të Kryeministrit për Qeverisje të Mirë.

**NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT****RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021**

Ky raport pasqyron përmbledhjen e punës të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut për periudhën Janar –Dhjetor 2021.

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe në fushat të cilat i trajton NJDNJ dhe ZBGJ.

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit- rezultatet	Afati kohor
Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë	Monitorimi i rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në intervista)	NJKDNJ	Rritja e shkallës së zbatimit të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi punën dhe punësimin Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim	Kontinuitet
Ofrimi i shërbimeve më të mira shëndetësore	- Ofrimi i rekomandimeve për rregulloren komunale për lirin nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë.	NJKDNJ	- Krijimi i lehtësirave për shërbime shëndetësore	
Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarë në Administratën Publike	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve më të mira për qytetarë		- Ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave në marrjen e dokumenteve identifikuese për qytetarë	

Udhëzimi Administrativ për heqjen e taksave komunale për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshorteve	Ofrimi i udhëzimit në shërbim të qytetarëve	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe NJDNJK		Masë afirmative një vit kohore
Projekt udhëzimi Administrativ(MPB) Nr.2021 masat për mbrojtjen e fëmijëve kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe atyre që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve	Konsultime Paraprake	NJDNJK		Kontinuitet
Draft Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe Planin e Veprimit 2022-2026	Ministria e Drejtësisë	NJDNJK ZBGJ	Platforma Zoom	
Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor	Agjencia për Barazi Gjinore	Zyrtarja për Barazi Gjinore	Asistenca teknike nga Un Uomen	25-27 Tetor 2021
Drejtoria e Policisë së Kosovës	Punëtori për përfshirjen e të rinjve brenda KLSP-ve si dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e integritetit gjinor dhe të rinjve	Paneliste në prezantimin/korni zës ligjore që rregullojnë çështjet gjinore në nivelin lokal se bashku me dokumentet strategjike	ZBGJ	
Organizata jo qeveritare: Voice of Roma Ashkali and Egyptians:	Luftimi i Antigjipsizmit:	Projekt ky i cili ka për qëllim të njoftoj zyrtarët publik si dhe organizatat e shoqërisë civile mbi fenomenin e antigjipsizmit	ZBGJ	

Fondacioni Jahjaga	Përfshirja dhe fuqizimi ekonomik i grupeve të marginalizuara në Kosovë	Fondacioni Jahjaga në koordinim me UNHCR dhe UNDC/UNKT takim virtual me gratë dhe vajzat nga komuniteti jo-shumicë që jetojnë në Komunën e Ferizajt	ZBGJ	
Agjencioni për Barazi Gjinore dhe ZBGJ	Hapja e fushatës globale 16 Ditë të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore ndaj grave dhe vajzave	ZBGJ	Platforma online ne hapjen e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit	
Avokati i Popullit	Hetimin e përgjithshëm për shëndetin maternal, planifikimin familjare dhe abortin në Kosovë	ZBGJ	Fokus-grupet për shëndetin riprodhues, është, thirrja falas 080015555	
Informimi dhe vetëdijesimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës	Takime me gratë e zonave rurale dhe me gratë e komunitetit RAE	Rahovicë, Manastirc, Lloshkobare Dubravë		Platforma Zoom
Ofrimi i mundësive të barabarta për Grua-Burrë		ZBGJ		Platforma Zoom
Parandalimi i stereotipeve dhe paragjytimeve për gruan		ZBGJ		Platforma Zoom

Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës e veçmas në trashëgimi		ZBGJ		
-Identiteti Gjinor		ZBGJ		
-Përkatësia Gjinore		ZBGJ		
-Pozita e femrës në familje dhe vendimmarrje		ZBGJ		
-Pozita e barabartë e vajzës dhe djalit në familje		ZBGJ		
-Format e diskriminimit së gruas		ZBGJ		
-Dhuna në familje		ZBGJ		
-Ligji për Barazi Gjinore		ZBGJ dhe mekanizmat tjerë institucional		
Takimet me organizatat Ndërkombëtare OSCE, Këshilli i Evropës	Promovimi i të drejtave të grave dhe të vajzave	ZBGJ		
16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje	Prezantimi i analizës në sektorin e arsimit	ZBGJ		
Punëtori on-line mbi rolin e grave dhe kontributi i tyre në siguri në bashkësi, përfshire sfidat gjatë pandemisë.		ZBGJ		

Rrjeti i Grave Profesionale ne kuadër të organizatës ;Leadership and Growth Council;takim online për të diskutuar :Roli i grave ne qeverisje dhe perspektiva për pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale 2021		ZBGJ		
Performanca komunale		ZBGJ		
DEMOS		ZBGJ		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, tryezën e rrumbullakët virtuale me temën :Nëna, Gruaja dhe Dhuna				
Promovimi i të drejtave të komuniteteve	- Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve	NJDNJ	-Integrimi i komuniteteve në jetën institucionale e publike Platforma Zoom	
Promovimi i të drejtave të fëmijëve	- Organizimi i debateve publike me drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve	NJDNJ NJDNJ DA	-Identifikimi i gjendjes aktuale për DF - Zbatimi i infrastrukturës ligjore për fëmijë	
Promovimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të - Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara	NJDNJ	- Infrastruktura e rregulluar për PAK-të - Grumbullimi i të dhënave për fëmijët me AK	



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2021

Aurora Ramadani
Drejtores e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme

Përmbajtja

1.Hyrje.....	
2.Përmbledhje.....	
3.Zyrtarja Administrative.....	
4.Zyrtari Financiar.....	
4.Sektori i Gjendjes Civile.....	
5.Zyra për Shërbim të Qytetarëve.....	
6.Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta.....	
8.Njësia e Përkthyesve.....	
9.Njësia e Arkivit të Administratës Komunale.....	

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bazuar në ligjet që janë në fuqi: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet administrative.

DAP është garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin:

- E vendimmarrjes;
- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimit të drejtë të kërkesave e shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimit rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër;
- DAP do të vazhdojë t'i ruaj dhe kultivoj edhe më tej marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektim e të drejtave dhe lirive të tyre, sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2021 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve;
- Infrastrukturë të avancuar profesionale;
- Ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akteve ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Depolitizim të aktiviteteve të administratës;
- Luftë kundër dukurisë së korrupsionit dhe dëmtimit të pasurisë së Komunës;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarët;
- Frymë të tolerancës për mendimin ndryshe dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.
- Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase mbi bazën e respektimit të ligjit.
- DAP gjatë vitit 2021 ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm të bazuar në respektimin e ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.
- DAP e organizuar në sektorët e lartshënuar ka arritur që me përkushtimin më të lartë t'i kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat që i kanë dalë përpara gjatë kësaj periudhe një vjeçare të punës, duke qenë vazhdimisht në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë. Më poshtë po përmendim vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:
- Gjatë këtij viti kemi organizuar dhe mbikëqyrë regjistrimin vjetor të inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale duke përfshirë edhe institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekave si dhe institucioneve të tjera që janë nën menaxhimin e Komunës dhe pas këtij regjistrimi kemi bërë edhe tërheqjen e inventarit të demoluar, duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që kemi konstatuar se mund të përdoret e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave që kanë pasur nevojë (sipas kërkesave të tyre).
- Këto veprime janë kryer duke formuar paraprakisht komisionet adekuate siç janë: Komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit;
- Janë marrë edhe një varg hapash e masash të tjera për funksionalizimin e mëtejshëm dhe bërjen më efikase të administratës komunale.

Në vazhdim do të paraqesim punën vjetore të sektorëve dhe njësive të DAP.

Administrata gjatë vitit 2021

DAP gjatë vitit 2021 ka zhvilluar aktivitetin e vet përmes këtyre njësive organizative:

1. Asistentja Ekzekutive;
2. Zyrtari financiar;
3. Sektorit të Gjendjes Civile;
4. Sektorit të Shërbimeve të Qytetarëve;
5. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta;
6. Njësia e Arkivit Komunal.

1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)

Është përkujdesur për punët administrative në kuadër të Drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat e Drejtorisë për të cilat janë zhvilluar procedura, dhe të njëjtat i klasifikon dhe i ruan në Arkivin e drejtorisë gjegjëse. Shtyp njoftime dhe shkresa të tjera të DAP-së, protokollon të gjitha shkresat që dalin nga DAP, përcjellë përmes postës elektronike, shkresa dhe materiale të dedikuara për Ministri, përmes intranetit u jep përgjigje kërkesave që i dedikohen DAP-së si dhe përpilon raportet e Drejtorisë.

2. ZYRTARI FINANCIAR

Është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, përkatësisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës elektrike, ujit, mbeturinave, faturat për riparimin e mjeteve zyrtare si dhe faturat tjera që janë barrë e drejtorisë përkatëse.

3.SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Të dhënat për dokumentacionin e lëshuar dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile (SGJC), gjatë vitit 2021, po i paraqesim në këtë formë:

Ekstrakte të lindjes -----	59908
-Certifikatë martese -----	12073
-Certifikatë vdekje-----	4804
-Certifikatë vendbanimi -----	5082
-Certifikatë bashkësie familjare -----	10103
-Certifikatë gjendje martesore -----	2930
-Certifikatë shtetësie -----	988
-Vërtetim nga arkivi -----	1934

Totali- 121,670

4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

Gjatë vitit 2021 në Zyrën për Shërbime të Qytetarëve janë kryer këto punë, të cilat do t'i paraqesim në mënyrë tabelare si më poshtë, të dhënat për pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve drejtuar organeve të Komunës sipas njësive organizative.

Nr. i Kërkesave për Drejtoritë

01/01/2021 - 31/12/2021

Nr.	Përshkrimi	Nr. kërkesave	Përqindja
1.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	87,385	58
2.	Drejtoria e Financave	29,394	19
3.	Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	20,413	13
4.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	2,363	1
5.	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit	2,177	1
6.	Zyra e Kryetarit	2,128	1
7.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	2,061	1
8.	Drejtoria e Arsimit	1,849	1
9.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1,642	1
10.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	386	0
11.	Drejtoria e Infrastrukturës	356	0
12.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm	207	0
13.	Kuvendi Komunal	10	0
		150,371	

5.SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Në kuadër të Sektorit e Shërbimeve të Përbashkëta hyjnë si më poshtë:

1. Njësia e postës me një zyrtar;
2. Njësia e Shoferëve 5 të punësuar;
3. Njësia për përkthime me 1 zyrtar;
4. Njësia për mirëmbajtje të objektit me 2 të punësuar;
5. Njësia arkivit administratës komunale 2 zyrtarë;
6. Zyrtar për mirëmbajtje e zërimit dhe rrymës elektrike.

Gjatë kësaj periudhe Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta i ka kryer këto shërbime siç vijojnë:

1.Njësia e Postës

Është përkujdesur për shpërndarjen e shkresave zyrtare prej zyrtarëve komunal deri tek qytetarët në qytet dhe zona rurale, përmes zyrtarit për shpërndarjen e postës.

2.Njësia e Shoferëve

Në mënyrë permanente është përcjellë puna e shoferëve, angazhimin e tyre për bartjen e zyrtarëve komunal, është përkujdesur për kohëzgjatjen e regjistrimit të automjete zyrtare dhe kompletimin e dokumentacionit për regjistrim përmes shoferëve.

3.Njësia e Përkthimit

Është përkujdesur dhe e ka monitoruar punën zyrës për përkthimin e shkresave zyrtare prej gjuhës shqipe në gjuhën serbe.

4.Njësia për mirëmbajtje të objektit

Përmes zyrtarit për mirëmbajtjen e objekti janë evituar prishjet e ndryshme si të dyerve, përkatësisht ndërrimin e bravave të dyerve, nyjeve sanitare si në objektet e Komunës ashtu edhe në objektet ndihmëse (Sallën e Sportit, zyrat e vendit etj.)

- Zyrtarit financiar është përkujdesur për gjendjen financiare për Drejtorinë e Administratës dhe Personelit, përkatësisht ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës elektrike, ujit, mbeturinave, faturat për riparimin e automjeteve zyrtare, si dhe faturave tjera që kanë qenë barrë e drejtorisë përkatëse.

5.Njësia e Arkivit të administratës komunale

Zyrtarët administrativ janë përkujdesur për punët administrative në kuadër të Drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat për drejtorinë, për të cilat janë zhvilluar procedura për shqyrtimin e tyre dhe të njëjta t'i klasifikoj për ruajtje në sirtarë.

6. Zyrtari për mirëmbajtjen e zërimit dhe rrymës elektrike

Përkujdeset për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik në objektin e Komunës dhe përkujdeset për mirëmbajtjen e zërimit për Sallën e Kuvendit.

- Në kuadër të Sektorit të Shërbimeve të përbashkëta hyjnë edhe sigurimi i objektit mirëmbajtja e higjienës për të cilën jemi në kontakt të përhershëm me menaxherët e këtyre operatorëve tender fitues.
- Me një përkujdesje të shtuar ka monitoruar gjendjen teknike të automjeteve zyrtare, evitimin e prishjeve të ndryshme, përcjelljen e mbushjeve me lëndë djegëse, kontrollimin e vajt, antifrizit , ndërrimin e gomave për sezonin dimëror, pastrimin e automjeteve si dhe shërbime tjera.
- Gjatë këtij viti kemi pranuar një donacion autobus për transportin e udhëtarëve të Markes NEUPLAN, tipi N316,kv-280, Ccm-14618, Dyer 2 ,Ulse 51,KM-740196 viti i prodhimit 2000, nga Kompania “Endriti” Shpk.

Nr	Shpenzimet	Litra	Vërejtje
1	Shpenzimet e administratës me derivate për automjetet zyrtare të Komunës se Ferizajt	8.655.02	
2	Shpenzimet e derivateve për gjeneratorë dhe me autorizime	6.120	
	Total	14.775.02	

Lëshuarja e vërtetimeve sipas kërkesave të qytetareve

Shenja	Shenja DSC	Numri
032/03	Vërtetimet e certifikatave të gjendjes ekonomike	667
032/04	Deklaratat e ndryshme me dëshmitar	8
183/01	Stimulimi për rritjen e fëmijëve	22
205/01	Vërtetimet për vendbanime dhe vendqëndrimin.	247
345/02	Shfrytëzimi i mjeteve transportuese	10
615/03	Kërkesat dhe ankesat e ndryshme	46

Total: 1000

SHPENZIMET E DERIVATEVE PËR AUTOMJETET E KOMUNËS SË FERIZAJT

03 Janar 2021 -31 Dhjetor 2021

Nr.	Emri i automjetit	Nr.i regjistrimit	Drejtoria	Km. fillim muaji Janar	Km. fund muaj Qershor	Km. e kaluara	Shpenzime dizel	% paraparë	Mes. në 100 km.	Vërejtje
1	Kia	05z-04-25	DI	117273	120090	2817	208.01	5,90%	7.3840966	
2	Kia	05z-06-25	DSHPE	100796	107001	6205	493	6,00%	7.9452055	
3	Kia	05z-07-25	DRKS.	111457	116029	4572	314.02	6,10%	6.868329	
4	Kia	05z-10-25	DZHE	138386	143028	4642	367	5.90%	7.906075	
5	Kia	05z-12-25	DA	149321	152179	2858	204.01	6,05%	7.1382085	
6	Honday 120	05z-13-25	DEF	147172	148520	1348	133.01	5.60%	9.8672107	
7	Honday 120	05z-14-25	DU	99363	103260	3897	288.01	5,90%	7.3905568	
8	Honday 120	05z-15-25	DA	152662	155299	2637	219.02	6,00%	8.3056504	
9	Honday 120	05z-19-25	DEF	182313	187751	5438	362.96	6,10%	6.6745127	
10	Minibusi	05z-20-25	DRKS	165951	165951	0	71	15,00%	#DIV/0!	Defekt
11	Kia.	05z-24-25	Kryesuesja e Kuvendit	94469	103655	9186	613.02	6,00%	6.6734161	
12	Kia	05z-27-25	DSHMS	45762	61164	15402	886.04	6,00%	5.7527594	
13	Kia	05z-28-25	DU	63020	72914	9894	615	6,00%	6.2158884	
14	Kia	05z-31-25	Kryetari	53271	60964	7693	503	6,10%	6.5384115	
15	Kombi-Merce.	05z-32-25	DAP	275777	278720	2943	307.85	12,00%	10.460415	
16	Xhipp-Tojota	05z-33-25	DBZHR	223950	227460	3510	484	10,00%	13.789174	
17	Renault	05z-34-25	Kabineti	20595	28401	7806	538.45	7,00%	6.8978991	
18	Nisan	05z-40-25	D.Bujqësis	238849	242533	3684	560.6	/	15.217155	
19	Dacia	05z-41-25	Kabineti	28824	38935	10111	573	6,00%	5.6670952	
20	Pezho 505	05Z-42.25	Kabineti	17747	18325	578	59	7,00%	10.207612	
21	Kia	05z-43-25	DGJPK	70343	85599	15256	855.02	5,60	5.6044835	
Total						120.477	8.655.02	10.32%	7.1839604	

6. NJËSIA E PËRKTHYESEVE

Dokumentet e përkthyer nga Zyra e përkthimeve gjatë periudhës një vjeçare **01 Janar – 31 Dhjetor 2021** janë si në vijim:

Gjatë kësaj periudhe, Zyra jonë kemi përpiluar shumicën e procesverbaleve nga takimet e KK, KPF dhe Komiteteve të ndryshme si dhe kemi përkthyer dhe njëherit kemi lekturuar dokumentet si në vijim:

Procesverbale të Kuvendit, të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete të cilët janë komitete të rregullta, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, ku në total kanë qenë gjithsej **37** procesverbale ose **264** faqe të përkthyer dhe të lekturuara.

Rregullore Komunale - 3 ose **43** faqe të përkthyer.

Korniza Afatmesme Buxhetore – **22** faqe.

Lajme për UEB faqe – **120** lajme – **136** faqe të përkthyer.

Konkurse gjatë kësaj periudhe kemi përkthyer **4** konkurse apo **8** faqe të përkthyer.

Vendime të Kuvendit Komunal, kanë qenë gjithsej **69** vendime ose **76** faqe.

Vendime, Aktvendime, Ankesa, Kërkesa të ndryshme të drejtorive, të Zyrës Ligjore. të Zyrës së Gjendjes Civile etj. Kanë qenë gjithsej **26** apo **63** faqe të përkthyer.

Dokumente tjera, Tendere, Njoftime për Kualifikim dhe Njoftime për Anulim të Zyrës së Prokurimit – kanë qenë **3** dokumente ose **32** faqe.

Totali i gjithë këtyre përkthimeve është **713** faqe të përkthyer dhe të lekturuara nga Zyra e Përkthyesve dhe gjithashtu edhe përpilimi i disa procesverbaleve sipas kërkesës dhe përkthimi direkt në takime të ndryshme sipas kërkesës.

7. NJËSIA E ARKIVIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

Gjatë vitit 2021, Njësia e Zyrës Pritëse ka pranuar, ka evidentuar, ka klasifikuar dhe ka regjistruar lëndët nëpër librat interne si dhe shpërndarjen në njësi organizative të Administratës Komunale.

Në këtë tabelë paraqesim të dhënat për pranimit të kërkesave të qytetarëve:

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat për pranimin e kërkesave të qytetarëve, drejtuar Departamentit të Administratës Komunale.

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1.	Vërtetimi i dokumenteve nga origjinali	1845
2.	Përcjellja e shkresave përmes postës	2462
3.	Pranimi i shkresave në mënyrë rekomanduese	1054
4.	Pranimi nga Gjykata,Aktvendime,Aktgjykime,Propozime për Përmbarime	4522
5.	Vulosja e dokumenteve përmes Arkivit,Aktvendime,Aktgjykime,Vendime	31000
6.	Arkiva Digjitale-Lëndët për Arkiv	103854
	Totali:	144737



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E FINANCAVE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Sebahate Ajeti Sadiku
Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave

Drejtoria e Financave mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin e Financave Lokale, si dhe në të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës, hartoi raportin vjetor të punës për vitin fiskal 2021 përfshirë të dy sektorët e këtij programi buxhetor, duke paraqitur të arriturat, sfidat si dhe objektivat afatshkurtëra dhe atë në fushën e:

1. Të hyrave vetanake dhe
2. Shpenzimeve buxhetore

Programi ynë buxhetor në momentin e hartimit të projekt buxhetit për vitin fiskal 2021 përcaktoj në të njejtën kohë edhe objektivat buxhetore si në fushën e të hyrave dhe në atë shpenzimeve buxhetore gjithnjë duke respektuar në këtë rast qarkoret buxhetore të cilat ishin edhe baza e hartimit të planit të të hyrave vetanake si dhe planifikimit buxhetor të shpenzimeve.

Në të dy segmentet e përgjegjesisë së programit tonë buxhetor treguam performancë të mirë në inkasimin e të hyrave, duke ditur se edhe në vitin 2021 jemi ballafaquar me virusin COVID 19, dhe në të njejtën kohë ruajtëm stabilitetin fiskal duke ngritur edhe më tej shkallën e efikasitetit të shpenzimeve buxhetore, rezultati i së cilës është shpenzimi i mjeteve të grantit qeveritar në kuotën prej 99.26 %. Nga përqindja shihet se kemi një suficit në vlerë prej 212,596.31€.

Drejtoria e Financave gjatë vitit fiskal 2021 në vazhden e aktiviteteve dhe rezultateve të treguara u ballafaqua edhe me sfida të shumta sidomos në fushën e të hyrave vetanake. Zbatimi i vendimeve të qeverisë për menaxhimin e pandemisë (VIRUSI COVID 19) tek inkasimi i borxhit të tatimit në pronë, kjo sfida do të jetë e pashmangshme edhe në vitin 2022.

TË HYRAT VETANAKE

Me mbylljen e vitit fiskal 2021 në kuadër të fushës së inkasimit të të hyrave vetanake organizata jonë realizoj të hyra vetanake në vlerë 6,195,939.98€, kurse të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2021 janë 4,444,628.00€ (me buxhetin e aprovuar) ku shihet se kemi arritur ta realizojmë për 1,750,765.98€ më shumë në krahasim me planifikimin e të hyrave shprehur në përqindje kemi 139.39%.

Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas llojit të të hyrave


Të hyrat tatimore - Tatimi në pronë 2,510,636.31 €

Të hyrat jo tatimore-Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat 2,677,962.21 €

Të hyrat indirekte- Gjobat e trafikut 928,859.70 €

Të hyrat nga dënimet e Gjykatës 62,495.00 € dhe

Të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve 15,400.76 €



Lloji i të hyrave

Lloji i të hyrës	Planifikimi i THV 2021	Realizimi i THV Janar - Dhjetor 2021	Diferenca mes planifikimit dhe realizimit	Realizimi i të HV Janar - Dhjetor 2020	% e realizimit në raport 2021/2020	% e realizimit të THV 2021
	A	B	A-B	C	B/C	B/A
Tatimi në pronë	2,166,084.00	2,058,710.33	107,373.67	1,205,512.56	170.77	95.04
Tatimi në tokë	602,491.00	451,925.98	150,565.02	163,661.72	276.13	75.01
Taksat e bizneseve	50,000.00	6,307.30	43,692.70	24,340.00	25.91	12.61
Taksat e pajisjeve motorike	163,000.00	299,045.00	(136,045.00)	262,435.00	113.95	183.46
Të hyrat nga qiratë	120,000.00	39,286.44	80,713.56	20,092.20	195.53	32.74
Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit	400,000.00	1,104,478.14	(704,478.14)	795,658.98	138.81	276.12
Taksat për legalizimin e pronës	150,000.00	207,143.85	(57,143.85)	90,657.76	228.49	138.10
Taksa tjera komunale	200,868.00	621,818.07	(420,950.07)	226,071.60	275.05	309.57
Pagesat në lidhje me automjetet	215,870.00	991,354.70	(775,484.70)	638,078.50	155.37	459.24
Të hyrat nga çertifikatat	80,000.00	107,777.00	(27,777.00)	88,815.00	121.35	134.72
Të ardhurat nga arsimi	95,000.00	96,876.14	(1,876.14)	52,795.30	183.49	101.97
Të ardhurat nga shëndetësia	110,000.00	103,124.50	6,875.50	72,197.50	142.84	93.75
Të hyrat tjera	91,315.00	107,506.53	(16,191.53)	79,698.92	134.89	117.73
Totali	4,444,628.00	6,195,353.98	(1,750,725.98)	3,720,015.04	166.54	139.39

Në tabelë shihet se kemi arritur inkasim e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin fiskal 2021 dhe kemi tejkalim për shumë prej 1,750,725.98€ apo 39.39%

Pagesat në lidhje me automjetet janë:

Gjobat e trafikut.....928,859.70€ dhe


Gjobat e gjykatës.....62,495.00€

Gjithsej.....991,354.70€

Të hyrat tjera janë:

- Gjobat nga ofiqaria8,386.00€
- Gjobat nga Inspektoriati.....12,675.00€
- Pranimi teknik i lokaleve.....11,726.00€
- Shitja e shërbimeve.....4,406.50€
- Gjobat nga ins.urban.....3550.00€
- Gjobat mandatore HM.....3,475.00€
- Inspeksioni higjenik sanitar.....13,027.00€
- Të hyrat nga QPS.....13,027.00€
- Të hyrat nga kultura.....736.00€
- Të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve..15,400.76€
- Gjobat tjera Pylltari.....20,137.27€

Gjithsej..... 107,506.53€.



Grafiku: Krahاسimi të hyrave

**Raporti i punës për Njësinë e tatimit në pronë
Prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021**

Të hyrat nga Tatimi në Pronë prej 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 janë gjithsej
2,510,639.31€

Nr. rend.	Muajt	Viti 2020	Viti 2021	Krahasuar në %	Ngritje-Zbritje %
1	Janar	120,486.17	230,257.31	191.11	91.11
2	Shkurt	106,191.97	156,552.03	147.42	47.42
3	Mars	64,977.93	160,701.10	247.32	147.32
4	Prill	8,886.42	293,916.62	3307.48	230.74
5	Maj	44,115.97	198,336.92	449.58	349.58
6	Qershor	152,495.60	255,433.67	167.50	67.5
7	Korrik	165,631.00	233,015.86	140.68	40.68
8	Gusht	101,520.81	289,551.26	285.21	185.21
9	Shtator	109,395.84	199,599.00	182.46	82.46
10	Tetor	122,796.06	175,763.41	143.13	43.13
11	Nëntor	75,774.36	131,041.11	172.94	72.94
12	Dhjetor	296,902.15	186,468.22	62.80	-37.2
	Gjithsej	1,369,174.28 €	2,510,636.51 €	183.37	83.37

Të hyrat nga Tatimi në Pronë në krahasim me vitit 2020 kemi rritje prej **83.37%** e arsyeja është se gjendja shëndetësore nga pandemia COVID-19 ka qenë më e mirë këtë vit dhe përkushtimi i zyrtarëve dhe angazhimi i të gjithë stafit që të këtë të hyra sa ma shumë dhe vullneti i qytetarëve për t'i kryer obligimet ndaj shtetit ka ardhur deri tek ky rezultat.

Të hyrat nga Tatimi në Pronë për vitin **2021** janë 2,510,636.31€

Krahasuar me planifikimin vjetor për vitin 2021 prej **2,679,960.00€** janë realizuar prej **93.68%**

Përveç punëve rreth pagesave, në zyrën e tatimit në pronë janë kryer punë tjera, të cilat po i theksojmë në vijueshmëri:

- Kemi kryer punët dhe konsultimet me Agjencinë e Privatizimit, me Agjencinë e Pronës, Me Departamentin e Tatimit në Pronë, me Hekurudhën e Kosovës për pronat dhe obligimet tatimore që ka pa i kryer Hekurudha e Kosovës, kemi përgatitur lëndë për zyrën ligjore për rastet në Gjykata, ju kemi përgjigjur dhe ftesave nga ana e përmbauesve privat për pronat me obligime tatimore të tatimit në prone.
- Kemi kryer edhe punët përgatitore për inspektimin nga Departamenti i Tatimit në Pronë me sukses, kemi kryer edhe Inspektimin nga DTP me sukses.
- Kemi kryer nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm auditimin për vitin 2021.

Nga Zyra e Tatimit në Pronë janë kryer edhe këto punë:

Nr. rend.	Emërtimi	TM1/2021
1	Objekte të pa ndryshuara	18
2	Objekte të ndryshuara GPS	1089
3	Objekte të reja	811
4	Gjithsej i objekte të verifikuara	1918
5	Faturat të lëshuara për pagesë	51881
6	Vërtetime të lëshuara nga inkasantët	22919
7	Taksa për automjete	28914
8	Lëndë të regjistruara-ndryshuara në kompjuter	8237
9	Lëndë të shkarkuar nga interneti	630
10	Verifikim i parcelave që kërkohet nga AKP	9
11	Verifikim i parcelave që kërkohet nga palët	1970
12	Konsultim me palë	41250
13	Thirrje telefonike	0.00
14	Vendosja e lëndëve nëpër regjistrator që janë ndryshuar pronarët	1936

15	Ankesave ndaj faturës	108
16	Ankesa ndaj certifikatës së vlerës së vlerësuar	78
17	Kërkesë për korrigjim	305
18	Shqyrtim i Ankesave dhe Kërkesave për korrigjim	665
19	Vetdeklarim për posedim e pronës	164
20	Shqyrtim i vetdeklarim për posedim e pronës	0.00
21	Shpërndarja e vendimeve të ankesave	494
22	Vërejtje të përgatitura	0
23	Vërejtje të shpërndara	0
24	Bllokim të llogarive të tatimpaguesve	0
25	Debllokim të llogarive të tatimpaguesve	0
26	Procesverbale (njoftime)	0
27	Marrëveshje për pagesë	31
28	Gjetja e adresave të faturave të kthyer nga posta	200

Me fillimin e vitit:

- Kemi filluar me verifikimin e ndërmarrjeve shoqërore.
- Pastrimin e databazës nga gabimet dhe informatat e pasakta.
- Me përgatitjen e reformave tatimit në pronë për vitin 2022.
- Regjistrimin e pagesave nga viti i kaluar dhe të këtij viti si pagesa të dështuara nga sisteme elektronik.
- Verifikimi i afarizmit jo aktiv.
- Pranimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe shpërndarjen e vendimeve ndaj faturave të Tatimit në Pronë.
- Pranimin dhe shqyrtimin dhe shpërndarjen e vendimeve e ankesave ndaj certifikatës së vlerës së vlerësuar,
- Pranimin e shqyrtimin e kërkesave për korrigjim.
- Pranimin e kërkesave për vetdeklarim dhe regjistrimin e pronës në sistem protax.
- Pas shqyrtimit të lëndëve, zbatimin e vendimit nga operativa.
- Shpërndarjen e vendimit deri tek pala.
- Bartjen e ndryshimit të vendbanimit primar për obliguesin tatimor.

Janë kryer edhe punë tjera të ndryshme sipas kërkesave të palëve si konsultime të ndryshme, korrigjimi i lëndëve me gabime teknike dhe thirrje telefonike me palë për t'i përkujtuar se kanë afatin e pagesës, kanë obligime pa kryer, si dhe punë tjera.

Kërkojmë të mbështetet më shumë Zyra e Tatimit në Pronë me staf punues, me automjete për terren, me pajisjet kompjuterike, për të pasur sukses më shumë.

Raporti i buxhetit të realizuar komunal për periudhën Janar –Dhjetor 2021

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2021 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Për vitin 2021 kemi Ligjin e Buxhetit Nr.07/L-041 i aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës ,ku komuna e Ferizajt ka buxhetin në vlerë prej 34,208,507.00€ me këto burime të financimit:

- Granti Qeveritar janë 27,040,376.00 €,
- Të hyrat vetanake të vitit 2019 janë 4,444.628.00€,
- Huamarrja Klauzola Investive 2,723,503€

Mirëpo Buxheti i Komunës brenda vitit fiskal ka pasur lëvizje gjithnjë në rritje dhe vlera përfundimtare e buxhetit për vitin fiskal 2021 është 36,749,213.22€.

Në këtë vlerë buxhetore burimet e financimit janë nga:

- Granti qeveritar 28,726,717.88€
- Të hyra vetanake (viti 2021) 4,444,627.94€
- Financimi nga huamarrja 79,646.08€
- Huamarrja Klauzola Investive 2,723,503.00€
- Të hyrat vetanake të bartura (viti 2020) 661,268.78€
- Grant i donatorëve të mbrendëshëm 98,248.06€ (participimet për projekte në bujqësi),
- Donacion nga Save the Children 11,220.46 €,
- Qeveria Zvicrane 1.13€
- Donacion nga Council of Europe 3,979.89€.

Ndërsa shpenzimi i përgjithshëm i Buxhetit të Komunës është 35,241,146.41€. Është bërë një shpenzim i buxhetit prej 95.90%, në krahasim me mjetet buxhetore për këtë periudhë raportuse, pra për vitin 2021. Përqindja e shpenzimit të buxhetit nga të gjitha burimet e financimit është e kënaqshme.

SHPENZIMET FINANCIARE PËR VITIN FISKAL 2021

Një prej objektivave kryesore të Drejtorisë Financave gjatë vitit 2021 ishte përmbyllja me sukses e vitit fiskal

2021 duke realizuar planin buxhetor të shpenzimeve, sidomos atë me burim financimi nga Granti Qeveritar.

Buxheti përfundimtar i Komunës së Ferizajt për vitin fiskal 2021, është 36,749,213.22€ nga ky buxhet janë

shpenzuar 35,241,146.41€ me burime të financimit nga:

Granti Qeveritar në shumë prej 28,616,372.52€

Të hyrat vetanake 4,025,195.63 € .

Financimi nga huamarrja 79,476.98€,

Financimi nga huamarrja për klauzolën investive 1,779,340.18€

Të hyrat e bartura 656,349.06€,

Granti i donatorëve të brendshëm 79,675.76€

Save the Children 4,736.28€

Buxheti dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike Janar-Dhjetor viti 2021

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe mëditje	17,570,966.29	17,568,763.18	2,203.11	99.99
Mallra dhe shërbime	5,135,169.29	5,099,813.36	35,355.93	99.31
Komunali	700,312.85	699,321.02	991.83	99.86
Subvencione	1,110,364.00	1,101,032.83	9,331.17	99.16
Investime kapitale	11,872,181.19	10,772,881.64	1,099,299.55	90.74
Rezerva	360,219.00		360,219.00	-
Totali	36,749,212.62	35,241,812.03	1,507,400.59	95.90

SHPENZIMET NGA GRANTI QEVERTAR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE DHE PROGRAMEVE PËR JANAR - DHJETOR TË VITIT 2021 FB 10

Programet	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Komunali	subvencione	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT	80,224.85	183,044.12				263,268.97
ADMINISTRATA DHE PERSONELI	236,452.10	290,864.74	458,700.00			986,016.84
ZYRA E PROKURIMIT	22,432.59	2,304.28				24,736.87
ZYRA E KUVENDIT	135,689.39	18,156.94				153,846.33
BUXHETI DHE FINANCA	196,566.71	156,635.16				353,201.87
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE EMERGJENC	273,075.57	768,636.90	5,200.00		1,007,754.49	2,054,666.96
INFRASTRUKTURA PUBLIKE	41,795.41	10,594.53			2,966,576.30	3,018,966.24
ZYRA E KOMUNITETEVE	56,359.68	10,846.73	141.02			67,347.43
BUJQËSIA DHE PYLLTARIA	97,462.59	127,125.32			379,977.15	604,565.06
ZHVILLIM EKONOMIK	46,144.27	17,847.75			138,416.02	202,408.04
KADASTRA DHE GJEODEZIA	120,218.55	21,196.64			499,764.59	641,179.78
PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS	58,824.24	6,922.68			89,228.49	154,975.41
SHËNDETSIA	2,741,277.26	1,313,353.22	80,000.00		112,783.00	4,247,413.48
SHËRBIMET SOCIALE	102,952.21	22,366.91	6,000.00			131,319.12
SHERBIMET REZIDENCIALE	89,170.04	71,903.34	8,000.00		10,000.00	179,073.38
KULTURË, RINI DHE SPORT	390,789.75	148,259.00		18,580.00	75,072.60	632,701.35
ARSIM	12,800,096.91	1,026,599.96	141,280.00		933,008.52	14,900,985.39
GJITHSEJ	17,489,532.12	4,196,658.22	699,321.02	18,580.00	6,212,581.16	28,616,672.52

Buxheti nga granti Qeveritar dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike janar –dhjetor 2021

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe mëditje	17,489,897.74	17,489,532.12	365.62	100.00
Mallra dhe shërbime	4,216,708.14	4,196,658.22	20,049.92	99.52
Komunali	699,680.00	699,321.02	358.98	99.95
Subvencione	18,700.00	18,580.00	120.00	99.36
Investime kapitale	6,301,732.00	6,212,581.16	89,150.84	98.59
Totali	28,726,717.88	28,616,672.52	110,045.36	99.62

Në tabelë shihet se shpenzimet e mjeteve me burim financim Grant Qeveritar janë 28,652,305.43€ apo në përqindje 99.62% të mjeteve buxhetore, paga dhe mëditje janë 100.00% mallra dhe shërbime 99.52%, komunalit 99.95, subvencione 99.36 dhe investimet kapitale me 98.59%.

**SHPENZIMET NGA TË HYRAT VETANAKE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE DHE PROGRAMEVE
PËR JANAR - DHJETOR TË VITIT 2021, FB 21**

Programet	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Komunalit	subvencione	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT				49,860.00		49,860.00
ADMINISTRATA DHE PERSONELI		80,270.23			50,000.00	130,270.23
ZYRA E PROKURIMIT						-
ZYRA E KUVENDIT						-
BUXHETI DHE FINANCA		53,219.95				53,219.95
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE EMERGJENC		231,815.26		14,999.99	225,897.10	472,712.35
INFRASTRUKTURA PUBLIKE		10,818.59			2,068,974.85	2,079,793.44
ZYRA E KOMUNITETEVE						-
BUJQËSIA DHE PYLLTARIA		88,798.60		364,933.03	49,996.60	503,728.23
ZHVILLIM EKONOMIK						-
- Shfrytëzimi i mjeteve në të gjitha kategoritë ekonomike është bërë sipas periudhave të zotimit dhe deri në fund të gjitha mjetet që i kemi pasur në disponim i kemi shfrytëzuar;
- Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin – Planin e Prokurimit, kërkesat për prokurim, po ashtu bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave;
- Raportin e faturave të pa paguara për vitin kalendarik 2021;
- Pasqyrat financiare 2021.

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2021, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

- **Zhvillimi i punimeve për ndërtimin e shkollës së re "Ahmet Hoxha" në Ferizaj;**
- **Vazhdimi i punimeve të shkollës në fshatin Zaskok dhe fshatin Talinoc të Muhaxherëve;**
- **Fillimi i ndërtimit të Çerdhës së Fëmijëve në rrugën "Rexhep Bislimi";**
- **Vazhdimi i punimeve të shkollës së mesme në Komunën e Ferizajt;**
- **Vazhdimi i punimeve të shkollës profesionale në Komunën e Ferizajt;**
- **Renovimi i aneksit në shkollën "Jeronim De Rada" në Ferizaj;**
- **Rregullimi i oborrit të shkollës "Astrit Bytyçi";**
- **Shtrimi i dyshemesë së shkollave: "Vezir Jashari", "Muharrem Shemsedini", "Ali Hadri" dhe "Arsim Rexhepi";**
- **Ndërtimi i Sallës sportive në fshatin e Vjetër-Bibaj- është punuar deri në vlerën e 40.000,00 €;**
- **Ndërtimi i shkollës "Konstadin Kristoforidhi" Neredime, Ferizaj.**

Projektet që janë paraparë të bëhen renovimet e tyre në kuadër të projektit për efikasitet të Energjisë në Komunën tonë janë si më poshtë:

- SHFMU “Dituria“ Dardani.
- SHFMU “Bilall Shala“ Lloshkobare.
- SHFMU “Visar Dodani“ Varosh.

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor
Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët, dhe
Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellur dhe mbikqyrur përgatitjet e gjithëmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Takimet mujore të Task Focës, të mbajtura në QPS në Ferizaj;
- Është bashkëpunuar me Shoqatën e Biologëve, Matematicientëve, Fizicientëve dhe Kulturës Sportive në organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Në muajin Gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e Komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese, nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra;
- Është bërë Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, përmes Ekipës Vlerësuese;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmëvjetor janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj;
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2021 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellur respektimi i orarit mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizimin e mbajtjes të testit kombëtar për klasat e IX-ta (nuk është mbajtur) dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;

- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkurset e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtor administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Është bërë vlerësimi i brendshëm i performancës së drejtorëve të shkollave (gjithsej 18);
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASH;
- Kanë bashkëpunuar me IKSHPK duke përcjellur dhe raportuar me rregull në MASHT dhe SIA për numrin e të infektuarëve dhe të shëruarëve nëpër të gjitha shkollat e Ferizajt.

Poashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASH-in dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori në:

- Trajnimin e Stafit Udhëheqës të Shkollave për Menaxhimin e Institucioneve Shkollore;
- Trajnimin e Stafit Arsimor për zbatimin e Kurrikulës (përfunduar në muajin Korrik). Trajnimet janë realizuar në të gjitha fushat e Kurrikulës. Janë trajnuar gjithsej 162 mësime.

RAPORT MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS - 2021

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijën dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijës. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote, të mësojë së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Arsimi gjithëpërfshirës keqkuptohet si koncept që aplikohet vetëm tek fëmijët me nevoja të veçanta, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Në Kosovë, koncepti i edukimit gjithëpërfshirës, është kuptuar në formën më të kufizuar të tij, duke ngecur te sigurimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor / mësimdhënës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat ka bërë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për vitin 2021 vazhdimin e mbajtjes me informata të databazës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në nivelin komunal.

Në SHFMU “Ahmet Hoxha” funksionon me sukses Qendra për Mësim Shtesë, ku punohet me nxënësit që kanë ngecje në procesin mësimor e sidomos në shkrim lexim. Po ashtu kjo Qendër punon edhe me grupe të marginalizuara si komunitetet jo shumicë.

Zhvillimi i procesit mësimor në kushtet e pandemisë

Sfidë për Drejtorinë e Arsimit edhe këtë vit shkollor ka qenë pandemia Covid 19.

Viti i ri shkollor ka filluar me 27 Shtator. Shkollat kanë qenë mirë të përgatitura në aspektin teknik. Të gjitha shkollat janë pajisur me mjete higjienike, është bërë me kohë dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore si dhe është bërë vlerësimi higjienik edhe nga Inspektorati Sanitar.

Shkollat kanë filluar me sukses vitin e ri shkollor, por mësimi është zhvilluar sipas skenarit ‘Rikthimi’ dhe udhëzuesve të cilët kanë ardhur nga MASHTI. Pothuajse të gjitha shkollat kanë punuar me orë mësimore prej 40 minutash me përjashtim të shkollave “Gjon Serreçi”, “Dy Dëshmorët” dhe “Naim Frashëri” të cilat për shkak të hapësirës, kanë qenë të obliguara të punojnë me 30/35 minuta ora mësimore.

Periudha e parë e vitit shkollor 2021-2022 ka përfunduar me rregull dhe nuk ka rezultuar me probleme të theksuara me pandeminë.

NJËSIA E ARSIMIT PARAFILLOR

Në Komunën tonë funksionojë dy çerdhe të fëmijëve, IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “Engjujt” në partneritet publiko-privat. Gjithsej janë të regjistruar 446 fëmijë të përfshirë nga mosha 9 muaj deri në 6 vjeç.

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 në arsimin parafillor janë regjistruar 1689 fëmijë;

Në shkollën fillore klasat 1-5, janë regjistruar 8211 nxënës,

Në shkollën e mesme të ulët, klasat 6 – 9 janë regjistruar 6575 nxënës,

Në shkollat e mesme të larta, klasat 10 – 12 janë regjistruar 5934 nxënës.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë Klasa IX-të Viti shkollor 2020 – 2021

Këtë vit shkollor, Testit të Arritshmërisë i janë nënshtruar 1679 nxënës. Kalueshmëria ka qenë 49.42 %

REZULTATET E TESTIT TË MATURËS (Qershor-Gusht)

Në Testin e Maturës i janë nënshtruar 1887 nxënës. 1449 nxënës e kanë kaluar apo shprehur në përqindje 79.43 %, ndërsa numri i nxënësve të cilët nuk kanë kaluar Testin e Maturës është 20.57%.

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të mëdha në shumë dimensionë që është duke u ballafaquar arsimit në Republikën e Kosovës, ku ende nuk po mund të arrijmë një standard të dëshiruar që garanton zhvillim, përparim dhe stabilitet të qëndrueshëm, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2020/2021, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor, konstatojmë se edhe në këtë vit shkollor, përkundër situatës pandemike ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në Komunën e tonë, kjo vjen si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensionë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit që në Komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale për të realizuar objektivat e parapara në procesin edukativo-arsimor.

Prandaj, çdo vërejtje, apo sugjerim konstruktiv do të ishte i mirëseardhur dhe do të ndikonte në begatimin akoma të këtij raporti i cili do të jetë edhe më i plotë dhe në funksion të avancimit të çështjes së arsimit në përgjithësi.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Xhemile Murati Shabani
Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Hyrje

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Komunës së Ferizajt, me detyra, funksione dhe përgjegjësi institucionale, duke ushtruar punë menaxhuese, krijuese e organizative në këto fusha: në kulturë, rini, sport, biblioteka dhe në atë të arkivit. Në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, funksionojnë këta sektorë dhe njësi:

- **Spektori i Kulturës**
- Njësia e kulturës
- Teatri
- Galeria
- Muzeu
- **Spektori i Rinisë**
- **Spektori i Bibliotekave**
- **Spektori i Sportit**
- **Arkivi**

Kjo drejtori ka nën menaxhim disa objekte ku zhvillon punën dhe aktivitetet e saja.

Këto janë:

- **Teatri i Qytetit /Galeria/Muzeu**
- **Palestra e Sporteve**
- **Stadiumi i Qytetit**
- **Stadiumi në fshatin Tërrn**
- **Biblioteka e Qytetit**
- **Biblioteka në fshatin Neredime**
- **Biblioteka në fshatin Talinoc i Muhaxherëve**
- **Biblioteka në fshatin Komogllavë**
- **Biblioteka në fshatin Dardani**
- **Arkivi Historik**

Përveç këtyre objekteve, aktivitetet zhvillohen edhe në hapësira tjera publike, si:

Bulevardi i Qytetit

Sheshi i Qytetit

Skena Verore e Teatrit, etj

Projektet e përfunduara

1. Përfundimi i punimeve në fushën sportive në fshatin Lloshkobare.
2. Përfundimi i punimeve në fushat e pingpongut (Tabelat e Pingpongut), tabelat e shahut në fshatin Pleshinë.

Projektet e filluara ku ende vazhdojnë punimet edhe në vitin 2022

3. “ Pallati i Kulturës”
4. “Ndërtimi i fushave sportive në fshatrat e Ferizajt”
5. “Ndërtimi i fushave të pingpongut dhe tabelave të shahut” (Tabelat e Pingpongut)

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave, publikon thirrjen publike, ku fton të gjitha organizatat me karakter kulturor, sportive e rinor që të aplikojnë në këtë thirrje, si mundësi për financim të projekteve kulturore, sportive e rinore.

Në vitin 2021 janë përkrahur me subvencione 55 OJQ, kryesisht shoqata kulturore, klube sportive dhe organizata rinore. Gjithashtu janë përkrahur 40 artist, të rinj e sportistë të pavarur.

Librat e financuara për botim në vitin 2020 janë gjithsej 12 (dymbëdhjetë) , libra monografik dhe letrar.

Në vazhdim po japim planin e punës nga secili sektor veç e veç, ku janë të përfshira aktivitetet kryesore.

SEKTORI I KULTURËS

Sektori i Kulturës është një nga dikasterët që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Ferizaj. Ky sektor organizon aktivitetet kulturore të përbashkëta e të ndara, me grupet kulturore e komunitetin artistik,.Këto aktivitete shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillimvit, e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitete shtesë.

Në kuadër të Sektorit funksionojnë këto njësi:

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria e Arteve**
- **Njësia e Muzeut**
- **Teatri “Adriana”**

Aktivitetet dhe ngjarjet kulturore

Repertori mujor i Teatrit “Adriana” - Në këtë repertor të vitit 2021 janë dhënë shfaqje që janë prodhimtari e Teatrit “Adriana” si dhe shfaqje mysafire. Vlen të theksohet se Teatri “Adriana” kishte repertorin mujor gjatë gjithë vitit 2021.

Koloni Artistike ArsFer -Galeria e Arteve në bashkëpunim me SHAF "Zef Kolombi" organizuan koloninë artistike tre ditore "Arsfer" ku morën pjesë 40 artistë nga Kosova, Maqedonia e Shqipëria. Kolonia dhe Ekspozita janë organizuar në Galerinë e Arteve në Ferizaj. Më 17 Janar u bë hapja solemne e ekspozitës së kësaj kolonie, e cila mbeti e hapur deri më 10 Shkurt.

Teatri “Adriana” në Festivalin të Dramës Shqipe ‘Talia e Flakës –Gjilan - Shfaqja ‘Kontrolli dhe Makina e Dashurisë’ prezantoi në Festivalin të Dramës Origjinale Shqipe ‘Talia e Flakës – Gjilan. Shfaqja "*Kontrolli dhe Makina e Dashurisë*" me tekst dhe regji të Besim Ugzmajlit, në Festivalin "Talia e Flakës 2021" u vlerësua me çmimin "*Prurje e re për Kompozim Regjisorial*", si dhe me çmimin "Skenografia më e mirë".

Promovim i librit "Aromë Pranvere" të autores së re Suella Selimi-Në Galerinë e Arteve, u bë promovimi i librit me poezi "Aromë Pranvere" të autores së re Suella Selimi, ku prezantuan mysafirë të shumtë e kritikë të fushës.

Homazhe për humanistin Don Sandro - Me rastin e ndarjes nga jeta të priftit italian, humanistit *Don Sandro Sciaboletta*, Komuna e Ferizajt organizoi homazhe për nder të veprës dhe jetës së tij. Ai kishte kontribuar shumë sidomos në arsim e shëndetësi, duke dërguar afro 500 pacientë për shërim në Itali (kryesisht fëmijë), si dhe afër 100 studentë nga Ferizaj në univeristet italiane. Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm, Komuna e Ferizajt në vitin 2006, e dekoroi me titullin më të lartë “Qytetar Nderi”.

“Gostia” - Natë Poetike – Teatri i Qytetit “Adriana” me disa prej aktorëve të saj, prezantoi me një performancë poetike. U interpretuan poezi nga poetë tanë e botëror. Regjia: Sovran Nrecaj.

Hapja e manifestimit- 17 Shkurti- Dita e Pavarësisë.

Me një koncert për fëmijë dhe një aktivitet sportiv, filloi manifestimi tradicional kushtuar përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Kalendari mban aktivitetet kryesore kushtuar kësaj feste.

Ekspozita e Pavarësisë – Çmimi “Gursel Sylejmani” - Në një ambient festiv u hap ekspozita tradicionale e Pavarësisë, ku tradicionalisht ndahet çmimi special për punimin më të mirë "Gursel Sylejmani". Fitues i këtij çmimi u shpall artisti *Mervan Mustafa*. Ky aktivitet, u organizua nga Galeria e Arteve- Ferizaj në bashkëpunim me SHAF "Zef Kolombi", në shënim të 13 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Klubi Letrar “De Rada” ligjëratë kushtuar Festës së Pavarësisë - Sektori i të Rinjve i Klubit “De Rada” për nder të 17 Shkurtit organizoi takimin “*Rrugëtimi drejt pavarësisë*”, një bashkëbisedim me mysafirët e ftuar: Besim Zymeri, Fatbardha Zogaj, Gazmend Bytyçi, Fisnik Bislimi dhe Festim Kaqiku, të cilët shpalosën kujtimet e tyre nga periudha të ndryshme kohore, të viteve të trazuara të historisë më të re kombëtare. Në këtë takim morën pjesë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, të cilët treguan interesim të lartë për t’u njohur me të kaluarën.

Koncert Festiv - “Dita e Pavarësisë” - Në një atmosferë festive, në Teatrin "Adriana"- Ferizaj, u mbajt një koncert festiv me grupet e organizuara nga AMC Corporation, ku prezantuan me këngë e valle.

Promovimi i librit "Grafite në murin e kohës" nga autori Zymer Haliti - Në promovim morën pjesë mysafirë të shumtë, dashamirë të librit dhe kritik të fushës.

Ekspozitë kushtuar ditës së mësuesit - Në kuadër të shënimit të kësaj date, Muzeu i Qytetit në Ferizaj hapi ekspozitën me fotografi "Rrugëtimi i Shkollës Shqipe në Ferizaj".

Dita e Gruas- Vizitë e organizuar tek Mësuese Maria - Me një vepër artistike të piktores Rrezarta Halili, DKRS nderoi mësuesen e veteranen e kulturës znj.Maria Gjini, e cila në takim shpalosi kujtime nga eksperiencia e saj në arsim e kulturë.

Dita Botërore e Poezisë nga Klubi Letrar “De Rada” - Aktiviteti letrar “*Oda e Poezisë*” i organizuar në Galerinë e Arteve nga KL “De Rada”, është bërë një aktivitet mujor që mbledh dashamirët e librit nga mosha të ndryshme.

„Gratë në Parlament“ – Premierë teatrore ne Ferizaj - Me tekst të Aristofanit, me adaptim dhe regji të Elmaze Nurës, Teatri i qytetit “Adriana” vjen me premierën e re teatrore. Prezantojnë trupa e aktorëve të Teatrit “Adriana”.

40 vjetori i demonstratave 1981 - Ekspozitë me fotografi e artefakte - Në kuadër të shënimit të **40 vjetorit të Demonstratave të vitit 1981**, Njësia për Trashëgimi dhe Muze në bashkëpunim Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës prezantuan ekspozitën me dokumente dhe fotografi historike të kësaj ngjarje të rëndësishme historike me titull “Vullkani i Republikës”. Në kuadër të këtij përvjetori u organizua dhe Akademi Përkujtimore, u dha një program i larmishëm, ku prezantoi Kori i Qytetit, një video material i kohës.

Ditën e Monumenteve - Veç Muzeu i Qytetit që ka Ferizaj, ekzistojnë edhe disa muze private që mirëmbahen dhe koleksionohen nga dashamirë të trashëgimisë kulturore. I tillë është edhe Muzeu i Musa Emini që ka një pasuri me eksponate të shumta. Stafi i DKRS-së vizitoi këtë muze, pikërisht në Ditën e Monumenteve.

AKV "Kastriotët" Koncert për mjekë – “Ju faleminderit” - Orkestra e AKV “Kastriotët” bashkë me solistë, mbajti koncert falënderimi për stafin shëndetësor në prag të Ditës së Infermierisë, ku morën pjesë stafi shëndetësor ferizajas, ku dominuan nën tingujt e këngëve të muzikës së mirëfilltë popullore, me moton "Ju faleminderit", si nderim dhe falënderim për punën e stafit shëndetësor në Ferizaj.

Ligjerata në vigjilje të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve - Këto ligjerata i organizoi Njësia për Trashëgimi dhe Muze për nxënësit e shkollave të mesme kësaj radhe me Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit" të cilët patën rastin njihen me të kaluarën historike dhe trashëgimore të trevës së Ferizajt! Kjo ligjeratë u realizua në data 14-18 Maj.

Ekspozitë nga Trashëgimia Kulturore e Ferizajt - Në kuadrin e shënimit të 18 Majit - Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Muzeu i Qytetit sot ka bërë hapjen e ekspozitës para bibliotekës, ku u prezantua trashëgimia kulturore e trevës së Ferizajt.

Konferencë shkencore “Gjendja e muzeve gjatë pandemisë” - Kjo konferencë u zhvillua në vigjilje të 18 majit- ditës ndërkombëtare të muzeve. Nikoqire ishte Njësia për Trashëgimi e Muze e DKRS-së, ndërsa si panelistë prezantuan Prof. Dr. Ibrahim Gashi, Nora Prekazi, zyrtare e muzeut nga Mitrovica, Besim Qeriqi- doktorant i historisë. Konferencën e udhëhoqi gazetari Afrim Demiri.

Ekspozitë personale e karikaturës nga Imri Musliu - Imri Musliu- tani më është bërë i njohur me pjesëmarrjen e tij me karikatura në shumë prezantime e festivale ndërkombëtare. Në këtë ekspozitë ai prezantoi punimet e tij më të sukseshme të viteve të fundit. Ekspozita hapet pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Kulturës.

Hapja e manifestimit „Ditët e Kulturës“ 1-12 Qershor - Me një koncert për fëmijë, filloi manifestimi tradicional "Ditët e Kulturës".

Prezantim vizuel i veshjeve kombëtare shqiptare - Ky aktivitet u zhvillua nga Njësia për Trashëgimi e Muze, me mysafirët special Prof. Dr. Drita Halimi-Statovci, profesore universitare dhe Dr.Zanita Halimi profesore e antropologjisë. Aktivitein e pasuruan rapsodi i njohur ferizajas Nazmi Hajdari me lahutë dhe grupi i vajzave „Shamikuqet“.

Festivali "Fëmijët e Gëzuar"- Festival tradicional për Fëmijë “Fëmijët e Gëzuar”, shënoi edicionin e 33-të, këtë edicion e realizoi në kuadër të manifestimit „Ditët e Kulturës“. Ky festival zakonisht mbahet në mbështetje të DKRS-së, dhe është pjesë e kalendarit të aktiviteteve të DKRS-së.

Festivali i Recitatorëve - Në sallën e Teatrit "Adriana", u mbajt Festivali i Recitatorëve. Fokusi i këtij edicioni ishin nxënësit e shkollave fillore. Anëtarë jurie ishin: Gresa Gashi- aktore, Ali Krasniqi- aktor dhe Zyrafete Shala- shkrimtare, ndërsa Selektor Arben Marevci.

Dita e shkollës së Arteve „Çesk Zadeja“ - Në ditën e kësaj shkolle u prezantua një koncert me nxënës e pedagogë të shkollës, po ashtu edhe një ekspozitë nga arti pamor në Galerinë e Arteve. Shkolla e Arteve është promotor i shumë aktiviteteve kulturore në Ferizaj.

Tre aktorë të Ferizajt me pjesëmarrje filmi në Kanë. - Tre aktorë të Teatrit Adriana: Uratë Shabani, Vjosa Abazi, Blin Sylejmani, pjesë të filmit të Luana Bajramit, “Luaneshat e Kodrës”, film i cili u shfaq në Festivalin e Cannes. Ky film është filmi i parë i gjatë kosovar që shfaq premierën në festivalin më të rëndësishëm të filmit në botë, atë të Kanës. Ky film u përkrah nga DKRS-ja në organizimin e punëve teknike.

“Sofra Tradicionale”- aktivitet kulturor - Grupi i folklorit i AKV “Kastriotët” performoi në aktivitetin “Sofra Tradicionale”, ku u prezantuan ushqimet tradicionale shqiptare.

Ekspozitë me artefakte “Kosova në arkivin e shtetit shqiptar” - Nën përkujdesjen e Njesisë për Trashëgimi dhe Muze dhe Bibliotekës së Qytetit, Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës prezantoi ekspozitën me artefakte, me titull: “Kosova në arkivin shqiptar”, i cili aktivitet mbledhi njohës dhe dashamirës të historisë dhe kulturës. Veç folësve të tjerë, foli edhe drejtori i këtij agjencioni, z.Bedri Zyberaj i cili potencoi vlerat historike që mbart kjo ekspozitë. Ekspozita u mbajt në bibliotekën e qytetit.

Ekspozita kolektive “Ditët e Kulturës”- Kjo ekspozitë ka krijuar një imazh profesional duke mbledhur vepra artistike të përzgjedhura nga artistë të mbarë trojeve shqiptare. Kësaj here në ekspozitë morën pjesë 20 artistë, të cilët prezantuan mbi 30 veprat e tyre multidisiplinare, nga Ferizaj. Vepra fituese u shpall ajo e artistit z. Mujadin Nuhiu. Ekspozita mbeti e hapur deri në mesin e Korrikut.

Koncert Festiv - Trupa Artistike Regjionale - Në shënim të 12 Qershorit- Ditës së Çlirimit të Ferizajt, u prezantua një koncert festiv me program të përzgjedhur e këngëtarë të njohur nga estrada ferizajase si:

Veli Sahiti, Osman Shehu, Erëza Çerkini, Fadil Keca, Visar Çarkaxhiu, Bardhyl Abazi dhe Anisa Shabani, Orkestrimet: Shkumbin Azizi e Lulzim Shehu. Drejtor Artistik- Bardhyl Abazi.

Hapja e Festivalit MuralFest Kosova - Ndonëse MuralFest vazhdimisht krijon aktivitete me murale dhe evente të tjera kulturore (ligërata, trajnime etj), më 12 qershor zyrtarisht hapi edicionin e 6-të të këtij festivali. Ky edicion u shënua me disa murale dhe aktivitete të tjera, si dhe me mysafirë të shumtë nga SHBA, Spanja, Polonia etj.

Në ditën e fundit të këtij edicionit përkoi me Ditën Ndërkombëtare të Refugjatëve, duke u kthyer në 21 vjet më parë. Mural i cili iu kushtua të gjithë atyre që u detyruan të largohen nga vendi i tyre. Fotografia referencë nga fotografi Hazir Reka, që përfaqëson një refugjat kosovar, ditën kur gratë ishin ndarë nga burrat para se të largoheshin nga shtëpitë e tyre. (Reuters, 1999)

Gala koncert për Qazim Dushkun - Në Palestrën e Sporteve “Bill Clinton”, u dha koncerti memorial kushtuar figurës ferizajase dhe kosovare Qazim Dushku. Në këtë koncert morën pjesë këngëtarë eminentë nga estrada ferizajase dhe kosovare. Koncertin e organizoi Trupa Artistike Regjionale- TAR, ndërsa u mbështet nga DKRS.

Festivali i këngës për fëmijë Diamond Fest, edicioni 8-të - Në palestrën e sporteve “Bill Clinton”, u mbajt edicioni 8-të i festivalit DiamondFest.

Ekspozitë me artefakte nga mjeku Salih Krasniqi - Në Galerinë e Arteve u hap ekspozita e mjekut kosovar **Prof. dr. Salih Krasniqi**, me temën: **"Si u vra kodi etik i Hipokratit dhe si u shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës?"** Artefakte me tematika e luftës së fundit në Kosovë. Kjo ekspozitë mbeti e hapur deri më 26 qershor.

29 qershor - 30 vjetorit i themelimit të Lidhjes së Historianëve Shqiptarë "Ali Hadri" Në sallën e Teatrit “Adriana” u përkujtua themelimi i LSHS “Ali Hadri”, me seli në Ferizaj. Organizatori i këtij takimi Muhamet Shabani dhe kumtues të shumtë lidhur me këtë përvjetor, por edhe për rrjedhat e reja historike. Mysafir special ishte edhe historianja e njohur shqiptare, Elena Kocaqi.

“Mblesëri në Malësi” premierë e re teatrore në Ferizaj - Kjo shfaqje është produksioni më i ri i Teatrit “Adriana”, me tekst të Çehov-it, e në regji të Ekrem Sopit. Performuan trupa e Teatrit “Adriana”- Ferizaj.

Koncert Recital – Trio Moso - Në sallën e Galerisë së Arteve u dha një koncert i muzikës klasike nga grupi Trio Moso, i përbërë nga: Arjeta Krosa-flautë, Arbreshë Ademi-çelo dhe Rinor Aliu-piano. Në koncert u luajtën vepra të kopozitorëve botërorë, si Haydn, Tchaikovsky etj.

Festivali Ndërkombëtar i Karikaturës - Shoqata e Karikaturistëve „HiTHi“ përgaditi edicionin e 7-të të Festivalit Ndërkombëtar të Karikaturës në Ferizaj, ku prezantuan me punime nga aplikues të shumë nga e gjithë bota. Një mundësi e mirë për të parë këndëvshtrime të ndryshme artistike nga vende të botës përmes karikaturës. Përkrahës DKRS.

Kocert për piano dhe orkestër - Albana dhe Emi Çerkini

Një prej aktiviteteve të përkrahura nga thirrja publike e DKRS-së. Në piano përcolli Rinor Aliu. Në koncert u ekzekutuan vepra të zgjedhura nga Moxart, Bethoven etj.

Teatri Adriana mori pjesë në Festivalin e Teatrit Shqiptar në Dibër

Me shfaqjen “Vizita e Zonjës Plakë”, Teatri “Adriana” prezantoi në festivalin e Dibrës në Maqedoni.

Festivali i Pianos PIANO FEST – edicioni i 2-të - Në sallën e Teatrit "Adriana" u mbajt Festivali i Pianos PIANO FEST, edicioni i dytë, i organizuar nga profesorja e pianos Ylberina Isufi. Festivali nuk kishte karakter garues, por aty me talentin e tyre prezantuan pianistë të vegjël nga Kosova e Shqipëria.

Koncert recital në violinë - Fjolla Koxha - Në sallën e Teatrit „Adriana“ u dha një koncert në violinë nga Fjolla Koxha.

Aktiviteti Letrar „Muzat e Jezercit“ - Në fshatin Jezerc u mbajt manifestimi tradicional poetik "MUZAT E JEZERCIT", edicioni i 5-të. Në manifestim morën pjesë poetë nga Kosova e Shqipëria. U prezantuan botimet e të Klubit "De Rada" gjatë periudhës 2020/21, pastaj tryeza me temën “Kritika letrare shqipe sot”, diskutime e debate rreth letërsisë, orë letrare etj. Poashtu edhe kursi i poezisë udhëhequr nga poeti i njohur Xhevdet Bajraj. Nikoqir dhe organizator i kësaj ngjarje poetike është Klubi Letrar "De Rada"- Ferizaj. Manifestimi përfundoi më 24 Korrik me lexim të poezive.

DITËT E MËRGATËS – Ferizaj 2021 (26 Korrik – 09 Gusht)

U hap manifestimi tradicional „Ditët e Mërgatës“- Ferizaj 2021

Me një defile të përbashkët, koncert për fëmijë dhe disa prezantime sportive të kulbeve sportive për fëmijë, sot u hap manifestimi tradicional “Ditët e Mërgatës”. Ky manifestim përfshin një varg aktivitete, kryesisht kulturore, të cilat organizohen një shenjë mikëpritje për mërgimtarët tanë që vijnë në pushime.

Ekspozitë me fotografi historike - Muzeu i Qytetit, prezantim në formën vizuale, eksponate dhe fotografi nga e kaluara jonë historike, e sidomos që ndërlidhet me historinë e qytetit.

KONCERT PËR DITËT E MËRGATËS - Në pjesën ballore të nënkalimit të qytetit, u dha një rock koncert nga këngëtari ferizajas, Mentor Haziri. Koncerti u dedikojë mërgimtarëve tanë.

Festivali i këngës për fëmijë A-Mol - Festivali i këngës për fëmijë „A-Mol”, është një prej katër festivaleve në Ferizaj që organizohen në këtë fushë. A-Mol është në kalendarin e aktiviteteve të Sektorit të Kulturës.

Aktivitet kulturor "Tingujt e Zemrës" në fshatin Miroslav - Në kuadër të manifestimit “Ditët e Mërgatës”, zakonisht organizohet një aktivitet kulturor në mirëpritje të mërgimtarëve e quajtur “Tingujt e Zemrës”.

Dita Tradicionale "Bjeshkët e Jezercit" - Në kuadër të manifestimit “Ditët e Mërgatës”, zakonisht organizohet një aktivitet kulturor në fshatin Jezerc në mirëpritje të mërgimtarëve.

Gala koncert në sheshin e qytetit - Në sheshin e qytetit- Ferizaj, u mbajt një koncert me këngëtarët e njohur të estradës shqiptare: Kastriot Tusha & Arif Vladi, si dhe Melihate Kelmendi- Xhakli. Përcolli orkestra popullore AKV "Kastriotët".

Koloni artistike për mërgimtarë - Në organizim të Galerisë së Arteve dhe ShAF "Zef Kolombi" tradicionalisht organizohet një koloni artistike në Ferizaj, ku veç piktorëve ferizajas, marrin pjesë edhe artistë që jetojnë në mërgatë.

Punëtori për animacion me artistin nga Meksiko Pablos Guerneros - Një aktivitet që ka të bëjë me animacionin, u organizua nga FerFilm, me mysafirin nga Meksiko, Pablos Guerneros.

Panairi i Librit – Është hapur edicioni i tretë i Panairit të Librit, i organizuar nga Klubi Letrar “De Rada” në bashkëpunim me DKRS – Ferizaj. Në këtë panair morën pjesë mbi 30 shtëpi botuese.

Play Fest Festival - Festivali PlayFest është një aktivitet katër ditor që prezanton aktivitete të larmishme kulturore. Vendi i përzgjedhur ishte Parku i Lirisë, ku prezantuan grupe muzikore, të piktoreve, të filmit etj. Organizator Pëllumb Bekteshi.

Koncert për mërgimtarë AKV Kastriotët- Sheshi i Qytetit - Në sheshin e qytetit të Ferizajt, AKV “Kastriotët” dhanë një koncert për mërgimtarë.

Dokumentar për rapsodin Sadik Cokli - U shfaq dokumentari “Rrëfime për rapsodin Sadik Cokli”, në skenar dhe regji të Sabri Pajazitit. 47 vjet pas vdekjes së tij, doli në pah një dokumentar me rrëfime, një audio inçizim nga ky rapsod legjendar. Iniciator dhe realizator i këtij evenimenti ishte i biri Sadik Coklit, Osman Berisha, veteran i kulturës. Pas dokumentarit u ekzekutuan dy këngë nga Nazmi Hajdari- lahutë dhe SHKA "Mejdi Xhaferi"- Mirosalë, kushtuar Sadik Coklit.

Ekspozitën Historike për Mërgimtarë - Në kuadër të aktiviteteve për "Ditët e Mërgatës", Njësia për Trashëgimi dhe Muze, organizoi Ekspozitën Historike për Mërgimtarë. Në të u shpalosën pjesë të rëndësishme historike që ndërlidhen me trevën e Ferizajt. Ajo qëndroi e hapur në Bulevardin e Qytetit, para Bibliotekës së Qytetit "Sadik Tafarshiku".

Klubi Letrar "De Rada" – promovim libri - Në bashkëpunim me Shtëpinë botuese "OM", në Galerinë e Arteve në Ferizaj, promovuan vëllimin me poezi në gjuhën shqipe dhe angleze "Qysh me abortu dreqin" të autores Uresa Ahmeti.

Festivali i Fotografisë - Lens Fest – Në këtë vit erdhi edhe një festival i ri, e kësaj here nga fusha e fotografisë. Është fotografia Bardha Goga, e cila e themeloi festivalin e fotografisë Lens Fest. Në edicionin e parë prezantuan fotografë eminent nga Kosova, të cilët ndërkohë organizuan punëtori për të rinj në mësim të fotografisë. Festivali u realizua për pesë ditë radhazi, 20-24 Gusht.

FerFilm Festival - 5 net radhazi, 02-06 shtator, u mbajt edicioni i 9-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit –FerFilm. Gjatë këtyre netëve, u shfaqën filma të shkurtër të vendeve të ndryshme të botës, poashtu edhe aktiviteteve rekreative, në natën e fundit u ndanë mirënjohjet dhe shpërblimet. Triumfoi filmi i shkurtër “Paris, the mecca of parkour” nga Spanja, dokumentari më i mirë i shkurtër “Survival and school” – Ilir Kabashi nga Kosova, ndërsa filmi më i mirë i luajtur i shkurtër “The Other” nga Irani. U shpërblyen edhe filma të tjerë në kategori të tjera.

Në piano e stilit të vjetër vjen në Galerinë e Arteve - Një piano e stilit të vjetër erdhi si donacion Sektorit të Kulturës- DKRS-Ferizaj, nga Shoqata Humanitare kosovaro-zvicerane "Sytë Kërkojnë Dritë".

Manifestimi Letrar "Ora e Astritit" - Në sallën e Galerisë së Arteve u mbajt aktiviteti tradicional letrar "Ora e Astritit", të organizuar nga Klubi Letrar „De Rada“. Paraprakisht ishte hapur një konkurs disa ditor, ku kishin konkuruar shumë poetë me poezitë e tyre. Ndërsa më 28 Shtator u mbajt nata finale. Në këtë mbrëmje veç leximit të poezive, u ndanë edhe shpërblimet për fituesit. Me çmimin e parë u shpërblye poezia "Arti i Heshtjes" i Abdyl Hajredinit.

Punëtori me karakter artistik në Muze - Në kuadrin e aktiviteteve të Njesisë për Trashëgimi dhe Muze, në ambientet e Muzeut u mbajt, aktiviteti uorkshop me karakter artistik, ku u bë paraqitja në pikturë e artefakteve të Muzeut të trashëgimisë kulturore nga ana e nxënësve të shkollave të mesme të Komunës së Ferizajt.

Festivali i Teatrove - Gjatë shtatë netëve u mbajt Festivali i Teatrove- Ferizaj 2021, edicioni 50-51, cili solli shfaqje nga teatrot e qyteteve nga Prishtina, Prizreni, Gjakova, Podujeva, Gjilani e Ferizaj.

Në natën e fundit u ndanë edhe shpërblimet:

Çmimi i jurisë së gazetarëve: Ernest Malazogu.

Kostumografia më e mirë: Mentor Berisha - Teatri i Gjilanit.

Skenografia më e mirë: Petrit Bakalli - Teatri Bekim Fehmiu – Prizren.

Roli më i mirë episodik: Vlora Dervishi - Teatri Hadi Shehu – Gjakovë.

Roli më i mirë dytësor: – grua: Donikë Ahmeti - Teatri Dodona – Prishtinë.

Roli më i mirë dytësor: – burrë: Tristan Halilaj - Teatri AAB – Faruk Begolli.

Roli më i mirë – burrë: Ernest Malazogu - Teatri Bekim Fehmiu – Prizren.

Roli më i mirë – grua: Vjosa Abazi - Teatri Adriana – Ferizaj.

Çmimi special i jurisë: Takime në burg. – Teatri Avdush Hasani – Podujevë.

Regjia më e mirë: Blertë Neziraj – Kosovo for Dummies, Teatri i Gjilanit.

Shfaqja më e mirë: Provo edhe një herë, Sam. Regjisor: Ilir Bokshi – Prizren

Festivali për fëmijë Sidorela Fest - Eidicioni i V-të - Ky festival është pjesë e kalendarit të aktiviteteve të DKRS-së. Kandidatët u prezantuan në dy forma, playback dhe live. Fituese e vendit të parë në këtë edicion ishte Shqiponja Miftari me këngën “Pandemia“.

Premierë e re teatrore në Ferizaj, shfaqja “Fuego” - Shfaqja “Fuego” është në regji të Fadil Hysajt, ndërsa luajnë Bajrush Mjaku e Shpëtim Selmani.

Koloni artistike me piktorë - Shoqata e Artistëve Figurativ “Zef Kolombi” dhe Galeria e Arteve në Ferizaj, organizuan një koloni artistike ku morën pjesë 20 artistë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria, sipas kriterëve të caktuara. Më 7 Nëntor, u përmbyll solemnisht me hapjen e ekspozitës së kolonisë. Ekspozita qëndroi e hapur në Galerinë e Arteve edhe për disa ditë.

Bienali i Vizatimit- Edicioni i 5-të - Bienali i Vizatimit, tanimë e ka krijuar identitetin e vet artistik si një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe më serioze të artit pamor në Kosovë dhe më gjerë, që organizohet çdo dy vite në bashkëpunim me Galerinë e Arteve në Ferizaj, dhe me SHAF “Zef Kolombi”. Ky Bienal është konceptuar që të jetë në shërbim të promovimit të vizatimit si një nga fushat më të vjetra dhe më të rëndësishme të artit pamor. Në këtë edicion kanë konkuruar 41 artistë prej të cilëve juria ka përzgjedhur 18 artistë pjesëmarrës nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

„Kosovarja Këndon“- edicioni i 49-të - Në sallën e Teatrit “Adriana”- Ferizaj përfundoi edicioni i 49-të i Festivalit “Kosovarja Këndon”- Ferizaj 2021. Në praninë e një numri të konsiderueshëm të shikuesve, prezantuan 13 kandidatë nga vise të ndryshme të Kosovës (Gjilani, Podujeva, Prizreni, Ferizaj, Prishtina) dhe nga Preshava. Këngët i përcolli orkestra e AKV “Kastriotët” me formacion të zgjeruar, nën udhëheqjen artistike të Fitim Bytyçit. Në pjesën speciale prezantoi grupi i folklorit të ansamblit, nën udhëheqjen e Musa Ahmetit. Festivali ndau plaketë postmortum për profesor Fahri Beqirin, i cili ndërroi jetë këtë vit. Festivali së shpejti do të fillojë përgatitjet për vitin jubilar 50 vjetorin e themelimit, i cili do të mbahet në vitin 2022.

Orë letrare nga Klubi Letrar „De Rada“ - Një bashkëpunim i mirë në mes KL “De Rada” dhe Shoqatës së Shkrimtarëve “Oeneum” nga Tetova, të cilët organizuan një orë letrare të përbashkët në Galerinë e Arteve në Ferizaj.

4 dhjetor – AKV “Kastriotët” triumfojnë në festivalin e Rahovecit - Orkestra popullore e AKV “Kastriotët” me solistë, morën pjesë në Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës Popullore në Rahovec, ku triumfuan tek çmimet kryesore:

- Çmimi i parë - AKV "Kastriotët";
- Orkestra më e mirë - AKV "Kastriotët"
- Solisti më i mirë - Liridon Sadriu;
- Solistja më e mirë- Djellëza Dedushi
- Interpretja më besnike e këngës popullore - Anisa Shabani.;
- Çmimi i karrierës - Riza Bytyçi

Promovimi i librit “Lëmsh kujtimesh e përjetimesh”- Kanun Veseli - Në këtë promovim morën pjesë dashamirë të librit si dhe mysafirë të shumtë, pedagogë të autorit, si dhe u lexuan poezi të autorit nga disa të rinj.

„Ndeja me Borisin“ – premierë e re nga Teatri „Adriana“ - Teksti: Thomas Bernhard prezantoi regjisorja e re ferizajase: Enkeleda Simitxhiu.

Koncert solistik në piano - Orges Isufi - Në sallën e Teatrit “Adriana” u organizua koncert solistik me pianistin e vogël Orges Isufi, i cili kohëve të fundit po dëshmon suksese me talentin e tij.

13 Dhjetor –Koncert me fagotë - Në sallën e Galerisë së Arteve u mbajt një koncert instrumental me fagotë, ku prezantuan studentë dhe profesorë të këtij instrumenti.

Koncert me flautistët e vegjël - Në sallën e Galerisë së Arteve prezantoi grupi i flautistëve të vegjël nën udhëheqjen e profesoreshë Blenda Konxheli.

Ekspozita kolektive e Karikaturës në Ferizaj - Shoqata e Karikaturistëve HiTHi – Ferizaj, e përmbyll këtë vit kalendarik edhe me një ekspozitë. Këtë herë ekspozojnë karikaturistët e qytetit të Ferizajt: Nexhmedin Hasani – Trisha, Imri Musliu, Selajdin Hajdini e Agron Sejdiu.

Premierë teatrore "Marksistët dhe Leninistët e Zvicrës" - Teatri “Adriana” krejt në fundvit erdhi edhe me një premierë të re. Kësaj here ishte shfaqja teatrore "Marksistët dhe Leninistët e Zvicrës" në regji të Blerta Nezirajt.

Program kulturo-artistik për fundvit - Zakonisht Sektori i Kulturës organizon një mbrëmje festive për fundvit, ku prezanton raportin e punës, falënderime për bashkëpunëtorët, si dhe bëhet shpallja e artistit të vitit. Kësaj here në koncert prezantoi Trupa Artistike Regjionale me solistë të estradës ferizajase. Në këtë mbrëmje u shpall artisti i vitit - aktorja Uratë Shabani.

Viti 2021 ndonëse ende në një atmosferë me prezencën e pandemisë, në fund ishte vit i rezultateve dhe sukseseve në organizim dhe prodhim të aktiviteteve kulturore.

Në bazë të analizës së raportit dalin këto rezultate:

Në Muzeun e Qytetit kishte **60 vizita grupe të organizuara**, si dhe mbi 5000 vizitorë të Muzeut dhe aktiviteteve që ka organizuar kjo njësi.

Galeria e Arteve organizoi mbi dhjetëra aktivitete nga fusha e artit pamor, duke vazhduar me manifestimet tradicionale dhe aktivitetet e pavarura. Këtë vit Galeria kishte mbi 6000 vizitorë.

Teatri i qytetit „Adriana“, vazhdoi me repertorin e saj të rregullt, poashtu realizoj **pesë premiera teatrore**, organizoi Festivalin e Teatrove (edicioni 51-52), si dhe u kthye nga disa festivale me shpërblime. Për shkak të kufizimeve pandemike, nuk ka numër të saktë të pjesëmarrësve në teatër, por interesi dhe shikueshmëria e shfaqjeve ka qenë e tejkaluar.

Njësia e Kulturës, organizon edhe shumë aktivitete edhe të disiplinave të tjera si: koncerte, takime letrare, festival, manifestime kulturore etj. Gjatë vitit 2021 janë organizuar **149 aktivitete kulturore konkrete**, pa përfshirë këtu vizitat e shumta, takimet, dhe organizime të tjera të pavarura etj.

Biblioteka Komunale “Sadik Tafarshiku”

- Në vitin 2021 në Bibliotekë u anëtarësuan 1272, lexues të sektorit për të rritur dhe 1584 të sektorit për fëmijë, gjithsej 2856.
- Te sektori për të rritur u lexuan 7830 libra, te sektori për fëmijë 12780, gjithsej 20610 libra.
- U përpunuan dhe u inventarizuan 3189 libra për tu shpërndarë më pas në sektorët përkatës.
- Në sallën e informatikës ishin 1534 lexues kurse në sallat e leximit 12091 lexues.
- Në bibliotekën e fshatit Dardani u anëtarësuan 129 lexues me 250 libra të lexuara.
- Në bibliotekën e fshatit Komogllavë u anëtarësuan 160 lexues me 580 libra të lexuara.
- Në bibliotekën e fshatit Neredime u anëtarësuan 86 lexues me 890 libra të lexuara.
- Në bibliotekën e fshatit Talinoc i Muhaxherëve u anëtarësuan 65 lexues me 234 libra të lexuara.

Gjithsej 440 lexues me 1954 libra të lexuara.

Hapja e Këndit Arkivor nga Agjencia e Arkivit të Shqipërisë - Në Bibliotekën "Sadik Tafarshiku" në Ferizaj u hap Këndi Arkivor në Ferizaj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë i pasur me materiale të digjitalizuara. Në ceremoni prezantoi drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave në Republikën e Shqipërisë, z. Endrit Musaj, etj.

Aktivitetet që biblioteka i ka mbajtur në vazhdimësi janë anuluar për shkak të pandemisë.

Sektori i Rinisë

Sektori i Rinisë është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, e që merret me aktivitete rinore, takime edukative, kreative dhe prosperuese. Krahas ngjarjeve të organzuara nga DKRS, organizoi dhe udhëhoqi shumë aktivitete rinore me iniciativa të ndryshme.

Aktivitetet e Sektorit Rinisë kanë filluar me festat 5-7, dhe 8 Marsit që janë Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, 7 Marsi – dita e Mësuesit si dhe 8 Marsi - Dita e Gruas.

Orë historike - Në Bibliotekën e qytetit “Sadik Tafarshiku” anëtarët e KRFsë dhe Sektori i Rinisë, realizuan aktivitet tre ditor, projektit “Java e Edukimit dhe Letërsisë shqiptare”, Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt organizoi një diskutim me temë “Ndikimi i personaliteteve të shquara në historinë kombëtare shqiptare”. Së bashku u diskutuan shumë tema historike ku u informuan edhe për njohuri të reja.

Orë historike: “Rrugëtimi i shkollës shqipe dhe gruaja shqiptare në sytë e misionarëve të huaj gjatë viteve 1943-1945”. Të ftuar në cilësinë e panelit ishin dy historianë, të cilët mbajtën ligjërata “Për rrugëtimin e shkollës shqipe” dhe “Pikëpajmet e misionarëve anglez për femrën shqiptare”, në audiencë ishin Vullnetarët e Sektorit Rinisë dhe të rinjtë nga Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt.

Vizitë në Prekaz: - Së bashku me vullnetarët e Sektorit të Rinisë, anëtarët e organizatës Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt si dhe anëtarët e organizatës studentor Pro-Ars ishim të pranishëm në manifestimin kulturor “Nata e Zjarreve – Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” e cila u mbajt në fshatin Prekaz, në përkujtimin e Epopesë së Jasharajve.

Ecja me moton “Thank You NATO” – Ecje për te stanet e fshatit Dubravë ecje simbolike e të rinjve të qytetit me ushtarë të KFOR-it dhe nën kujdesin e profesionistëve të shoqërive bjeshkatore.

Dokumentar - Me datë 24 Mars në praninë e të rinjve të qytetit, pjesëtarëve të KFOR-it dhe anëtarëve të Shoqërive Bjeshkatore u shfaq dokumentari “NATO and Kosovo – The evolution of KFOR” që tregonte për arsyen e ndërhyrjes së forcave të NATO-së dhe rolin e saj në ndërtimin e institucioneve të sigurisë.

Pikturimi i të rinjve rreth digjitalizimit të industrisë së përpunimit të drurit - Të ftuar nga organizata REA në aktivitetin B2B, piktorët e rinj të cilët pikturuan digjitalizimin e industrisë së përpunimit të drurit duke u përshtatur me temën të cilën e kishin zhvilluar anëtarët e organizatës REA me kompanitë të cilët punojnë në atë industri.

Pastrim për nder të Ditës së Tokës - Në koordinim me KFOR- LMT, vullnetarët e Sektorit të Rinisë, Kuvendin e të Rinjve, organizatën rinore Pro-Ars, kemi pastruar tre parqe: Parkun e qytetit, Parkun Liria, si dhe Parkun e Pishave në fshatin Rahovicë. Të tre grupet janë ndarë në tre parqet, një pjesë e grupit të KFOR-it së bashku me Drejtoreshën e DKRS stafin dhe vullnetarët e sektorit kanë zgjedhur Parkun e Lirisë.

Orë letrare për nder të Ditës së Librit - Në mënyrë virtuale duke respektuar kushtet e pandemisë, duke bashkëpunuar me Klubin Letrar “De Rada” është mbajtur aktiviteti letrar për të diskutuar rreth librit “Ferma e Kafshëve” nga George Oruell. Aktiviteti është zhvilluar në formatin online duke përdorur Google Meeting me që rast të rinjtë kanë analizuar përmbajtjen e librit. Ky aktivitet u realizua më 23 prill në Ditën e Librit.

Ecje bjeshkatore - Së bashku me Shoqërinë Bjeshkatore Alpiniste “Kastrioti” me ushtarë të njësimit KFOR-LMT, kemi vizituar Kalanë e Novobërdës me që rast pjesëtarët e KFOR-it, janë njoftuar me historinë e kësaj kalaje. Po ashtu u vizituan edhe malet e Jezercit, përkatësisht Kalaja e Jezercit, pikave luftarake të UÇK-së, vendin e rënies së Dëshmorëve të Jezercit si dhe Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

Diskutim me të rinj për nder të të Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve - Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt organizoi aktivitetin e radhës në formë diskutimi, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve. U diskutua për problemet që kanë hasur refugjatët, kudo në botë në periudha të ndryshme kohore, por me theks të veçantë për refugjatët shqiptar të viteve 1998-99'. Bashkëbisedues me të rinjtë ishte edhe profesori i historisë, Besim Qeriqi.

Shpalosim kujtime nga e kaluara jonë e lavdishme - Sektori i rinisë në bashkëpunim me KRF-në organizoi aktivitetin e radhës, në formë diskutim të hapur me disa prej protagonistëve kryesor të 12 Qershorit të vitit 1999, në qytetin e Ferizajt, me ish ushtarët e UÇK-së, që të parët marshuan në qytetin e Ferizajt si ushtarët e lirisë. Panelistët shkëmbyen historitë e tyre të veçanta rreth 12 Qershorit 1999, me theks të veçantë në Zonën Operative të Nerodimes. Gjatë diskutimit u theksua nevoja e madhe për rritjen e aktiviteteve të këtij karakteri, në mënyrë që të rinjtë të njihen me historinë.

Tridhjetë e shtatë aktivistë dhe disa policë mbajtën në duar shkronjat e 5 emrave të viktimave në aksidentin fatal dhe disa porosi/thirrje për të respektuar shenjat dhe rregullat e komunikacionit.

Eja dhe shiko, zhvillimi i finales së kampionatit Evropian “Euro2020” - Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt me përkrahjen e DKRS Ferizaj, ka organizuar dhe shfaqur drejtpërdrejt finalen e Kampionatit Evropian “Euro 2020”. Në ngjarjen sportive janë paraqitur qytetarë të shumtë që janë pasionantë të futbollit.

Aktivitetet e legjislaturës së III-të në Kuvendi e të Rinjve në Ferizaj – Me përkrahjen e Sektorit të Rinisë u prezantuan aktivitetet e Legjislaturës III-të KRF ka realizuar një varg aktiviteteve të shkëlqyera dhe tejet produktive. Fokusi ynë mbetet në ndërtimin e politikave të orientuara në ruajtjen, mbështetjen dhe përfshirjen e gjeneratës së re. Në një ceremoni madhështore u përmyllë aktiviteti i Legjislaturës së III-të.

ROCK KONCERT ME TË RINJ - Në kalendarin e aktiviteteve për mëgimtarë, u dha edhe një koncert me të të rinj, organizuar nga Sektori i Rinisë.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë - Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit organizoi zhvillimin e aktiviteteve sportive me të rinjtë e qytetit tonë për nder të 12 Gushtit- Ditës Ndërkombëtare të Rinisë. Në aktivitet morën pjesë dhe e ndihmuan aktivitetin edhe Klubi i Pingpongut “Gani Maloku” dhe të rinj nga Komuna jonë të cilët janë pjesë e grupeve rinore.

Kampi i Vullnetarizmit - Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt, realizoi projektin Kampi i Vullnetarizmit, të përkrahur dhe financuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Ferizajt. Projekti Kampi i Vullnetarizmit u zhvillua në hapësirat e bregdetit shqiptar. Qëllimi i projektit ishte ngritja e kapaciteteve tek të rinjve përmes trajnimeve të ndryshme, mirëpo edhe relaksimi i tyre pas një periudhe të vazhdueshme të angazhimit në aktivitete vullnetare.

Turneu në futbal - U turneu i futbollit në Sallën e Sporteve "Bill Clinton", turne ky i organizuar nga Sektori i Rinisë- Ferizaj, pjesëmarrës ishin të rinj nga shkollat e mesme. Turneu përfundoi me fitues skuadrën e FC Mani, kurse vendin e dytë e zuri skuadra e FC Gzimi.

Trajnim me Play International. Të rinjtë e qytetit vazhduan me pjesëmarrje edhe në trajnimin e dytë, të organizuar nga organizata Play International, trajnimi, ka të bëjë me lojërat socio-sportive, e cila aplikohet tek fëmijët e moshave të mesme. Këto mësimë që kanë marrë të rinjtë, do t'i aplikojnë në praktikë me fëmijët, në shkollat e Komunës së Ferizajt.

"Rinia në Vullnetarizëm" - Projekt i cili implementohet nga organizata Vizioni Rinor i Shalës. Aktiviteti "Nata e Filmit 2", u zhvillua në ambientet e Qendrës së Kulturës në Ferizaj, ku pjesëmarrës ishin edhe disa nga deputetët e Kuvendit të të Rinjve të Ferizajt.

Java e KFOR - Tetor u zhvillua dita e parë e aktivitetit të përbashkët mes Sektori i Rinisë- Ferizaj, Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt si dhe KFOR LMT, ku si terren zgjodhëm ecjen nga Restorant "Bulica" deri te antena në Luboten. Në aktivitet morën pjesë vullnetarë nga Sektori i Rinisë, Kuvendi i të Rinjve, Rin-On, si dhe pjesëtarët e KFOR-LMT.

Në bashkëpunim me Qendrën e Kompetencës. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e shkollës së mesme profesionale Qendra e Kompetencës në Ferizaj, ku pjesëmarrësit akumuluan leksione teorike dhe praktike, nga ushtarët amerikan të KFOR-it, rreth ndihmës së parë.

Në kuadër të kampanjës "Java e KFOR-it", u mbajt aktiviteti i radhës i titulluar Movie Night, ku morën pjesë disa nga deputetët tanë, por edhe të rinjtë e qytetit tonë, si dhe pjestarët e ekipës LMT të KFOR-it amerikan. Këto aktivitete mbahen me qëllim të socializimit dhe argëtimit në mes të rinjve.

Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste Lybeteni në bashkëpunim me Sektorin e Rinisë – DKRS Ferizaj organizuan ecje dimërore në fshatin Jezerc të Ferizajt. Shtegu prej 14 Km ishte po aq tërheqës dhe sfidues për shkak të terrenit me lagështi dhe pjesëmarrësit kaluan një të diele të bukur, të fundit për vitin 2021.

Ceremonia e Çmimit “Vullnetari i Vitit” - Pas punës së komisionit të pavarur të krijuar për të shpallur këtë çmim, ata vendosën që çmimi për "Vullnetarin e Vitit" 2021 i takoi Lorik Krasniqi i cili njëherit udhëheq me Organizatën Rinore, Kuvendi i të Rinjve të Ferizaj. Një çmim tjetër kishte përgatitur këtë vit komisioni për vullnetarin e vitit, çmimin "Aktivisti rinor i vitit 2021", çmim i cili i takoi aktivistit rinor, Vullnet Ilazi.

SEKTORI I SPORTIT

Spektori i Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, e që merret kryesisht me aktivitete sportive. Këto aktivitete realizohen duke iu referuar planit të punës të përpiluar në fillimvit e në disa raste mund të ndryshohen duke iu përshtatur rrethanave.

Ky sektor organizon aktivitetet sportive të përbashkëta me klubet sportive e komunitetin sportiv me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe me Federatat Sportive. Krijon kusht për mbarëvajtjen e aktiviteteve të klubeve sportive e të sportistëve.

Viti 2021 ishte vit i vështirë për Sektorin e Sportit. Ky vit ka sjellë vështirësi të mëdha për shkak të pandemisë dhe në masë të madhe ka dëmtuar klubet sportive si në procesin stërvitor ashtu edhe në zhvillimin e lojërave kampionale, por megjithatë DKRS dhe klubet sportive janë përpjekur që mos t'i ndërpresin aktivitetin sportiv.

Fillimisht po japim gjeneralet e klubeve sportive për vitin 2021 ku janë të përfshirë në organizimin e sportit ferizajas gjithsej 54 klube sportive dhe 4 shoqata sportive, të cilat janë të organizuar mjaft mirë në zhvillimin e sportit në Komunën e Ferizajt.

Në të gjitha klubet sportive janë të përshira në të dy gjinitë me të gjitha grupmoshat, duke u përfshirë nga grupmosha U 7 deri tek seniorët, çka do të thotë se në Komunën tonë kemi diku rreth 5300 sportistë.

Në këtë periudhë pandemike të vitit 2021, shumica e klubeve sportive aktivitetet stërvitore i kanë mbajtur në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton”, Stadiumin e Qytetit “Dardania”, poashtu janë shfrytëzuar dhe hapësira tjera publike, gjithashtu edhe garat e planifikuara, turnet dhe lojërat miqësore janë realizuar, duke i respektuar masat anti-covid.

Stërvitjet e realizuara gjatë vitit 2021

Spektori i Sportit kujdeset për infrastrukturën fizike-sportive që të krijoj kushte sa më të mira për zhvillimin e orëve stërvitore dhe garave të ndryshme sportive. Njëkohësisht po krijohen edhe terrene të reja sportive edhe nëpër fshatrat e Komunës së Ferizajt, në këtë mënyrë aktivizojmë jo vetëm klubet aktive por edhe komunitetin në fshatra.

Pallati i Sporteve “Bill Clinton” – Klubet sportive kolektive dhe individuale e sportit të pavarur, aktivitetin e tyre e realizojnë në Palestrën e Sporteve. Stafi i Sektorit të Sportit kujdesen për lehtësimin e realizimit të aktiviteteve sportive.

Në Pallatin e Sporteve në Ferizaj gjatë vitit 2021 janë realizuar gjithsej 4706 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të Palestres kryesisht janë klubet sportive të Komunës së Ferizajt e në disa rastet edhe klubet sportive nga komunat fqinjë.

Lojë Kampionale - Në Pallati i Sporteve “Bill Clinton “ janë realizuar gjithsej 202 (dyqind e dy) lojë kampionale, 8(tetë) lojë për kupë dhe 5 (pesë) lojë miqësore.

Në Palestrën e Sporteve janë realizuar dhe dy koncerte kulturore, për përgatitjen e pjesës teknike të aktivitetit është përkujdesur Sektori i Sportit.

Stadiumi i Qytetit “Dardania - Në stadiumin e qytetit në Ferizaj janë realizuar 770 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të stadiumit të qytetit janë kryesisht klube të futbollit të Komunës së Ferizajt.

Në Stadiumin e qytetit janë zhvilluar përpos stërvitjeve edhe lojë me rëndësi– Janë zhvilluar 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) lojë kampionale, 1(një) lojë për Kupë, 1 (një) lojë miqësore dhe 3(tre) turne.

Aktivitete Sportive

Kuvendet e rregullta të punës dhe ato zgjedhore - Sektori i sporteve në bashkëpunim me klubet sportive kanë organizuar kuvendet e punës. Gjatë muajit Janar dhe Shkurt të gjitha klubet sportive të Komunës së Ferizajt, kanë mbajtur Kuvendet e rregullta të punës dhe ato zgjedhore, ky organizim i kuvendeve ishte në pajtueshmëri me MKRS-në dhe KOK-un, si objektiv që të riorganizohen të gjitha kuvendet e klubeve.

Të gjitha këto kuvende janë monitoruar nga DKRS, gjegjësisht nga Sektori i Sporteve, por në disa raste monitorues ishin edhe zyrtarët nga Federatat Sportive.

Turneu në Volejboll, Institucionet e Komunës së Ferizajt (femrat) - Komuna e Ferizajt gjegjësisht DKRS për nder të 17 Shkurtit organizoi turneun e institucioneve në volejboll (femrat), pjesëmarrëse ishin 6 ekiye të organizatave punuese, në vendin e parë u rendit Polica Rajonale. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe mirënjohje nga Sektori i Sportit.

"Ecja pranverore" – Me një pjesëmarrje masive prej mbi 300 pjesëmarrësve, Shoqëria Bjeshkatëre Alpiniste Lybeteni nga Ferizaj për herë të tetë me radhë organizoi Ecjen Pranverore 2021. Ky organizim tradicional në Ferizaj u organizua në bjeshkët e bukura të Pleshinës dhe Burrnikut, me pjesëmarrjen e mbi 15 shoqërive, klubeve apo grupeve të ndryshme nga të gjitha trojet tona.

Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe - Është organizuar kampanja me letër të bardhë , në bashkëpunim me klubet sportive në Ferizaj për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim e Paqe. Mesazhi është dhënë përmes letrës së bardhë, për të nxitur paqe dhe mirëkuptim, për të nxitur ndryshim në shoqëri, zhvillim në komunitetin sportive që manifestohet përmes fuqisë së sportit.

Dita Olimpike 2021 – Për nder të Ditës Olimpike në bulevardin e qytetit të Ferizajt, u mbajt vrapimi me fëmijët të lindur në vitin 2008. Kjo garë e vrapimit ishte e organizuar mjaft mirë në bashkëpunim me KOK-un dhe Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj. Në këtë garë vrapimi morën pjesë në vrapim fëmijet e të dy gjinive, të lindur në vitin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Ditët e Mërgatës - Më disa demonstrime sportive, me pjesëmarrjen e shumë klubeve sportive, u hap manifestimi tradicional “Ditët e Mërgatës”. Ky manifestim shënohet edhe me aktivitete të shumta sportive, të cilat organizohen një shenjë mikëpritje për mërgimtarët tanë që vijnë në pushime.

Ecje në natyrë - DKRS dhe shoqëritë bjeshkatore në kuadër të aktiviteteve për mërgimtarë, u organizua edhe një ecje bjeshkëve në bashkëpunim me shoqëritë bjeshkatore ferizajase. Ky rrugëtim ishte i përbashkët me pjesëmarrjen e shumë bashkatdhetarëve që jetojnë larg vendlindjes.

U vizituan istikamet e UÇK-së te pika 1 dhe Kalanë e Jezercit më pas vazhduan rrugëtimin te pika 6, e më pas në Livadhet e Kishës, ju bashkuan organizimit të shoqatës "Jezerci" e cila për mërgimtarët, kishte organizuar një program të pasur kulturo-sportiv.

Ecje për Ditë të Dëshmorëve – Nën organizim të Shoqërisë Bjeshkatore Alpiniste Lybeteni dhe në bashkëpunim me shoqëritë bjeshkatore nga Ferizaj e në përkrahje të Komunës së Ferizajt, u organizua ecja tradicionale, për të pestën herë me radhë me rastin e Ditës së Dëshmorëve të Ferizajt- 28 Shtator dhe 23 vjetorin e Epopesë së UÇK-së në Jezerc.

Turneu memorial në Volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” - Nën organizimin e DKRS dhe KVF “Ferizaj” u mbajt turneu memorial në Volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” ku ishin pjesëmarrës 4 ekipe nga Kosova të cilat treguan një cilësi të lartë të lojës së volejbollit. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa nga organizatori.

Garat shkollore lokale dhe regjionale - Në Pallatin e Sporteve u organizuan garat shkollore, lokale dhe regjionale në dy gjinitë ku morën pjesë të gjitha ekipet nga shkollat e Komunës sonë, si dhe ekipet nga Komuna e Shtimes, Lipjanit, Kaçanikut , Shtërpçës dhe Hanit të Elezit. Edhe në këtë garë tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa si dhe dy vendet e para fituan të drejtë të marrin pjesë në garën finale që mbahet në Prishtinë.

Garat Republikane – Në Komunën e Ferizajt në bashkëpunim me Sportin Shkollor u realizuan edhe garat republikane në sportin e volejbollit dhe atë të pinpongut.

Turneun memorial në Pingpon “Ahmet Hoxha” - Klubi i Pingpongut “Ahmet Hoxha” dhe DKRS organizuan turneun memorial ne Pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës dhe shpërbleu tri vendet e para me kupa dhe medalje.

Turneu për Veteranve në Pingpong “Gani Maloku” - Klubi i Pingpongut “Gani Maloku” në bashkëpunim me DKRS-në organizuan turneun e veteranëve në Pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, ku tri vendet e para u shpërblyen me kupa dhe medalje.

Gara në Automobilizëm - Nën organizimi Klubit të Automobilizmit “Ferizaj”, me përkrahjen e DKRS-së u mbajt gara malore në automobilizëm ku morën pjesë një numër i madh i garuesve nga gjitha klubet e Kosovës të cilat zhvilluan garat në disa kategori të ndryshme në të dy gjinitë. Tri vendet e para u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje.

TË ARRITURAT NË SPORT PËR VITIN 2021

KV “Ferizaj”M - Klubi i Volejbollit “Ferizaj”, meshkujt është Kampion i Kosovës me Seniorë për stinorin vjeshtor dhe fitues i Kupës së Republikës së Kosovës. Ky klub ka të organizuara mjaft mirë edhe grupmoshat e reja.

KVF “FerVolly”- Klubi i Volejbollit “FerVolly”, Femrat , është Kampion në Superligën B, fitues i kupës së Federatës, fitues i Kupës në BeachVolley për grupmoshta: U18 , U22.

K SH. “Ferizaj” – Rezultate dhe sukseset në vitin 2021 kishte dhe Klubi i Shahut ”Ferizaj, është fitues i Kupës së Kosovës dhe pjesëmarrës i shumë garave tjera në nivel të Kosovës, ku dhe u shpërblye me shumë medalje dhe kupa në turne të ndryshëm.

KPP “Ahmet Hoxha” - Është fitues i kupave dhe medaljeve në kategoritë e ndryshme, sidomos me grupmosha të reja është edhe fitues i Kupës së Kosovës për juniorë.

Autoklubi “Ferizaj” - fitues i kupave dhe medaleve në kategoritë e ndryshme të automobilave si në gara vendore ashtu edhe në gara ndërkombëtare. Autoklubi “ Ferizaj” i ka të organizuara te dyja gjinitë që janë vazhdimisht aktiv në sportin e automobilizmit.

Sportet tjera individuale - Klubet e karatesë, xhudos, notit dhe boksit, i kanë sjellë qytetit të Ferizajt 837 medalje nga turnetë e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Medalje Evropiane në Ferizaj - Behije Mustafa, garuese e Klubit “Fituesi” në Ferizaj është garuesja e parë që qytetit të Ferizajt i ka sjellë Medaljen e Bronzët Evropiane në Karate.

Arkivi Historik

Arkivi Historik Komunal përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt me rrethinë dhe vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë vitit 2021, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dhe vendosur nëpër rafte dokumentacionin arkivor. Dokumentacioni arkivor që gjendet në Arkiv është përpunuar detajisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Gjatë vitit 2021 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsej 46 qytetarë që i kemi shërbyer në mënyrën më të mirë të mundshme, duke i respektuar kornizat ligjore, duke ju shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në Drejtoritë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndëve. Gjatë vitit 2021 në kryerjen e punës në Arkivin Historik jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

- 1.Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore;
- 2.Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde;
- 3.Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde;
- 4.Sistematizimi i lëndëve arkivore në fonde;
- 5.Mbrojtja teknike;

Gjatë këtij viti kemi arritur të krijojmë edhe 2 fonde të reja (fondi komisionit informues dega LDK, fondi daktilografisë) si dhe përpunimi i materialit nga fondet e viteve paraprake.

- 1.Përpunimi i fondit, dëmet e shkaktuara nga okupatori serb gjatë luftës 1998-99
- 2.Përpunimi i fondit, lista e pagave të bashkësisë lokale të KKF
- 3.Përpunimi i fondit për mbrojtje dhe siguri viti 1971-1979
- 4.Fondi i komisionit informues dega LDK 1995/96
5. Fondi Universiteti i punëtorëve daktilografisë çertifikata nga viti (1984-1993)



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2021

Abetare Kurti Maliqi
Drejtores e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraprakisht ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm të punëve dhe aktiviteteve në vitin paraprak, me qëllim të identifikimit të të gjitha sfidave që do të merren si bazë në përcaktimin e objektivave kryesore për vitin 2021, për të dy sektorët – Sektorin e Shëndetësisë dhe Sektorin e Mirëqenies Sociale.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka vlerësuar si të domosdoshme mbajtjen e takimeve konsultuese me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional si dhe udhëheqës të njësive për përcaktimin e objektivave. Konkluzion i përbashkët i këtyre takimeve ishte se bazë e përcaktimit të objektivave për vitin 2021, do të jetë buxheti që kemi, duke u fokusuar në objektivat më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor që drejtpërsëdrejti do të reflektonin në nivelin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për një mirëqenie shëndetësore më të mirë për qytetarët tanë.

Objektivat e Sektorit të Shëndetësisë për vitin 2021

- Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë (permanente)
- Ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm që do të reflektojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe llogaridhënies;
- Ndërmarrja e veprimeve preventive për Covid 19, angazhimi permanent në trajtimin e të infektuarëve me këtë virus, duke bashkërenditur koordinimin ndërinstitucional të institucioneve në nivel lokal dhe atë qendror;
- Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2021;
- Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore;
- Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor;
- Avancimi profesional specifik për mjekët familjarë ekzistues;
- Ngritja e aktiviteteve të Njesisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor;
- Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera;
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore;
- Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet;
- Promovimi i shëndetit të gruas dhe fëmijës;
- Vazhdimi i vizitave sistematike në shkolla dhe çerdhe, analiza e rezultateve dhe ndërmarrja e veprimeve për përmirësim;
- Edukimi i stafit për trajmin e diabetit dhe shputës diabetike;
- Angazhim në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, DSHMS, respektivisht Sektori i Shëndetësisë, si çdo herë është angazhuar të jetë në përputhje me planin e punës dhe objektivat periodike të përcaktuara për secilën periudhë të vitit, si në periudhën tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe periudhën përfundimtare njëvjeçare. Por fatkeqësisht me vazhdimin e pandemisë Covid 19 shpeshherë jemi atakuar nga rrethana mjaft sfiduese ngase i tërë personeli shëndetësor ishte i angazhuar në parandalimin dhe trajtimin e Covid 19, dhe kjo gjë na pamundësonte që disa realizimin e disa objektivave, si për shembull aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor, vizitat sistematike nëpër shkolla dhe çerdhe, etj.

- **Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë dhe ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm**

Ushtrimi i kontrollit të brendshëm është objektiv i yni që ka për qëllim ngritjen e përgjegjësisë, disiplinës në punë dhe llogaridhënies. Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli asnjëherë nuk kemi qenë tolerantë ndaj të papërgjegjshmëve dhe kemi kërkuar nga menaxhmenti i QKMF-së që çdoherë të ndërmerren veprime ndaj kujdo qoftë që nuk respekton orarin dhe disiplinën në punë.

- **Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2021**

DSHMS çdo herë ka qenë e angazhuar për përfitimin e donacioneve nga donatorët; falë angazhimit të kreut komunal dhe DSHMS-së është arritur Marrëveshja e Mirëkuptimit mes Komunës së Ferizajt dhe "Qatar Charity" me datë 29.10.2020, ku jemi përfitues të ndërtimit të një Qendre të Mjekësisë Familjare në Softaj. Më 21.09.2021 është bërë përrurimi i kësaj qendre ku ofrohen shërbime shëndetësore për banorët e këtij fshati, respektivisht edhe për banorët e fshatrave Softaj, Pojatë, Rahovicë dhe Papaz, si dhe për qytetarë të tjerë që gravitojnë rreth kësaj qendre.

- **Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore**

DSHMS si prioritet ka rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore kundrejt qytetarëve tanë, ngase konsiderojmë se niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve është i mirë dhe çdoherë i kushtojmë vëmendje çdo ankese të palëve që cenojnë nivelin e shërbimit.

Sa i përket ndërtimit të QMF-së në Prelez të Muhaxherëve, DSHMS-së me kohë ka marrë të gjitha veprimet procedurale për implementim të këtij projekti, për të cilin nga ana e operatorit kontraktues është bërë hartimi i projektit për këtë qendër, ky projekt është në procedurë e sipër në Zyrën e Prokurimit.

- **Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor**

Në bazë të hulumtimeve dhe në konsulltim me menaxhmentin e QKMF-së vlerësohet si domosdoshmëri rritja e numrit të mjekëve familjarë, duke marrë për bazë numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës sonë. Prandaj, në vazhdimësi do t'i trajtojmë me prioritet Specializimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor.

- **Avancimi profesional specifik për mjekët familjarë ekzistues**

Ngritja profesionale kadrovike çdoherë ka qenë dhe do të jetë prioritet i yni, si e tillë është një kriter esencial që ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Në bazë të raporteve që kemi nga Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare gjatë vitit 2021 në përputhje me planin dhe programin e edukimit specialistik në mënyrë të vazhdueshme bëhen trajnime në ngritjen profesionale shëndetësore ku janë zhvilluar shumë aktivitete – punëtori me mjekë familjarë, mjekë të përgjithshëm, si dhe infermierë që punojnë në kuadër të QKMF-së në Ferizaj.

- **Ngritja e aktiviteteve të Njesisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor**

Njësia e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor ka zhvilluar shumë aktivitete promovuese edukative për përmirësimin e shëndetit të popullatës; në kuadër të edukimit dhe promovimit shëndetësor janë mbajtur shumë ligjërata nëpër shkolla.

- **Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera**

Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera është bërë në bazë të kërkesave nga njësiti kryesore pranë QKMF-së.

- **Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore**

Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është në kontinuitet dhe çdo herë intervenimet bëhen sipas nevojës; paraprakisht bëhet një vlerësim i infrastrukturës së objekteve shëndetësore nga ana e kompetentëve të QKMF-së.

- **Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet**

Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së dhe SHBK-së, ka për qëllim njohjen, më për së afërmi, me zhvillimet dhe aktivitetet si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohen për të gjetur forma dhe mënyra të rrugëzgjdhjes.

- **Promovimi i shëndetit të gruas dhe fëmijës**

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionon Qendra për Shëndetin e Gruas dhe Fëmijës që është në mbështetje për gratë, që nga fillimi i shtatzënisë deri pas lindjes, që është një hap i rëndësishëm progresiv për shëndetin e nënës. Ky shërbim ka një rëndësi të veçantë në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, si dhe në identifikimin e hershëm të sëmundjeve.

- **Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe shputës diabetike**

Shërbimi për trajtimin e diabetit është shërbim që funksionon në kuadër të QMF-së II, që nga viti 2011, si shërbim preventiv dhe shërues në kuadër të KPSH-së. Ky shërbim tani ka formuar edhe grupet vetëmbështetëse me prindërit e fëmijëve me diabet, që kanë për qëllim edukimin e pacientëve, shkëmbimin e përvojave dhe ofrimin e mbështetjes nga grupi. Me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së këtij shërbimi, stafi i trajnuar bart përvojat e mira tek stafi i ri shëndetësor për ruajtje të kontinuitetit të këtij shërbimi tejet të rëndësishëm.

- **Angazhim në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, si me ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore**

Gjatë vitit 2021 në DSHMS, respektivisht në Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte zhvillimi i politikave shëndetësore konform infrastrukturës ligjore në fuqi, që rregullon sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësor, duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime sa më dinjitoze dhe cilësore.

Jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për t'u bërë dhe angazhimi ynë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida jo të tejkalueshme, si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, për këtë arsye edhe jemi angazhuar të gjejmë alternativa të tjera që nga të hyrat nga participimi të furnizohemi me barna esenciale që sado pak t'i mbështesim qytetarët tanë.

Një sfidë e vazhueshme është mungesa e ligjit mbi sigurimet shëndetësore, gjë që pamundëson posedimin e një sistemi të mirëfilltë shëndetësor.

DSHMS është transparente për punën dhe aktivitete që zhvillon kundrejt hierarkisë institucionale lokale dhe qendrore, si dhe ndaj qytetarëve. Kjo transparencë pasqyrohet edhe në vazhdim të këtij raporti ku do të bashkëngjeshim raportin njëvjeçar të QKMF-së.

RAPORT PUNE - QKMF

Shkurtesat

AMC – Action for Mothers and Children
AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare
AMFK - Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës
CDF – Community Development Fund
DAT - Dispanseri Antituberkular
DSHMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DMF – Departamenti i Mjekësisë Familjare
ESP - Edukimi Specialistik Postdiplomik
EVP - Edukimi i Vazhdueshëm Profesional
IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IRSHPK – Instituti Rajonal i Shëndetit Publik të Kosovës
KAN – Kujdesi Antenatal
KD – Këshilli Drejtues
KP – Këshilli Profesional
KPSH – Kujdesi Primar Shëndetësor
MSH - Ministria e Shëndetësisë
OBSh - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OIK - Oda e Infermierëve të Kosovës
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare
QTMF – Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare
QZHVP – Qendra për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional

MRCPG – Medical Royal College of General Practitioners

SISH - Sistemi Informativ Shëndetësor

SHEP - Shërbimi Emergjent Primar

UNHCR _ United Nations High Commissioner for Refugees

UNICEF - United Nations International Children's Emergency Fund

ZHVP - Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2021 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të vitit 2021, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së rekomandimeve të paracaktuara për vitin 2021, të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH
3. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH
4. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional
5. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve.
6. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në AMF të komunës sonë
7. Funksionalizimi i laboratorëve nëpër QMF në fshatra.
8. Krijimi i një planstrategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare.
9. Aktivizimi i ordinancës stomatologjike në shkollën fillore *Tefik Çanga*, nëse përmirësohet situata epidemiologjike me COVID - 19.
10. Implementimi i tërësishëm i SISH-it dhe programit të SMSF-së.

Mirëpo edhe gjatë këtij viti prioritet ka vazhduar të jetë menaxhimi i pandemisë COVID-19, organizimi i ekipeve për ofrimin e ndihmës profesionale për personat e infektuar, testimi, përgatitja, fillimi dhe zhvillimi i fushatës së vaksinimit kundër COVID-19.

Aktivitetet dhe takimet

Më 12.01.2021 është mbajtur takimi virtual me drejtorët e QKMF-ve të të gjitha Komunave të Kosovës, i organizuar nga MSH në bashkëpunim me IKSHPK. Në këtë takim jemi njoftuar për hapat që janë ndërmarrë lidhur me planifikimin dhe sigurimin e vaksinës kundër COVID 19. Kjo fushatë e vaksinimit, më e madhja e ndërmarrë ndonjëherë në tërë botën, duke përfshirë edhe Kosovën, do të bëhet përgjatë viteve 2021-2022 . Në fazën e parë të vaksinimit është parashikuar të vaksinohen këto grupe të popullatës së rrezikuar:

- Punëtorët shëndetësor
- Të gjithë personat mbi 65 vjeç
- Të gjithë personat me sëmundje kronike.

Më 12.03.2021 - Përfaqësues të KFOR-it Amerikan, Justin Schlake rreshter dhe Minica Miranda - ushtarë, vizituan Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, me qëllim të njoftimit me masat e ndërmarra kohët e fundit, për menaxhimin e situatës së pandemisë COVID 19. Veç tjerash u diskutua edhe për vaksinimin e popullatës me vaksinën anticovid dhe përgatitjet që janë bërë në këtë drejtim. Mysafirët u njoftuan për angazhimet rreth zbatimit të planit shtetëror të vaksinimit, të ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe përgatitjeve të bëra në QKMF lidhur me evidentimin e personave që do të vaksinohen në fazën e parë.

Më 13.01.2021 - janë dërguar në MSH tabelat e plotësuara me të dhëna për profesionistët shëndetësor të rregullt, ata të angazhuar në QKMF përmes Caritas Kosovës dhe ata me kontratë si staf mbështetës, si dhe tabela tjetër me të dhëna për qytetarët e komunës së Ferizajt sipas grupeve të rrezikut: të personave mbi 65 vjeç dhe atyre me sëmundje kronike. Këto të dhëna janë kërkuar me qëllim të planifikimit më të drejtë të mbulueshmërisë së popullatës me vaksinë kundër COVID - 19.

Më 25.03.2021 - është mbajtur takimi online i grupit punues për Programin e Vizitave Shtëpiake, për kujdesin për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjet. Takimi është organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, me përkrahjen e Zyrës së UNICEF-it, me mjetet financiare të qeverisë së Luksemburgut. Të ftuar ishin drejtorët e QKMF-ve, anëtarët e grupit punues të programeve për vizita në shtëpi, përfaqësues të MSH-së dhe përfaqësues të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Në këtë takim, ku u diskutua për vështirësitë e krijuara gjatë pandemisë me COVID 19, u prezantua raporti i punës së realizuar nga ekipet tona dhe u ngritën disa shqetësime që, po e pengojnë në njëfarë mënyre rrjedhën e punës, si mungesa e mbushjeve të telefonave dhe vështirësitë për të komunikuar përmes telefonit me gratë e komunitetit RAE, për shkak se nuk posedojnë telefona personal.

Më 24.03.2021 - në mënyrë simbolike është shënuar Dita Botërore kundër Tuberkulozit, me një aktivitet më ndryshe për shkak të pandemisë, organizuar nga koordinatori për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, si dhe nga personeli i palodhshëm i Dispanserit Antituberkular dhe pulmologut. Me këtë rast, para mediave lokale, në formë të shkruar janë dhënë mesazhe për ndërgjegjësimin e popullatës, për pasojat e rënda shëndetësore, sociale dhe ekonomike që sjell tuberkulozi, si dhe rritjen e përpjekjeve për t'i dhënë fund epidemisë së tuberkulozit. Faktikisht, pacientëve me tuberkuloz u është rrezikuar shëndeti më shumë për shkak të pandemisë, sepse e kanë imunitetin më të dobësuar.

Më 19.04.2021 - Bashkë me Koordinatorin për këshilla për gjidhënie znj. Minire Shabani është pritur në vizitë znj. Hana Buçinca - zyrtare e programeve në "Aksionin për Nënë dhe Fëmijë - AMC". Kjo vizitë kishte për qëllim shtimin e motivimit të stafit mjekësor në ndërgjegjësimin e nënave të reja për rolin e pazëvendësueshëm të të ushqyerit me qumësht gjiri dhe rëndësinë që ka në rritjen e imunitetit të foshnjave. Njëherësh janë sjellë donacion disa posterë muri dhe 480 broshura me mesazhe për promovim të gjidhënies.

Më 22.04.2021 - Koordinatorin për monitorimin e procesit të vaksinimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë-së, z. Niman Bardhi, ka vizituar QKMF-në në Ferizaj, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të rrjedhës së procesit të vaksinimit kundër COVID-19. Z. Bardhi e vlerësoi si shumë të mirë organizimin e procesit të vaksinimit, ndërsa me drejtoreshën dhe udhëheqësit e tjerë të QKMF-së, diskutuan rreth përgatitjeve shtesë të nevojshme për ofrimin e shërbimit të vaksinimit me kapacitet më të lartë, pas furnizimit të radhës me vaksina anti-covid nga MSH.

Më 03.04.2021 - Në Ferizaj ka filluar vaksinimi i punëtorëve shëndetësor me vaksinën Astra Zeneca kundër Covid-19. Planifikimi për rrjedhën e procesit të vaksinimit ka filluar disa ditë më parë, me ç'rast janë hartuar listat ku janë përfshirë punëtorë shëndetësor nga të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private: mjekët, infermierët, punëtorët administrativë, punëtorët teknikë etj. 1560 vaksinat e sjella në kuadër të kontigjentit të parë janë dhënë deri në ditët e fundit të muajit Prill.

Më 12.05.2021 - Është shënuar 12 Maji - Dita Ndërkombëtare e Infermierëve me një ekspozitë të fotografive të punës së stafit shëndetësor gjatë pandemisë, organizuar nga infermierët e QKMF-së. Ky organizim, ku mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu e zyrtarë të tjerë të Komunës, u mbajt në sheshin e qytetit të Ferizajt.

Më 13.05.2021 - pas furnizimit me 500 doza të vaksinave Astra-Zeneca, ka vazhduar procesi i vaksinimit kundër COVID-19 te personat e grup moshave mbi 65 vjeç, sipas Kalendarit Shtetëror të Vaksinimit.

Më 31.05.2021 - U shënuar Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit me një varg aktiviteteesh nga Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor i QKMF-së në bashkëpunim me IRSHPK.

Më 11.06.2021 - Ne turneun e volejbollit të institucioneve të komunës së Ferizajt, organizuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për nder të 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të qytetit tonë, Ekipi i QKMF – së zuri vendin e parë.

Më 15.06.2021 – Dita e Shëndetësisë në Ferizaj u shënua në sallën e Teatrit “Adriana” me një manifestim ku u promovua monografia “Infermiera Ferizajase” nga autorët Agim Hajdini, Bashkim Mehmeti dhe Rexhep Jakaj.

Më 17.06.2021 - nga Drejtoresha e DSHMS-së, znj.Abetare Kurti-Maliqi dhe Drejtoresha e QKMF-së, është pranuar një kontigjent prej 10 000 maskash nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me qëllim të përballimit sa më të lehtë të pandemisë nga ana e personelit shëndetësor.

Më 22.06.2021 - Organizata *Interantional Charity Organization* nga Katari, me seli në Prishtinë, ka bërë hapjen e pusit për furnizim me ujë në QKMF 1.

Më 30.06.2021 - nga Caritas Kosova kemi pranuar në shfrytëzim një veturë të re (Citroen Elyesse). Ky donacion është mbështetur në aktivitetet e kontraktuara në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosovës.

Më 07.07.2021 – Oda e Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës ndau mirënjohje për infermierët e Kujdesit Primar, Sekondar dhe Terciar, për kontributin, sakrificën dhe profesionalizmin e treguar gjatë pandemisë COVID-19. Mirënjohjen për stafin infermior të qendrës sonë e pranoi kryeinfermieri i QKMF-Ferizaj.

Më 13.07.2021 - Menaxhmenti i QKMF-së priti në vizitë rreshterët Nathion Foster dhe Ethan Neuton të KFOR-it Amerikan. Në këtë takim u diskutua për situatën e qetë aktuale me koronavirus dhe rrjedhën e procesit të vaksinimit anticovid. Në fund të takimit, të dyja palët u dakorduan për organizimin e trajnimeve për personelin e Shërbimit Emergjent Primar, për intervenime emergjente në rast të traumave të ndryshme.

Më 06.08.2021 - Në zyrën e Kryeshefit të QKMF-së me një ceremoni modeste u përcoll në pension infermieri Gafurr Azemi që për vite me radhë ka kontribuar në QKMF. Z. Gafurr Azemi u nderuar me një mirënjohje dhe një orë dore.

Më 13.08.2021 - Pas kërkesës së menaxhmentit të spitalit, Këshilli Drejtues i QKMF-së mori vendim që deri në qetësimin e situatës me COVID-19, t'i jepet në shfrytëzim Spitalit të Përgjithshëm hyrja kryesore e objektit të SHEP-së me të gjitha hapësirat, kurse hyrja dytësore me korridor, me banakun për shfrytëzimin e telefonit, zhveshtorja dhe dhoma e personelit, dhomat e shefit dhe kryeinfermierëve në katin e parë, si dhe dy apo më shumë dhoma të Repartit të Kirurgjisë për infuzione, t'i mbeten në shfrytëzim të përkohshëm stafit të QKMF-së, deri në lirin hapësirave të SHEP. Në vendim u theksua se objekti jepet dhe pranohet në gjendje të rregullt nga komisioni adekuat i të dy institucioneve.

Më 05.09.2021 - Tri ekipet mjekësore të vaksinimit anti-covid të QKMF-së, pas 230 të intervistuarve, vazhduan me vaksinimin e më se 155 refugjatëve-azilkërkues afganë. Përveç vaksinimit, QKMF-Ferizaj, ka ndihmuar ekipet mjekësore të NATO-s edhe me një autoambulancë për nevojat shëndetësore të azilkërkuesve afganë.

Më 16.09.2021 - Në funksion të sensibilizimit për imunizim kundër COVID-19, ekipi mobil i Qendrës së Vaksinimit në Ferizaj, ka vaksinuar 84 qytetarë të komunitetit RAE, ndërkohë që 48 janë vaksinuar në Qendrën e Vaksinimit në Ferizaj.

Më 16.09.2021 - Në fshatin Softaj u përurua objekti i QMF 9, projekt ky realizuar me investimin e përbashkët mes Komunës së Ferizajt dhe organizatës "Qatar Charity". Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast, krahas punëtorëve shëndetësor dhe banorëve vendës, ishin të pranishëm edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, Ambasadori i Shtetit të Katarit, Shkëlqesia e Tij, Ali bin Hamad Al-Marri, drejtori i organizatës "Qatar Charity" në Kosovë, Essam Dabab, drejtori i Marketingut dhe Zhvillimit në "Qatar Charity", Abdulaziz Jassim Al Hejji, Drejtoresha e DSHMS-së, znj. Abetare Kurti-Maliqi.

Më 21.09.2021 - Në shenjë falënderimi për bashkëpunimin ndërinstitutional, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt, Dr. Halit Gërbeshi nderoi me mirënjohje menaxhmentin e QKMF-së, për përkrahjen e ofruar me hapësira të punës dhe personel infermierik me qëllim të ofrimit të trajtimit mjekësor për çdo pacient me COVID-19.

Më 21.09.2021 - Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu në kuadër të vizitës së institucioneve shëndetësore publike të qytetit, vizitoi edhe QKMF-në, me qëllim të falënderimit të personelit për kontributin e dhënë në menaxhimin e pandemisë COVID 19 në Ferizaj.

Më 29.09.2021 - Stafi menaxherial i tre institucioneve shëndetësore të Ferizajt ishin të ftuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Kazermën „Skënderbeu” ku u pritën ngrohtësisht nga znj. Irfete Spahiu-Gjenerale e Brigadës dhe z. Sejdi Ahmeti-Komandant i QSB-së. Përveç vizitës së kazermës, krerët e institucioneve shëndetësore shprehën vullnetin për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet shëndetësisë dhe FSK-së.

Më 30 shtator në lagjen Sallahane, më **1 tetor** në fshatin Dubravë dhe më **4 tetor** në lagjen "Halit Ibishi" në Zyrën për komunitetet, Ekipi i Shërbimit të Vaksinimit të QKMF-Ferizaj, ka mbajtur ligjërata senzibilizuese për komunitetin rom, egjiptas dhe ashkalinj me qëllim të vetëdijesimit për rëndësinë e vaksinimit kundër Covid 19.

Më 01.10.2021 - Në kuadër të Tetorit-Muajit të Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, QKMF në Ferizaj, përmes faqes zyrtare njoftoi qytetarët se edhe këtë vit ofron falas shërbimet e mamografisë. Në këtë njoftim iu bë apel grave të Regjionit të Ferizajt që të shfrytëzojnë këtë mundësi për të evituar dilemat dhe rreziqet lidhur me kancerin e gjirit, sepse zbulimi i hershëm i tij sjell rezultate më të mira. Ndërsa më 5 tetor QKMF ka ofruar edhe një numër telefoni për caktimin e terminëve për mamografi.

Më 07.10.2021 - Nga Ministria e Shëndetësisë iu dorëzua QKMF-së në Ferizaj automjeti Xhip Mitsubishi (veturë frigorifer), për nevojat dhe aktivitetet e shërbimeve shëndetësore, si bartja e vaksinave dhe barnave. Dorëzimi i kësaj veture u bë sipas marrëveshjes së lidhur ditë më parë mes Ministrit të Shëndetësisë, Dr.Arben Vitia dhe Kryetarit të Komunës së Ferizajt z.Agim Aliu. Akti i pranim-dorëzimit u bë në Prishtinë, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Më 13.10.2021 - në QKMF u organizua diskutimi lidhur me Draft-ligjin për infermierinë. Në këtë takim morën pjesë udhëheqësit e OIK-ut dhe përfaqësues nga institucionet shëndetësore të Ferizajt: QKMF, Spitali i Përgjithshëm, Qendra e Shëndetit Mendor dhe Qendra Rajonale e Shëndetit Publik. Diskutimi ishte mjaft konstruktiv dhe u dhanë shumë propozime, vërejtje dhe konsultime lidhur me Draft-ligjin që po hartohet.

Më 15.10.2021 - përfunduan punën specialistët e grupit të dytë, të cilët prej 15 Gushtit kanë qenë të angazhuar nga Ministria e Shëndetësisë në vaksinimin e qytetarëve të Komunës sonë kundër Covid 19. Në shenjë falënderimi për kontributin e tyre të çmuar në vaksinimin e qytetarëve, menaxhmenti i QKMF-së bashkë me ekipin menaxhues të vaksinimit anti-covid ndanë mirënjohje për pesëmbëdhjetë specialistët e të dy grupeve, praktikë kjo që do të vazhdojë edhe për stafin tjetër në fund të këtij viti. Të njëjtën ditë për grupin e tretë të specialistëve, Dr.Drita Emini ka mbajtur trajnimin për vaksinimin anti-covid.

Më 19.10.2021 - për nxënësit e klasave të gjashta, në shkollat fillore të Ferizajt, ka filluar vaksinimi sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit nga OBSH. Për procesin e vaksinimit, paraprakisht janë njoftuar drejtorët e shkollave, e përmes tyre edhe prindërit e nxënësve. Së pari janë vaksinuar nxënësit e shkollave në qytet, ndërsa ditët në vijim vaksinimi ka vazhduar edhe në shkollat e fshatrave të komunës sonë.

Më 20.10.2021 - Menaxhmenti i QKMF-së priti përfaqësuesit e Qendrës së Kompetencës me të cilët u diskutua rreth vazhdimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy institucioneve. Për dallim nga marrëveshjet e mëparshme, ku përfshihej vetëm praktika e nxënësve të Qendrës së Kompetencës në QKMF, kësaj radhe marrëveshja është plotësuar edhe me pika të reja të mirëseardhura për infermierët e QKMF-së, ku bëjnë pjesë ndjekja e seminareve e trajnimeve të ndryshme, shfrytëzimi i laboratorëve të Qendrës së Kompetencës për trajnime etj.

Më 28.10.2021 - pas furnizimit me 8500 doza të vaksinës kundër gripit sezonal, në tri qendrat e qytetit (QMF 1, QMF 2 dhe QMF 4) ka filluar procesi i vaksinimit. Meqë në QKMF, për shkak të mungesës së hapësirës nuk ka pasur vaksinim kundër gripit sezonal, qytetarët e rajonit dhe fshatrave që gravitojnë në këtë qendër janë shpërndarë në tri qendrat e tjera. Njoftimi për mënyrën e shpërndarjes së tyre është bërë përmes faqes zyrtare të QKMF-së në rrjete sociale.

Këtë vit sasia e vaksinave kundër gripit e arritur në QKMF ka qenë më e lartë sesa vitet e tjera.

Më 28 dhe 29.10.2021 - sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, ekipet mobile të QKMF-së, në Sheshin e Qytetit kanë bërë vaksinimin e popullatës me vaksinën kundër Covid 19. Me këtë rast janë dhënë vetëm dozat e para të vaksinës, ndërsa dozën e dytë, qytetarët janë udhëzuar që ta marrin në Qendrën e Vaksinimit). Gjatë këtyre dy ditëve vaksinimi është bërë pa termin dhe janë vaksinuar qytetarë pavarësisht nga komuna të cilës i takojnë.

Më 02.11.2021 - në QKMF është pranuar donacioni, në vlerë prej 80 mijë eurosh, i aparaturës Senexpert IV R2 Module & Laptop 10 sipas kontratës me CDF dhe Lefeid USA me nr.CDF/TB/016/2021 të datës 31.08.2021. Kjo aparatura shërben për të fuqizuar kapacitetet diagnostike të Dispanserit të Sëmundjeve të Mushkërive dhe TB, në kuadër të programit kombëtar për kontrollin e TB, të përkrahur nga granti i Fondit Global për Programin e TB që pritët të funksionalizohet pas 10 Janarit. Është siguruar edhe inventari dhe mjetet e tjera përcjellëse, një televizor, si dhe kabineti i sigurisë për mbrojtje në vendin e punës nga kontaminimi me bacile të TB.

Më 05.11.2021 - Drejtoresha e QKMF-së mori pjesë në takimin e organizuar nga HandiKos në Ferizaj, takim ky në të cilin u diskutua për ofrimin e shërbimeve me bazë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuar, si reagim ndaj ndikimit të Covid-19. Ky projekt financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga HandiKos-Ferizaj partneritet me *Save the children*. Ndërsa më **03.12.2021** - Drejtoresha mori pjesë në takimin e organizuar nga HandiKos për shënimin e *Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuar*. Në tryezën e rrumbullakët u diskutua rreth temës: Qeverisja e përgjithshme në raport me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, duke u fokusuar në raportin mbi të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të strategjisë komunale dhe planit të veprimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Komunën e Ferizajt për periudhën kohore 2019-2021.

Më 08.11.2021 - është shpallur konkursi me numër 1768 për plotësimin e një vendi të punës për Likvidator.

Më 09.11.2021 - Pas aprovimit të rekomandimit nga Komiteti për Imunizim kundër COVID 19 - edhe në QKMF-Ferizaj ka filluar vaksinimi anti-covid pa termin.

Më 10.11.2021 - ekipi mobil i vaksinimit anti-covid ka vazhduar punën në lokacionin e ri, në Qendrën Tregtare Village, në hapësirën e Viva Fresh Store.

Më 15.11.2021 - me një ceremoni modeste u përcoll në pension punëtori teknik z. Nuhi Baftija. Me këtë rast drejtoresha, Dr.Nadire Ymeri, në emër të menaxhmentit të QKMF-së e falënderoi z.Nuhi për përkushtimin dhe korrektësinë që ka treguar në punë për vite me radhë, si dhe kontributin e dhënë në QKMF. Z.Nuhi u nderua me një mirënjohje dhe një orë dore.

Më 25.11.2021 - Në platformën ZOOM u mbajt takimi me zonjën En, eksperte rreth hulumtimit mbi antigjipsizmin në Kosovë. Ky hulumtim është mbështetur nga organizatat e

shoqërisë civile *Voice of Roma, Ashkali and Egyptian, Terre des hommes* dhe *HEKS/EPER* në bashkëpunim me Zyrën për qeverisje të mirë dhe me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë *Think International* dhe atyre vendorë *UBO Consulting*.

Më 08.12.2021 - Sipas rekomandimeve të Komitetit për imunizim në masë, procesi i vaksinimit anti-covid ka vazhduar të bëhet brenda institucioneve shëndetësuese, e jo në qendrat e improvizuara. Qytetarët e Ferizajt janë njoftuar me kohë se vaksinimi anti-covid do të bëhet në QMF 1.

Më 08.12.2021 - Drejtoresha e QKMF-së dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, pritën në takim, në vizitën e parë, drejtorin e ri të DSHMS-së Dr. Kemajl Emini i emëruar në këtë post nga Kryetari z. Agim Aliu. Në këtë takim, drejtori u njoftua rreth organizimit të punës në QKMF, shërbimeve mjekësore, vaksinimit anti-covid, të arriturat, sfidat, pasojat e pandemisë dhe për një varg çështjesh të tjera të rëndësishme.

Më 13.12.2021 - u mbajt Simpoziumi i Parë i Infermierisë, organizuar nga Zyra e Kryeinfermierit të QKMF-së, z. Selim Bega dhe Drejtoresha e Infermierisë së Spitalit të Përgjithshëm, znj. Linda Viqa, në bashkëpunim me delegatët ferizajas të Odës së Infermierëve të Kosovës. Me moton: INFERMIERIA FERIZAJASE PËRBALL COVID 19, ky simpozium kishte për qëllim shpalosjen e përvojave të infermierëve në luftë kundër pandemisë dhe sfidat në punën e tyre të përditshme gjatë dy viteve të fundit. U prezantuan gjithsej tetë studime raste, katër nga infermierët e QKMF-së dhe katër nga infermierët e Spitalit të Përgjithshëm. Ky takim i rëndësishëm, i pari i këtij lloji në Kosovë, shënoi përmbylljen e aktiviteteve të infermierisë për vitin 2021.

Më 15.12.2021 - përfundoi punën grupi i tretë i specializantëve dhe infermierëve të angazhuar nga Ministria e Shëndetësisë në vaksinimin anti-covid. Me këtë rast, menaxhmenti i QKMF-së, u ndau mirënjohje të gjithë mjekëve dhe infermierëve të angazhuar nga MSH, për kontributin e ofruar në vaksinimin anti-covid. Me mirënjohje u nderuan edhe pjesëtarët e ekipit udhëheqës të Shërbimit të Vaksinimit Anti-Covid: Dr. Drita Nazifi - udhëheqëse e këtij shërbimi, Dr. Hesat Shatrolli-Koordinator i procesit të vaksinimit, Bekim Salihu-Koordinator i SISH-it dhe të gjitha infermieret e Shërbimit të Vaksinimit të cilat kanë qenë të angazhuara në këtë proces që nga fillimi i tij.

Më 17.12.2021 - Kryetari Agim Aliu dhe drejtorit i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, vizituan QKMF-në ku u takuan me anëtarët e Këshillit Drejtues. Në këtë takim u diskutua rreth vijueshmërisë së punëtorëve, disiplinës në punë dhe çështjes së orientimit të mjekëve të rinj në specializimin e lëmive të tjera e jo të Mjekësisë Familjare.

Më 29.12.2021 - Drejtoresha e QKMF-së ka marrë pjesë në takimin e drejtorëve të QKMF-ve me shefen e Divizionit të KPSH-së (në MSH-së), përfaqësuesit e UNICEF-it dhe shefen e Vaksinimit të IKSHPK-së.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht në muajin Janar, jemi furnizuar me 2 defibrilatorë dhe 2 aparate për EKG, nga Operatori Ekonomik, për nevoja të QKMF-së. Ndërkohë kemi pranuar një donacion me pajisje higjienike, me nëntë artikuj, nga kompania CADI-Ferizaj. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është realizuar projekti për furnizim me veshmbathje për personelin e QKMF-së, duke përfshirë edhe punëtorët me Caritas Kosova.

Në muajin qershor, me mbështetjen e Komunës, janë bërë renovime në Qendrën e SHEP si: suvatim, ngjyrosje e hapësirave, ndërrimi i sanitarisë dhe instalimi i rrjetit të ri të ujësjellësit brenda objektit. Ndërsa në oborrin e QKMF-së është shtruar një pjesë e rrugicës me kubëza.

Gjatë ***periudhës Janar-Dhjetor 2021*** numri i përgjithshëm i shërbimeve mjekësore dhe infermierike në QKMF është **1 068 430**, nga të cilat **231 432** janë vizita mjekësore, **797 994** shërbime infermierike dhe shërbime të tjera, **39 004** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë vitit 2021 ka mbajtur 26 mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje u shqyrtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF.

Më 02.02.2021 - nga Ministria e Shëndetësisë jemi furnizuar me frigoriferë të vegjël (2.6 l) gjithsej 72 copë për vaksinat anticovid dhe me 5500 teste rapide antigjenike. Pesë (5) prej frigoriferëve janë për Dragkovic. Gjithashtu, jemi furnizuar edhe me 5500 teste rapide antigjenike. Në Këshillin Drejtues është diskutuar rreth trajnimit të personelit për përdorimin e testeve dhe sigurimin e një hapësire të veçantë për testimin e pacientëve, në mënyrë që pacientët e dyshuar për Covid 19 të mos jenë në kontakt me të tjerët.

Më 05.02.2021 - në Qendrën Trajnuese të Mjekësisë Familjare në Ferizaj filloi viti akademik 2021-2023 i Edukimit Specialistik Postdiplomik (ESP) në Mjekësi Familjare. Mjekët nga Rajoni i Ferizajt do të ndjekin Programin e Mjekësisë Familjare të përcjellë nga Mentorët Klinikë: Dr. Afrim Rexhepi-koordinator i QTMF-së, Dr. Drita Lumi dhe Dr. Ylber Murati. Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) specializimin e Mjekësisë Familjare e realizon përmes 11 Moduleve, kurse vetë programi i Mjekësisë Familjare në nivel vendi është i akredituar nga Kolegji Mbretëror i Mjekëve Familjarë nga Britania e Madhe (MRCGP-INT). Secili mjek i cili e përfundon specializimin e Mjekësisë Familjare do të jetë edhe anëtar i MRCGP- INT.

Më 18 shkurt - kemi publikuar njoftimin lidhur me vaksinimin anti-covid, përmes të cilit i kemi njoftuar qytetarët mbi moshën 65 vjeç që të paraqiten nëpër qendrat tona, në mënyrë që të bëjmë kategorizimin e tyre më herët.

Më 26.02.2021 - ka arritur plani shtetëror i vaksinimit kundër Covid 19 i aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë. Në këtë plan janë paraqitur në mënyrë tabelare fazat e vaksinimit.

- Meqë gjatë këtyre muajve janë pensionuar disa punëtorë të QKMF-së, në të njëjtën mbledhje Këshilli Drejtues unanimisht vendosi që punëtorëve që pensionohen brenda muajve Mars dhe Prill t'u blihet nga një orë dore.

- Në mbledhjet e Këshillit Drejtues është diskutuar edhe lidhur me gjendjen shëndetësore të punëtorëve të prekur.

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes të kryetarit të Komunës, z. Agim Aliu dhe përfaqësuesit të organizatës "Qatar Charity" më 29.10.2020, janë ndërmarrë masat e duhura për lirim të objektit të vjetër, bartjen e inventarit nga Softaj në AMF në Talinoc, ku do të vazhdojë punën edhe personeli, deri në ndërtimin e objektit të ri të QMF 9.

Më 05.03.2021 - Këshilli Drejtues ka shqyrtuar edhe kërkesat e ndryshme që kanë arritur në emër të tij, nga të cilat do të përmendet kërkesa e punëtorëve që janë të angazhuar në QMF dhe AMF të fshatrave, të cilët kanë kërkuar stimulim të punës së tyre në terren, sepse kanë më shumë shpenzime. Këshilli Drejtues vendosi unanimisht që të stimulohen punëtorët që punojnë nëpër fshatra; mjekët të stimulohen me 50 € ndërsa infermierët me 30 €. Stimulimi u takon vetëm mjekëve dhe infermierëve që udhëtojnë.

- Në mbledhjet e Këshillit Drejtues janë aprovuar edhe listat e përfituesve të shtesës mujore që kanë qenë aktiv gjatë periudhës janar, shkurt, mars, prill dhe maj 2021 për stafin shëndetësor dhe atë mbështetës të rrezikuar nga infektimi me COVID-19.

Më 18.03.2021 - u vu gurthemeli i objektit të QMF 9 në Softaj dhe në ceremoninë e rastit ishin të pranishëm Shkëlqesia e Tij, Ambasadori i Katarit në Shqipëri, Ali bin Hamad Al-Marri, Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtori i organizatës "Qatar Charity" për Kosovën, Mahmoud Abbas Shaker, Kryetari i Komunës z. Agim Aliu, Drejtoresha e DSHMS-së znj. Abetare Kurti-Maliqi dhe udhëheqja e QKMF-së.

Më 20.03.2021 - Në bazë të nenit 64 alineja 2, nenit 65, 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114, Udhëzimit Administrativ mbi organizimin e punës në Kujdesin Parësor Shëndetësor Nr.04/2020, neni 21 pika 6 do të shpallur konkursi për pozitën: Zëvendës drejtor në QKMF. Procedurat e konkursit janë finalizuar me zgjedhjen e zëvendës drejtorit Dr. Afrim Abazi.

Më 30.03.2021 - Për shkak të pensionimit, pushimit pa pagesë dhe pushimit të lehonisë së disa punëtorëve, janë shpallur konkurse për plotësimin e vendeve të punës.

Në konkursin e shpallur më 30.03.2021 janë kërkuar:

1. Tetë (8) Specialistë/e të Mjekësisë Familjare, Specializantë/e të Mjekësisë Familjare ose Mjekë/e të Përgjithshëm
2. Dy (2) Laborantë/e të biokimisë
3. Një (1) Zyrtar/e juridik/e – zyrtar/e për statistikë
4. Tre (3) Fokistë (Një në QMF 4, një në QMF-Dardani, një në QMF-Pleshinë dhe Neredime)

Më 29.06.2021 - është shpallur konkurs për plotësimin e gjashtë vendeve të punës:

1. Tre (3) Magjistra të Farmacisë
2. Një (1) Teknikë të Farmacisë
3. Dy (2) Laborantë (të biokimisë, kimisë, ekologjisë)

Pika e parë këtij konkursi ndërkohë është anuluar për shkak të mungesës së buxhetit me *Vendimin* (nr. 867 të datës 02.07.2021) të Drejtoreshës së QKMF-së, bazuar në njoftimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Më 04.06.2021 - në mbledhjen e Këshillit Drejtues është diskutuar rreth UA 4/20 dhe formën unike të Statutit të QKMF-së, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik u bë aprovimi i Draft-Statutit Unik të QKMF-së.

Më 10.06.2021 - Meqë situata ishte e qetë dhe Emergjenca e Spitalit nuk kishte në trajtim pacientë me COVID-19, objekti i SHEP u lirua, ndërsa më 16 qershor janë liruar edhe ordinancat specialiste. Ndërkohë janë bërë disa renovime në SHEP.

Më 06.07.2021 - në mbledhjen e Këshillit Drejtues është diskutuar Draft-Statuti, janë bërë disa plotësime e ndryshime dhe pas aprovimit nga anëtarët e Këshillit Drejtues i është dërguar Drejtoreshës së DSHMS-së, për të dhënë pëlqimin dhe për t'u përcjellë pastaj në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërkohë, më 02.08.2021 Draft-Statuti është kthyer me disa rekomandime dhe pasi të shqyrtohet nga një komision i përbërë prej profesionistëve, do të ridërgohet me akt përcjellës.

Më 03.09.2021 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues u diskutua rreth udhërrëfyesve klinik për menaxhimin dhe trajtimin e COVID-19.

Më 07.10.2021 - në Prishtinë është mbajtur punëtorja: *Identifikimi i hapësirave të nevojshme për vaksinim në KPSH dhe identifikimi i nevojave për rrjet qeveritar dhe infrastrukturë hardverike*. Në këtë takim morën pjesë Drejtoresha e QKMF-së, Shefja e Shërbimit të Vaksinimit dhe Administratori i IT-së -Përgjegjës i SISH-it.

Në përgjithësi, nga temat më të diskutuara në mbledhjet e Këshillit Drejtues gjatë kësaj periudhe ka qenë menaxhimi i situatës së pandemisë COVID 19, e cila gjatë muajve gusht, shtator dhe tetor ka qenë tejet e rënduar. Gjithashtu, është diskutuar edhe për tri mbledhjet e Ekipit Menaxhues të Vaksinimit anti-covid në QKMF, ku është diskutuar për menaxhimin e procesit të

vaksinimit anti-covid në koordinim me Komitetin për Menaxhimin e Vaksinimit në Masë në nivel vendi.

Me angazhimin e menaxhmentit në organizimin e punës dhe me punën e palodhshme të personelit mjekësor e atij mbështetës, është arritur që çdo pacient i infektuar me coronavirus që është paraqitur në Kujdesin Primar Shëndetësor të marr trajtimin e nevojshëm mjekësor nga ekipet anti-covid të QKMF-së.

Procesi i vaksinimit anti-covid në Qendrën e Vaksinimit, përpos diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Drejtues, ka qenë preokupim kryesor i Ekipit Menaxhues të Vaksinimit Anti-covid i cili përbëhet nga: Drejtoresha e QKMF-së-Dr. Nadire Ymeri, Dr. Drita Emini- Shefe e Shërbimit të Vaksinimit, Dr. Hesat Shatrolli - Koordinator i Cilës së Shërbimeve, Bekim Salihu - Administrator i lartë i IT-së dhe Kooordinator i SISH-it. Ky ekip ka mbajtur mbledhjen e parë më 12 korrik dhe të dytën më 16 gusht, ku ka qenë e pranishme edhe Drejtoresha e DSHMS-së, znj. Abetare Kurti - Maliqi si anëtare e këtij ekipi. Vlen të theksohet se për të ndihmuar procesin e vaksinimit, nga 15 qershori, MSH ka dërguar 15 mjekë specializantë në dy grupe dhe 18 infermierë. Ndërsa nga Kryqi i Kuq janë angazhuar çdo ditë nga katër vullnetarë.

Gjatë **periudhës Janar-Dhjetor** në QKMF janë bërë edhe inspektime nga Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë për të cilat më pas janë dërguar raportet tematike si në vijim:

1. **Raporti tematik i datës 11.05.2015** për inspektimin në QKMF - që ishte i fokusuar në zbatimin e masave mbrojtëse dhe gjendjen e përgjithshme lidhur me situatën e krijuar për shkak të koronavirusit (COVID-19);

2. **Raporti tematik i datës 19.05.2021** për inspektimin në QMF 1 - që kishte për qëllim verifikimin e respektimit të masave ligjore, etike dhe standardeve të cilësisë, si dhe monitorimin e zbatimit të Qarkores Informuese me Nr. 02/2021 të datës 08.04.2021 për profesionistët shëndetësor në Institucionet Shëndetësore Publike rreth zbatimit të procesit të vaksinimit/imunizimit sipas planit shtetëror kundër pandemisë COVID-19.

3. **Raporti tematik i datës 21.06.2021** për inspektimin tematik të bërë në Qendrën e Vaksinimit të QKMF-Ferizaj më 17.06.2021.

4. **Raporti tematik i datës 28.07.2021** në QMF 2, për respektimin e orarit të punës nga personeli shëndetësor dhe furnizimin me barna nga lista esenciale.

5. **Raporti tematik i datës 19.08.2021** për inspektimin në Qendrën e Vaksinimit në Ferizaj.

6. **Raporti i datës 08.10.2021** për inspektimin e bërë në QKMF (më 27.09.2021) me qëllim të verifikimit të raportimit të rregullt në IKSHPK.

7. **Raporti i datës 08.10.2021** mbi inspektimin tematik në Qendrën e Vaksinimit më 24.09.2021. Inspektimi është bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L125, Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor Nr. 02/L-38, Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në territorin e Republikës së Kosovës Nr. 07/L-006 dhe Qarkoren Informuese Nr. 07/2021 e protokolluar me

numër 05-5475. Edhe në këtë raport tematik nuk ka vërejtje dhe rekomandohet të vazhdohet respektimi i qarkores Nr. 07/2021.

Në asnjërin nga këto raporte nuk kishte vërejtje, prandaj në secilin prej tyre vetëm janë dhënë rekomandimet për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të punës.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DMF (DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE)

Zyra e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare dhe Këshilli Profesional gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur pesë (5) mbledhje, më 12.02.2021, 16.03.2021, 03.06.2021, 11.08.2021 dhe 27.10.2021 në të cilat janë diskutuar tema të ndryshme, e ndër to temë primare ka qenë menaxhimi i situatës së rënduar epidemiologjike si pasojë e pandemisë me COVID-19, rrjedha e procesit të vaksinimit të popullatës me vaksinat anti-covid dhe vaksinat kundër gripit sezonal. Duhet të ceket se gjatë kësaj periudhe situata me COVID-19 ka shkuar duke u keqësuar e sidomos në muajt mars, prill dhe maj, pastaj ka qenë një periudhë më e qetë, por në muajt gusht dhe shtator numri i rasteve me Covid është rritur sërish; kjo situatë ka vazhduar edhe gjatë muajit në vazhdim me intensitet më të ulët. Si rrjedhojë e situatës epidemiologjike të përkeqësuar kohë pas kohe, por edhe aplikimit të masave anti-covid dhe kufizimit të numrit të pjesëmarrësve edhe mbledhjet e Këshillit Profesional janë mbajtur vetëm atëherë kur situata ka qenë më e qetë.

Megjithatë, kontakti dhe konsultimet me shefat e njësive ka qenë i përditshëm, me vizita të kryeshefit nëpër QMF dhe AMF në terren, ku aty janë bërë konsultime, koordinimi i punëve, kontrolli i mbarëvajtjes së punës dhe ofrimit sa më të mirë të shërbimit shëndetësor. Poashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe disa aktivitete dhe takime.

Në mbledhjet e Këshillit Profesional kanë raportuar përgjegjësit e njësive dhe sektorëve për punën që është bërë aty si dhe për problemet, nevojat dhe mundësitë e përmirësimit të mbarëvajtjes së punës, e sidomos përballjen me pandeminë COVID-19. Në mbledhje është diskutuar për detyrat dhe aktivitetet të cilat janë të përfshira në disa pika:

1. Menaxhimi i situatës epidemiologjike me COVID -19
2. Formimi i ekipeve mobile shtesë (ekipet e dyta) gjatë orarit të paradites dhe pasdites për personat e dyshuar dhe COVID-19 pozitiv.
3. Caktimi i një hapësire në QMF 1 për dhënien e terapisë parenterale për pacientët covid pozitiv.
4. Njoftimi për Qarkoren Informativ Nr.01/2021 të datës 02.03.2021, për vaksinim me vaksinën kundër COVID-19.
5. Përgatitja për fillimin e testimeve me Rapid-Test.
6. Fillimi i vaksinimit kundër COVID-19, organizimi dhe mbarëvajtja e punës.

7. Njoftimi mbi Qarkoren Informativ Nr.04/2021 dhe vendimin e MSH mbi miratimin e Planit të veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë kundër COVID-19
8. Fillimi i vaksinimit kundër gripit sezonal, i organizuar në tri QMF.
9. Transferimi i Qendrës së Vaksinimit Anticovid nga salla e Shkollës së Mesme të Bujqësisë në QMF 1.
10. Diskutimi rreth SISH-it mbi procedurën e futjes në sistem të pacientëve në laborator dhe lidhtore.
11. Respektimi i orarit të punës dhe pauzës nëpër njësi nga stafi shëndetësor dhe ai mbështetës.
12. Përpilimi i orareve për kujdestaritë e të dielave dhe festave.
13. Sistemimi i mjekëve të rinj të pranuar me kontratë të rregullt, si dhe atyre përmes Caritas-it.
14. Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së.
15. Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me përgjegjësit e njësive.
16. Vazhdimi i trajnimeve online si dhe në QTMF për stafin shëndetësor.

Menaxhimi i situatës epidemiologjike me Covid-19 - Prej fillimit të pandemisë e deri tani, preokupim i yni si menaxhment, por edhe i stafit shëndetësor dhe atij mbështetës, ka qenë dhe ende vazhdon të jetë organizimi dhe menaxhimi sa më i mirë i kësaj pandemie, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për popullatën, si ata me Covid-19 dhe ata me sëmundje të tjera akute dhe kronike. Për këtë qëllim, si rezultat i rritjes së numrit të rasteve të dyshuara dhe pozitive, kah mesi i muajit mars, ekipit mobil i është shtuar edhe ekipi i dytë, që d.m.th. paradite dhe pasdite, nga dy ekipe kanë dalë në terren për t'i ofruar shërbime popullatës me simptoma të dyshuara apo pozitive. Po ashtu në kuadër të hulumtimit dhe zbulimit të rasteve të dyshuara, prej datës 18.03.2021 kanë filluar edhe testimet në popullatë, me rapid-teste.

Në mbledhjen e Këshillit Profesional të datës 16.03.2021 janë dhënë informata për shefat e njësive rreth Qarkores Informativ 01/2021 të datës 02.03.2021, për vaksinim me vaksinat kundër Covid-19, ku është përshkruar në mënyrë të detajuar Plani gjithëpërfshirës i vaksinimit të popullatës, fazat e vaksinimit (3 faza), mënyra e organizimit, trajnimi i stafit etj. kurse në mbledhjen e Këshillit Profesional të datës 03.06.2021 anëtarët e këshillit janë njoftuar me Qarkoren Informativ Nr. 04/2021 dhe vendimin e MSH mbi miratimin e Planit të veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë kundër COVID-19. Në mbledhjet e Këshillit Profesional po ashtu është diskutuar edhe për aftësimin profesional të stafit nëpërmjet ligjëratave të organizuara online si dhe trajnimet dhe ligjëratat në Qendrën Trajnuese në kuadër të QKMF-së. Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe pajisja e stafit shëndetësor dhe atij mbështetës me uniforma. Ndërsa janë pranuar tetë mjekë me kontratë të rregullt pune.

Gjatë kësaj *këtij viti* janë mbajtur, gjithashtu, një numër i takimeve dhe aktiviteteve:

- Takimi me dy përfaqësues të UNHCR-it për komunitetet me 26.01.2021 - e që interesimi i tyre ishte për 18 familje të komunitetit RAE, të riatdhesuara më herët, se a janë përfshirë në listën për vaksinim kundër Covid-19.

- Takimi me Drejtoreshën e DSHMS-së, znj. Abetare Kurti-Maliqi dhe zyrtarën e kësaj drejtorie znj. Suzana Mustafa më 03.02.2021, ku përveç kryeshefit të DMF -së të pranishëm ishin edhe Kryeinfermieri i QKMF-së, Selim Bega dhe përgjegjësi i Departamentit të Administratës, Agim Rexhaj. Drejtoresha u njoftua me punën që është bërë në vitin 2020 si dhe për nevojat e QKMF-së për vitin 2021 në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Pas takimit, u bë një vizitë e përbashkët në Sektorin e Stomatologjisë dhe të Mjekësisë Familjare në QKMF.
- Takimi me Shoqatën “HANDIKOS” Ferizaj më 23.03.2021.
- Më 26.01.2021 ka arritur një donacion nga CDF me pajisje mbrojtëse personale, i dedikuar për distribuim në institucionet dhe shërbimet shëndetësore të *Programit kombëtar për kontrollin e tuberkulozit*.
- Janë caktuar 4 infermiere të kërkuara nga KKZ e KK Ferizaj që t'i bashkohen ekipit të Komisionit për Zgjedhjet Parlamentare për personat me Covid-19 nëpër shtëpitë e tyre.
- Janë caktuar 2 mjekë dhe 4 infermierë për t'u trajnuar për dhënien e vaksinës anti-covid.
- Për nder të Ditës së luftës kundër Tuberkulozit është organizuar një aktivitet në hapësirat e DAT-it, të udhëhequr nga Koordinatorja për edukim dhe promovim shëndetësor.

Po ashtu, në kuadër të mbarëvajtjes së punës nëpër njësitë e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve janë bërë edhe vizita me qëllim të monitorimit të mbarëvajtjes së punës në to, respektimin e orarit të punës dhe kohës së pauzës, ecurinë e punës, mungesat dhe nevojat nëpër këto njësi, ndërsa me përgjegjësit e njësisë janë mbajtur kontakte të vazhdueshme

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet infermierike në QKMF përbëjnë mbi 70% të volumit të përgjithshëm të punës në institucionin tonë dhe si të tilla kërkojnë një menaxhim dhe përkushtim serioz. Në QKMF janë disa shërbime të cilat udhëhiqen dhe mbahen vetëm nga stafi infermieror, si p.sh.: *Vizitat shtëpiake për persona me sëmundje kronike dhe kujdes paliativ, Shërbimi i vizitave për nëna dhe fëmijë, Kujdesi antenatal, Dispanseri antituberkular, Vizitat dhe shërbimet për persona me COVID-19, Qendra e thirrjeve* etj.

Të gjitha këto shërbime të kryera nga infermierët gjatë kësaj periudhe arrijnë në gjithsej **797 994** shërbime, që paraqesin **74.6%** të punës në QKMF, ndërkohë që **231 432** vizitat mjekësore përfshijnë **21.6%** dhe **3.65%** shërbimet stomatologjike.

Nga shërbimet infermierike që kanë ofruar numër të lartë të shërbimeve vlen të përmenden në veçanti: *Vizitat shtëpiake - 7 162, Vizitat për Nëna dhe Fëmijë - 2 587, Injeksione intramuskulare - 85 452, Infuzionet - 45 064 dhe Qendra e thirrjeve (covid) - 4186.*

Në fillim të vitit 2021 është bërë plani i punës, në cilin janë evidentuar ngecjet dhe janë vendosur prioritetet në infermieri si në vazhdim:

- Me qëllim të përgatitjes dhe avancimit profesional sa më të mirë të stafit infermieror është planifikuar një trajnim për emergjenca mjekësore me stafin e Emergjencës Primare.
- Është bërë pajisja e të gjitha QMF-ve me defibrilator automatik dhe është trajnuar stafi shëndetësor për përdorim të defibrilatorit, si dhe aplikimin e Reanimimit kardio-pulmonar bazik dhe zbatimin e hershëm të *zinxhirit të mbijetesës*.
- Është bërë përgatitja e stafit të vaksinimit për vaksinimin e popullatës me vaksinën kunder COVID-19.
- Organizimi i stafit infermieror, varësisht nga nevojat e QKMF-së dhe nevojave të popullatës nëpër QMF, si dhe zgjerimi i shërbimeve infermierore nëpër këto qendra.
- Avancimi dhe ngritja profesionale në marrjen e përgjegjësi si dhe në përdorimin e aparaturave dhe metodave të reja të aplikimit në shëndetësi, përmes Zhvillimit të Vazhdueshëm Professional (ZHVP), janë akredituar trajnimet për profile specifike si në stomatologji, rentgen, laborator etj.

Aktivitetet

- Në *periudhën Janar-Dhjetor* janë mbajtur dhjetë mbledhje me kryeinfermierë të njësi, mbledhje këto që janë të rregullta dhe në të cilat diskutohen planet, sfidat, nevojat si dhe dalin rekomandime për Këshillin Drejtues të QKMF-së.
- Është bërë planifikimi i pranimit të stazhierëve dhe praktikantëve për kryerjen e praktikës në QKMF, konform masave kundër pandemisë, në grupe të vogla me kohëzgjatje të orës prej 30 minutash ora, ashtu siç është edhe në shkolla. Grupimi bëhet me nga tre deri katër praktikantë nëpër njësi (nga 3 orë pune ose 6 orë mësimore) me 4 grupe në ditë.
- Deri më tani, për vitin 2021 janë regjistruar të kryejnë stazhin 285 praktikantë dhe deri më 31.12.2021 e kanë kryer stazhin 266 studentë dhe nxënës të diplomuar në shkollat e mesme.
- Nga Zyra e Kryeinfermierit, gjatë kësaj periudhe, janë lëshuar 172 vërtetime për praktikantët që kanë kryer stazhin. Kurse në proces të kryerjes së stazhit janë aktualisht 65 praktikantë. (Një pjesë e studentëve nuk i tërheqin vërtetimet menjëherë pas përfundimit të stazhit).
- Në kryerjen e praktikës nga studentët e infermierisë së UP-së dhe kolegjeve private janë të sistemuar edhe 66 studentë. Përveç Kolegjit Heimerer dhe Kolegjit AAB, me të cilët QKMF ka pasur marrëveshje bashkëpunimi, këtë vit është bërë marrëveshje edhe me Kolegjin Universum, prej të cilit janë sistemuar 30 studentë të vitit të dytë të infermierisë.
- Më 14-15 janar 2021 me kërkesën e shumë infermierëve është përsëritur sesioni online i ligjëratave për infermierë, ku kanë marrë pjesë rreth 93 infermierë, prej tyre afër 20

nga sektori privat. Ky organizim ishte fryt i bashkëpunimit të Zyrës së Kryeinfermierit me Koordinatorin e ZHVP-së.

- Më 24.01.2021- janë dërguar për trajnim 4 infermiere nga Shërbimi i vaksinimit në kuadër të përgatitjes për vaksinim kundër COVID-19.
- Më 28.01.2021 - me kërkesën e KZZ janë përgatitur dy ekipe infermierësh për ditën e zgjedhjeve, me qëllim të monitorimit të procesit të zgjedhjeve për personat covid-pozitiv të izoluar në shtëpitë e tyre. Këto ekipe së pari janë dërguar në trajnim e pastaj janë angazhuar në punë ditën e zgjedhjeve.
- Më 04.02.2021- dy infermiere nga Qendra e thirrjeve janë dërguar për trajnim në IRSHPK- Ferizajt për trajnim të rasteve në terren.
- Më 06.02.2021- Kryeinfermieri i QKMF-së bashkë me Shefin e Shërbimit Emergjent Primar, vizituan Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë me qëllim të shkëmbimit të përvojave të punës dhe marrjes së modeleve të punës që mund të aplikohen në SHEP. Një përvojë e tyre, që do të ishte tejet e dobishme për institucionin tonë, ishte angazhimi i infermierëve edhe si vozitës. Zbatimi i një praktike të tillë do të lehtësonte procesin e punës në SHEP dhe do të mundësonte aktivizimin e më shumë ekipeve shëndetësore emergjente, meqë kur kemi numër të limituar të vozitësve. Për ta realizuar këtë praktikë duhet që përmes MSH-së të dërgohen infermierët në kurs për vozitje emergjente në Vushtrri.
- Më 08.02.2021 pas një viti pune në pikën kufitare nga MSH jemi informuar se është marr vendim që të ndërpritet dërgimi i ekipeve infermierore në pikat kufitare, prandaj infermierët janë në kthyer në QKMF aty ku ka pasur nevojë.
- Më 10.02.2021 janë dërguar dy infermiere nga laboratorit për trajnim në marrjen e mostrave për teste rapide antigjenike.
- Më 18.02.2021 është mbajtur uorkshopi *Re-animimi kadio-pulmonar bazik dhe përdorimi i defibrilatorit automatik* me infermierët e katër QMF-ve, me ç'rast u trajnuan 16 infermiere dhe katër QMF-të e qytetit u pajisën me defibrilator automatik. Kjo punëtori u mbajt nga kryeinfermieri i QKMF në bashkëpunim me Koordinatorin e ZHVP-së.
- Më 25.02.2021 me kërkesën e Koordinatorës së ZHVP-së për mjekë, u organizua punëtori *Re-animimi kardio-pulmonar bazik dhe përdorimi i defibrilatorit automatik*, për mjekët e QKMF, pasi që është vlerësuar e suksesshme punëtori e njëjtë e mbajtur me infermierët.
- Më 09-12.03.2021- është mbajtur trajnimi për *Emergjencat Mjekësore* në QTMF, nga trajnerët: Selim Bega - i trajnuar për fatkeqësi dhe emergjenca në Turqi, në vitin 2019 (ACLS dhe ITLS), Ali Shaqiri -trajner në QKMF dhe trajner për ITLS, si dhe Afërdita Muharremi – Trajnere në QKMF. Këtë trajnim e ndoqën nga 15 infermierë të emergjencës dhe deri më 31.03.2021 janë trajnuar tri grupe të infermierëve të emergjencës me 42 infermierë, trajnimi është akredituar nga OIK-u dhe ishte i domosdoshëm për stafin e Emergjencës Primare, pasi nuk ishin trajnuar dhe certifikuar që nga viti 2010.

Gjatë kësaj *periudhe njëvjeçare*, jemi ballafaquar edhe më tutje me pandeminë COVID-19. Kanë qenë dy periudha kohore kur jemi përballuar me numër të madh të rasteve. Fillimisht në muajin prill, e pastaj edhe nga gjysma e muajit gusht kemi pasur edhe pikën më të lartë të rasteve që nga fillimi i pandemisë. Për shkak të kërkesave të shumta dhe nevojave të qytetarëve i kemi dyfishuar ekipet e *Vizitave në shtëpi për personat e infektuar me covid*, po ashtu edhe në *Qendrën e thirrjeve* e cila ka funksionuar që nga fillimi i pandemisë, kemi shtuar numrin e infermiereve, pasi që ka pasur numër të madh të pacientëve që duhej kontaktuar dhe përcjell deri në shërim.

Në fillim të prillit kemi bërë edhe përgatitjet përfundimtare për vaksinimin e grupmoshave të caktuara kundër COVID-19, për formimin e ekipeve sipas planit të ministrisë kemi dërguar edhe 13 infermiere nga të gjitha QMF-të të cilët janë trajnuar paraprakisht dhe kemi filluar vaksinimin me kohë.

Nga 31.03-03.04.2021 - në QT kemi mbajtur edhe trajnimin me grupin e tretë të infermiereve nga Emergjencia Primare mbi “Emergjencat mjekësore” ku janë trajnuar 42 infermiere. Kështu u realizua një prej prioriteteve infermiere për këtë vit, pasi që stafi i Shërbimit Emergjent Primar nuk ishte trajnuar dhe certifikuar që prej vitit 2010.

Më 12 Maj - kemi organizuar shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë, ndryshe nga herët tjera- në sheshin e qytetit kemi paraqitur një ekspozitë me foto nga puna e stafit shëndetësor të QKMF-së gjatë pandemisë, si dhe në tendë kemi angazhuar infermierët për matje të TA dhe Glikemisë në mënyrë simbolike për qytetarët. Kjo ekspozitë ishte e hapur gjatë tërë ditës për qytetarët, aktivitetit iu bashkëngjiten edhe studentët e infermierisë të Kolegjit Universum me të cilët kemi pasur bashkëpunim të mirë edhe më parë në fushën e infermierisë.

Më 18.05.2021 - kemi bërë planifikimin për vaksinimin masiv në bazë të rekomandimeve nga Ministria e Shëndetësisë. Kemi dërguar edhe 14 infermiere të tjerë nga QMF-të për të punuar në SISH dhe për të plotësuar nevojat e vaksinimit, që duke shtuar edhe 18 infermiere të dërguar nga MSH me kontrata të përkohshme, numri i infermiereve të angazhuar në procesin e vaksinimit masiv është 56 infermiere.

Më 26.05.2021 - Në bashkëpunim me shoqatën “Handikos” është mbajtur online ligjërata "Specifikat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procedurat standarde të veprimit kundër dhunës në familje" ku morën pjesë 35 infermiere.

Më 29.05.2021 dhe 26.06.2021 ekipet e Emergjencës Primare kanë përcjellë gjendjen e nxënësve në testin kombëtar të maturës shtetërore në 11 shkolla të qytetit.

Më 01.06.2021 - është mbajtur një trajnim për trajtimin e djegieve nga mjekët e klinikës së Kirurgjisë Plastike, në të cilin morën pjesë 14 infermiere dhe 4 mjekë. Trajnimi është vlerësuar si shumë i qëlluar dhe i nevojshëm, kështu që kemi kërkuar edhe një tjetër trajnim, që me mirëkuptim e pranuan ligjëruesit dhe të nesërmen është mbajtur i njëjti trajnim me grupin e dytë prej 15 infermiereve.

Nga data 01.06.2021 në marrëveshje me Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt kemi tërhequr teknikët tanë të rëntgenit që ndihmonin në ndërrimin e pasdites në spital, pasi që numri i pacientëve me covid kishte rënë në shifra minore.

15.06.2021 - pas një pune disa mujore të kryeinfermierëve dhe infermierëve më të vjetër në grumbullimin e materialeve, doli nga shtypi libri “Infermieria Ferizajase” e autorëve Agim Hajdini, Bashkim Mehmeti dhe Rexhep Jakaj. Promovimi i librit u bë në Teatrin e Qytetit, ku përveç punëtorëve shëndetësor të institucioneve ferizajase, morën pjesë edhe personalitete nga kryesia e OIK-ut dhe personalitete të shumta nga qyteti ynë.

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare infermierët e QKMF-së kanë kaluar nëpër sfida serioze në përballje me disa valë serioze të pandemisë, në veçanti gjatë muajve mars, prill dhe shtator. Gjithashtu, sfidë për infermierinë gjatë këtij viti ishte edhe vaksinimi i popullatës kundër COVID-19 që deri më **31.12.2021** janë aplikuar gjithsej **111 878** doza të vaksinës dhe procesi ka shkuar mirë.

Vlen të theksohet se krahas shërbimeve shtesë për persona me COVID-19, personeli infermierik në përgjithësi ka përmbushur edhe të gjitha obligimet e tjera, përkundër sfidave të pandemisë. Një nga sfidat që po na përcjellë gjatë kësaj pandemie është shërbimi i vizitave për nëna dhe fëmijë të cilin infermierët janë duke e kryer në sistemin online me rekomandim të UNICEF-it që është edhe organizator i këtij shërbimi, pasi që në komunën tonë kemi një numër të madh të nënave nga komuniteti RAE dhe me të cilat nuk po kemi mundësinë e qasjes në telefon ose online për arsye se u mungojnë pajisjet e teknologjisë së avancuar.

Gjatë muajit korrik kanë vazhduar aktivitetet normale të punës pasi situata pandemike ishte përmirësuar dukshëm dhe prioritet i është dhënë vaksinimit të popullatës me vaksinën anti-covid. Me kërkesën e shefes së vaksinimit janë dërguar edhe 6 infermierë shtesë në Qendrën e vaksinimit, si dhe 17 infermierë të tjerë janë pranuar nga MSH në mbështetje të ekipeve të vaksinimit, duke përmbyllur kështu formimin e ekipeve të vaksinimit sipas kërkesave të MSH.

Më 06.07.2021 - në emër të infermierëve të QKMF-së, në zyrat e OIK në Prishtinë, kryeinfermieri Selim Bega ka pranuar një mirënjohje "Për kontributin e dhënë të Infermierëve gjatë pandemisë" që ishte një shpërblim simbolik, por që u mirëprit nga infermierët.

Gjysma e dytë e muajit gusht është karakterizuar me një valë të madhe të pandemisë COVID-19 varianti delta, me ç'rast kemi angazhuar një numër të madh të infermierëve së bashku me mjekët në trajtimin e këtyre pacientëve. Krahas ekipeve për vizita shtëpiake për personat me COVID 19 kemi qenë të detyruar të hapim edhe një pjesë të QMF 1 për trajtim ditor me terapi kryesisht intravenoze për këta pacientë, pasi numri i tyre ishte rritur në shkallë enorme. Vetëm gjatë muajit gusht për persona me COVID 19 janë ofruar mbi 12 000 shërbime që paraqet numrin më të madh të këtyre shërbimeve që nga fillimi i pandemisë.

Më 31.09.2021 - pas kërkesë se drejtorisë së Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt për ndihmë me staf infermieror, pasi situata aty ishte alarmante, me pacientë të infektuar me COVID-19, me vendim të drejtorisë së QKMF-së, janë dërguar një grup prej 20 infermierësh në deri më 10 shtator si ndihmë në përballimin e gjendjes së krijuar.

Meqë stafi ynë infermieror ishte i mobilizuar në tërësi për shkak të rëndimit të situatës pandemike dhe Ministria e Shëndetësisë kishte lansuar fushatën për vaksinim masiv, në Qendrën e Vaksinimit anti-covid janë dërguar si përforsim edhe 6 infermiere nga Njësia e Fizioterapisë, për të punuar si ndihmës infermiere të vaksinimit deri me 10 tetor. Ndërkohë edhe nga MSH janë angazhuar edhe tre infermierë me kontratë të përkohshme si ndihmë gjatë pandemisë dhe vaksinimit anticovid.

Më 10.08.2021 - nga QKMF dhe QMF-II, në trajnim 5 ditor kemi dërguar 2 infermierë të vizitave shtëpiake për pacientët e palëvizshëm dhe kronikë.

Më 16.09.2021 - janë mbajtur tri trajnime në kuadër të AMC-Aksioni për Nëna dhe Fëmijë ku ne kemi dërguar dy infermiere (aq sa na ishte lejuar) për këtë trajnim.

Më 11.10.2021 - kemi formuar grupin edukues nga infermierët për *Muajin kundër kancerit të gjirit* në bashkëpunim me koordinatorët e edukimit dhe promovimit shëndetësor. Me këtë rast janë mbajtur pesë ligjërata në komunitet në fshatrat Dardani, Mirash dhe Greme, si dhe në lagjet Sallahane dhe Sherret që ishin detektuar më herët si pjesë me nevojë më të mëdha në edukimin dhe promovimin shëndetësor kundër kancerit të gjirit.

Më 13.10.2021 - u organizua debati mbi draft-ligjin për infermierinë nga OIK-u në bashkëpunim me Zyren e Kryeinfermierit, ku morën pjesë Menaxhmenti i QKMF-së dhe 20 infermierë nga QKMF, si dhe nga Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt. Me këtë rast u dhanë disa propozime dhe u diskutuan shumë pika dhe nene nga draft-ligji për infermierinë. Disa nga propozimet për ligjin e infermierisë të propozuara nga ky takim u morën nga paneli si të qëlluara dhe të arsyeshme në hartimin e Ligjit për infermieri.

Më 04.11.2021 - kanë filluar ligjëratat e akredituara për profile specifike (teknik laborator, teknik i stomatologjisë, rëntgenit, farmacisë etj.) për punëtor të rregullt dhe ata që janë të angazhuar përmes Caritas-Kosova në QKMF. Këto ligjërata janë mbajtur nga trajnerët e QKMF-së, Ali Shaqiri, Afërdita Muharremi dhe nga Kryeinfermieri i QKMF-së Selim Bega. Ligjëratat janë mbajtur në tri sesione me 04.11.2021, 11.11.2021 dhe 18.11.2021 në tre grupe të ndryshme dhe janë ndjekur online nga rreth 250 infermierë.

Më 05.11.2021 - Kryeinfermieri i QKMF-së ka marrë pjesë në takimin me kryeinfermieret e QKMF-ve të të gjitha qendrave të Kosovës, në Kolegjin Heimerer, ku u diskutua rreth praktikës së studentëve dhe nxënësve nëpër QKMF.

Më 14.11.2021 - është shënuar Dita e Diabetit në qendrën e qytetit nga mjekë dhe infermierë nga katër QMF-të, me ç'rast është bërë matja e glikemisë dhe këshillimi i qytetarëve në lidhje me sëmundjen e diabetit.

Më 13.12.2021 - në Teatrin e qytetit, është organizuar Simpoziumi i Parë i Infermierisë në Kosovë organizuar nga Zyra e kryeinfermierit të QKMF-se, Zyra e Drejtoreshës së Infermierisë së Spitalit të Përgjithshëm dhe Delegatëve të OIK-ut. Simpoziumi është akredituar nga OIK-u, për pjesëmarrësit aktivë me nëntë pikë dhe për pjesëmarrësit pasivë me shtatë pikë. Gjashtë infermierë nga QKMF prezantuan punimet e tyre dhe po atë nga Spitali i Përgjithshëm, ndërsa simpoziumi u ndoq nga 200 infermierë pjesëmarrës, 60 prej tyre ishin të pranishëm në sallë dhe 140 të tjerë e ndoqën online. Gjithashtu, të pranishëm ishin edhe personalitete nga niveli qendror, lokal, menaxhmenti i QKMF-se dhe spitalit Rajonal si dhe kryeinfermieret e QKMF-ve të rajonit dhe drejtorët e infermierisë së Spitaleve të Kosovës.

Vlen të theksohet se infermierët janë të angazhuar në të gjitha shërbimet ndaj qytetarëve tanë, si brenda institucionit ashtu edhe në shërbimet që ofrohen në terren. Një nga sfidat që po na përçjellë gjatë kësaj pandemie është **shërbimi i vizitave për nëna dhe fëmijë** të cilin infermierët janë duke e kryer në sistemin online, me rekomandim të UNICEF, që është edhe organizator i këtij shërbimi. Meqë në komunën tonë kemi një numër të madh të nënave nga komuniteti RAE dhe me të cilat nuk po kemi mundësinë e qasjes në telefon ose online, për arsye të nivelit jo të mirë zhvillimit ekonomik dhe arsimor të tyre!

KOMITETI PËR NGRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE **Zyra për sigurimin e cilësisë në punë**

Koordinatori i Cilësisë së Shërbimeve prej datës 24.05.2021 nga Drejtoresha e QKMF-së, është angazhuar në mbikëqyrjen e procesit të vaksinimit anticovid. Sipas pikës 3, të vendimit me numër protokolli 05-4179 të datës 11.06.2021, të Ministrit të Shëndetësisë, Koordinatorët e Cilësisë të QKMF-ve të Komunave përkatëse të raportojnë në Komisionin për Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit teknik të vaksinimit kundër Covid-19 në nivel të Republikës së Kosovës.

Nga data 15.06.2021 sipas vendimit të lartpërmendur koordinatori i cilësisë krahas raportimin në baza ditore dhe javore, ka kryer edhe detyra dhe obligime të tjera si: Mbikëqyrja e procesit teknik të vaksinimit; Mbikëqyrja dhe sistemimi i ekipeve gjatë proceseve të vaksinimit; Mbikëqyrja e arritjes së sasisë së nevojshme ditore të vaksinave, sipas planifikimit; Mbikëqyrja dhe menaxhimi i mbetjeve mjekësore pas vaksinimit dhe materialit tjetër shpenzues; Mbikëqyrja dhe sigurimi i furnizimit me mjete mbrojtëse dhe material tjetër shpenzues; Mbikëqyrja dhe furnizimi me material IEK; Mbikëqyrja e prezencës së autoambulancës në ofrimin e shërbimeve emergjente; Përcjellja e realizimit të procesit të vaksinimit sipas *Manualit për mbikëqyrje nga përhapja e virusit SARS-Cov 2, Covid-19*.

Pas miratimit të planit të veprimit për vaksinimin në masë të popullatës me vaksinën kundër Covid-19 menjëherë kemi filluar përgatitjet për sigurimin e një vendi të përshtatshëm për vaksinim, pasi që hapësira në QMF-1, ku fillimisht zhvillohej vaksinimi ishte jo e mjaftueshme karshi kërkesave të qytetarëve për vaksinim. Ndërkohë, siguroam sallën e Edukatës Fizike në SHML të Agrobiznesit “Zenel Hajdini”. Më 15.06.2021 salla ka qenë e gatshme për punë përveç paravanëve jofunksional, të cilët tek pas një muaji janë siguruar nga niveli qendror. Nga data

15.06.2021, detyrë e koordinatori ka vazhduar mbikëqyrjen e rregullt të procesit të vaksinimit kundër Covid-19 si: Mbikëqyrjen e vijueshmërisë së stafit shëndetësor; Menaxhimin e mbetjeve klinike nga procesi i vaksinimit kundër Covid-19; Menaxhimin e zinxhirit të ftohtë të ruajtjes së vaksinave; Raportimet tek Ekipi Menaxhues Qendror, tek drejtori i DSHMS-së, menaxhmenti i QKMF-së dhe ekipi menaxhues lokal. Gjithashtu, njoftimet e pranuar nga Ekipi Menaxhues i nivelit qendror janë bartur tek stafi shëndetësor në qendrën e vaksinimit gojarisht dhe përmes e-mailit. Gjatë kësaj periudhe te ekipi menaxhues qendror nga koordinatori janë dërguar: 173 - Raporte ditore; 28 - Raporte javore; 21 - Matrica e monitorimit të aktiviteteve në Qendrën e Vaksinimit; 43 - Njoftime; 12 - Forma mujore e realizmit të shërbimeve për mjekë dhe inferimerë; 36 - Forma standarde e raportimit të efekteve të padëshirueshme pas vaksinimit (EPPV) .

Ekipet mjekësore në procesin e vaksinimit kundër COVID 19, përveç ofrimit të shërbimit të vaksinimit në sallën e edukatës fizike të shkollës së mesme "Zenel Hajdini", përmes ekipeve mobile të vaksinimit në teren kanë vaksinuar, me dozën e parë qytetarët e komunitetit RAE në fshatin Dubravë, në lagjen Sallahane dhe Halit Ibishi (237 doza), pastaj vaksinimin e pacientëve të kujdesit palativ në shtëpitë e tyre, personat me aftësi të kufizuar në hapësirat e HandiFer-it (50 doza), klientët në shtëpinë integruese të komunitetit (20 doza), vaksinimi i qytetarëve në tendën e vendosur në Sheshin e Qytetit për një periudhë të caktuar dhe në hapësirën e Viva Fresh-it në Qendrën tregtare "Village" (122 doza), në Xhaminë e Madhe të Ferizajt (6 doza), vaksinimin e refugjatëve afganë në kampin e NATO-së në Ferizaj (508 doza), si dhe vaksinimin e nxënësve në shkollat e mesme dhe fillore (2170 doza). Ekipi mobil ka realizuar gjithsej **3268 doza të vaksinave kundër COVID 19.**

Gjatë kësaj periudhe në Qendrën e Vaksinimit Anticovid ka pasur pesë vizita mbikqyrëse nga Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë dhe raportet kthyesë të tyre kanë qenë pozitive. Sfidë kryesore gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator ka qenë numri jo i mjaftueshëm i ekipeve mjekësore në vaksinim në krahasim me interesimin e shtuar të qytetarëve për vaksinim.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sektori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë këtij viti, funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e shërbimeve të përhershme: Shërbimet konsultative nga mjeku i përgjithshëm, mjeku familjar dhe specialistët e tjerë (fiziatri, oftalmologu), shërbimet e shëndetit oral, shërbimet infermierike, shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe

fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas), shtëpiake, emergjente dhe diagnostike. (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet rëntgenologjike).

Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për *periudhës Janar-Dhjetor 2021*, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave dhe sektorëve, me sa vijon:

- **Në QKMF:** janë ofruar **215 697** shërbime shëndetësore, prej tyre **49 609** janë vizita mjekësore kurse **166 088** shërbime infermierike.
- **Në QMF 1:** janë kryer **137 240** shërbime shëndetësore, prej tyre **29 411** janë vizita mjekësore, kurse **107 829** shërbime infermierike.
- **QMF 2:** janë kryer **182 612** shërbime shëndetësore, prej tyre **50 544** janë vizita mjekësore kurse **132 068** janë shërbime infermierike dhe të tjera.
- **QMF 3 - Greme:** janë kryer **19 514** shërbime shëndetësore, prej tyre **5 073** janë vizita mjekësore kurse **14 441** shërbime infermierike.
- **QMF 4:** janë kryer **77 655** shërbime shëndetësore, prej tyre **21 528** janë vizita mjekësore kurse **56 127** shërbime infermierike.
- **QMF 5 - Komogllavë:** janë kryer **11 540** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 355** janë vizita mjekësore kurse **8 185** shërbime infermierike.
- **QMF 6 - Pleshinë:** janë kryer **8 487** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 163** vizita mjekësore dhe **5 324** shërbime infermierike.
- **QMF 7 - Neredime:** janë kryer **3 683** shërbime shëndetësore, prej tyre **1 397** vizita mjekësore dhe **2 286** shërbime infermierike.
- **QMF 8 - Dardani:** janë kryer **13 794** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 644** vizita mjekësore dhe **10 150** shërbime infermierike.

- **AMF – të** – janë kryer **11 613** shërbime shëndetësore, prej tyre **2 111** vizita mjekësore kurse **7 347** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar dhe QMF 2, ka kryer **62 806** shërbime shëndetësore, nga të cilat **36363** vizita mjekësore dhe **26 443** shërbime infermierike. Prej tyre **38 743** shërbime janë kryer në QKMF (SHEP) dhe **26 443** shërbime në QMF 2.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – ka kryer gjithsej **21 321** shërbime, nga të cilat **10662** vizita mjekësore dhe **10 659** shërbime infermierike. Prej tyre **10 140** shërbime janë ofruar në QKMF (SHEP) dhe **11 181** në QMF 2.

Tabela 1. Numri i shërbimeve në të gjitha QMF-të dhe AMF-të

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierike	Numri i përgjithshëm i shërbimeve
QKMF	49 609	166 088	215 697
QMF 1	29 411	107 829	137 240
QMF 2	50 544	132 068	182 612
QMF 3 - Greme	5 073	14 441	19 514
QMF 4	21 528	56 127	77 655
QMF 5 - Komogllavë	3 355	8 185	11 540
QMF 6 - Pleshinë	3 163	5 324	8 487
QMF 7 - Neredime	1 397	2 286	3 683
QMF 8 - Dardani	3 644	10 150	13 794
AMF - të	2 111	7 347	11 613
Kujdestaria e natës	36 363	26 443	62 806
Kujdestaria e të dielave	14 736	14 538	29 274

2. SHËRBIMET DIAGNOSTIKE

2.1. Njësia e laboratorit

Personeli i laboratorëve në pesë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë këtij viti arrin në **146 242** analiza, prej të cilave **132 052** janë analiza gjaku dhe **14 190** analiza urine.

Tabela 2. Numri i shërbimeve në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsej
QKMF	7 334	78 222	85 556
QMF 1	2 153	20 370	22 523
QMF 2	3 935	28 514	32 449
QMF 3 (Greme)	357	1 835	2 192
QMF 4	369	3 111	3 480
Totali	14 190	132 052	146 242

2.2. Njësia e radiologjisë

Njësia e Radiologjisë në kuadër të QKMF-së është e ndarë në gjashtë kabine: RTG në DAT, RTG digjital në SHEP, RTG dental, Mamografia dhe kabinetet e dy radiologeve të pajisura me aparate të ultrazërit. Gjatë *periudhës Janar-Dhjetor 2021* në këtë njësi janë kryer këto shërbime:

Tabela 3. Shërbimet në Kabinetin e RTG-së

Shërbimet	Numri i shërbimeve
Vizita specialistike radiologjike	4 042
Radiografia të extremiteteve	13 266
Radiografi të mushkërive	4 991
Radiografi e dhëmbit	591
Echo e abdomenit	166
Echo e gjirit	263
Echo e qafës	38
Echo e gjëndrës tiroide	9
Echo të tjera	98
Mamografi eksponime	3 081
Lexim i radiografive	2 765
Mamografi lexim	533
Gjithsej	29 843

3. DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në DAT gjatë periudhës *njëvjeçare Janar-Dhjetor* 2021 për raste të dyshuara (supozuara) për TB janë punuar 511 baciloskopi, prej të cilave 51 pacientë kanë rezultuar pozitiv.

Tabela 4. Shërbimet në Dispanzerin Antituberkular

Shërbimet	Numri
Vizita specialistike	2582
Edukim shëndetësor	2207
Përpunim i kontaktit	202
TBC pulmonare	32
Raste të reja me TB	51
TBC Extrapulmonare	18
Baciloskopi	511
BK+	103
Laborator (Se)	58
PPD	334
Vizita shtëpiake	183
Inhalime	44
Testi i HIV-it	21
Gjithsej	6 346

4. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- Edukimi shëndetësor dhe
- Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

4.1. Edukimi shëndetësor

Promovimi dhe edukimi shëndetësor, si një lëvizje për përmirësimin e shëndetit individual dhe të popullatës në mbarë botën, konsiderohet si ombrellë e shprehjes së një sërë aktiviteteve të cilat përqipen të rrisin mirëqenien fizike, mentale dhe sociale, parandalojnë sëmundjet dhe njëkohësisht të ndikojnë në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit.

8. Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare.
9. Me përmirësimin e situatës epidemiologjike me Covid-19 të vazhdohet me zonimin dhe listimin e pacientëve.
10. Implementimi i tërësishëm i SISH-it dhe programit të SMSF-së.

SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE

Sektori i Mirëqenies Sociale në kuadër të DSHMS-së ofron shërbime sociale për qytetarët në nevojë, për shërbimet profesionale sipas infrastrukturës ligjore dhe standardeve për shërbime sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të gjitha kategoritë në nevojë për shërbime sociale trajtohen nga institucionet profesionale relevante, Qendra për Punë Sociale, ku ofrohen Shërbime Sociale dhe Skema e Asistencës Sociale - ndihma ekonomike për familjet dhe personat që janë në nevojë socio-ekonomike. Përveç përkrahjes institucionale qytetarët përfitojnë shërbime dhe ndihma materiale edhe nga shoqatat e ndryshme të licencuara për shërbime sociale dhe nga donatorët vullnetmirë të cilët në koordinim me DSHMS-në përkrahin familjet skamnore të identifikuara nga zyrtarët kompetentë (profesionistët e Qendrës për Punë Sociale).

DSHMS - Sektori i Mirëqenies Sociale, përkujdeset me përkushtim profesional për kategoritë e cenueshme shoqërore si për personat me aftësi të kufizuara (me nevoja të veçanta) për çka në bashkëpunim me OJQ-në PEMA, rreth 70 fëmijëve me nevoja të veçanta u ofrohet trajtim profesional psiko-motorik dhe psiko-social. Gjithashtu, mbështeten edhe fëmijët e braktisur pa përkujdesje prindërore të cilët i trajtojmë me prioritet duke u ofruar përkujdesje institucionale dhe strehim familjar, gjatë vitit 2021 Komuna e Ferizajt ka pasur 6 (gjashtë) familje që kanë pranuar shërbime për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Për personat me ngecje në zhvillim mendor përkujdesemi me staf profesional të DSHMS-së në Shtëpinë me Bazë në Komunitet, ku për momentin në strehim rezidencial qëndrojnë 11 persona të cilët strehohen nga komisioni i DSHMS-së, pasi që nga Gjykata Themelore u është marr zotësia e veprimit me propozimin e QPS-ve në nivel rajonal.

Bashkëpunime shumë të frytshme kemi me OJQ-të lokale e vendore si Handikos, Hendifer, Ofap, Strehimorja për Viktimat e Dhunës në Familje “Shtëpia ime” por edhe me organizata ndërkombëtare si me GIZ-in Gjerman, me OSBE-në, me "Save the Children", "Relief Islamic", "Qatar Charity", KFOR-in Amerikan etj.

Kemi pasur kërkesa të shumta për trajtim, shërim, për pagesë të qerasë, për mbështetje me artikuj ushqimor e higjienik, mirëpo mungesa e një vije buxhetore, në të shumtën e rasteve e pamundëson mbështetjen e familjeve në nevojë, të cilët nuk kanë kurrfarë burimi të të ardhurave. Kjo është një sfidë që po na përcjell në vazhdimësi, prandaj DSHMS është duke u angazhuar në formimin e një fondi për mbështetje momentale për rastet emergjente.

Ne si zyrtarë të DSHMS-së jemi të angazhuar në disa grupe punuese për shërbime sociale si për trajtimin dhe ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar, në komisionin për trajtimin e dhunës në familje etj. Edhe pse me shumë sfida dhe obligime të shumta nga viti i kaluar, po vazhdojmë tu përgjigjen kërkesave dhe nevojave të qytetarëve duke u ofruar shërbime sociale dhe përkrahje materiale. Gjithashtu, është një numër i konsiderueshëm i lehonave për mbështetje me shumën 100 euro, respektivisht sipas të dhënave që posedojmë, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2021 kanë aplikuar 834 nëna për këtë mbështetje materiale.

Në periudhën Janar – Dhjetor kemi shpërndarë ndihma nga subvencionet

DSHMS-ja për vitin 2021 ka pasur në dispozicion mjete financiare si kategori e subvencioneve gjithsej 140.000.00 €, për përkrahje të rasteve më të rënda me shuma simbolike përballë nevojave dhe kostove për trajtime shëndetësore dhe për nevoja socio-ekonomike. Në vazhdim bashkëngjesim Raportin vjetor 2021 të Qendrës për Punë Sociale dhe Shtëpisë së Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore.

RAPORT I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Raporti i punës i shërbimeve sociale për periudhën Janar-Dhjetor 2021

Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale. QPS ofron shërbime sociale profesionale për të gjithë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijë të braktisur, fëmijë jetimë, fëmijë me sjellje asociale, delikuentë të mitur, shkurorëzimet dhe besimin e fëmijëve, kontaktimet fëmijë – prind, të moshuarit pa përkujdesje dhe vendosja e tyre në institucione, të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike, të aftësive të kufizuara mendore, të sëmundjes mendore të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi, të dhunës në familje, të trafikut të qenieve njerëzore, krimeve seksuale, fëmijët në situatë rruge, dhuna në shkollë, të varësisë nga alkooli ose drogat, të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu, ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë, mbi 50 kategori të ndryshme.

Gjithashtu QPS-të ofrojnë edhe shërbimin e Ndihmës së Asistencës Sociale e që në Kosovë numri i familjeve përfituese sillet mbi 1000 të cilët për çdo muaj kanë nevojë për shërbimet të QPS-së, intervenimet me pako higjienike dhe ushqimore, intervenimet në kohë krizash siç është pandemia etj.

Veprimtaria e QPS-së përfshinë ofrimin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale për banorët e komunës sonë, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesit dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Koncepti i përkujdesit social konsiston në atë që banorëve të komunës sonë t’iu ofrojë dhe zbatojë përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: Psikologji, Punë Sociale, Sociologji, Juridik, Pedagogji, përmes caktimit të ekspertëve profesional të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshëm në sistemin e përkujdesit social dhe të mirëqenies sociale dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultant në përkujdesin dhe mirëqenien sociale.

Përkujdesi dhe mirëqenia sociale në QPS-së sigurohet dhe zbatohet nga zyrtarët e shërbimeve sociale dhe të skemës sociale të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Kosovë.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE

JANAR - DHJETOR 2021

Kategoritë mbrojtëse	Rastet e vjetra	Rastet e reja 2021
Delikuenca e të miturve	41	50
Fëmijët me sjellje asociale	13	24
Fëmijë të keqtrajtuar	1	14
Fëmijë të braktisur të porsalindur	4	1
Fëmijë pa përkujdesje pr.të strehuar tek të afërmit me pagesë		30
Kërkesa për fëmijë me aftësi të kufizuara	504	18
Fëmijë me aft. të kufizuara në pagesë		117
Kujdestaria ndaj fëmijëve	3	3
Kërkesa për adoptim vendor	13	2
Kërkesa për adoptim ndërkombëtar	0	0
Fëmijë jetim	0	1
Rrëmbime ndërkombëtare	0	0
Vendosja në strehimore	0	8
Dhuna në familje	0	27
Viktima të krimeve seksuale	2	2
Viktima të trafikimit	0	0
Çrregullimet bashkëshortore	38	50
Familje strehuese	5	1
Mbrojtja e personave të moshuar	0	0
Klientë të tjerë	414	727
Puna e rrezikshme	0	0
Përdoruesit e substancave narkotike	1	0
Përdoruesit e alkoolit	0	0
Martesa e të miturve	0	2
Intervenimet e përgjithshme	2729	4624
Gjithsej:	3768	5701

Shërbimet Sociale veprojnë sipas Ligjit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare Ligji nr. 02/L-17, Ligji i Familjes 2004/32, Ligji për Mrojtjen e Femijëve, Ligji Nr.06/L-084, Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074 etj.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMIT TË S.N.S -së

Nëpunësit e S.N.S-së të Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj kanë pranuar të gjitha kërkesat e asistencës sociale në harmoni të plotë me Ligjin 2003/15.

Në periudhën **Janar-Mars-Qershor-Shtator-Dhjetor 2021** - numri i kërkesave që kanë aplikuar **për herë të parë është:**

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtim	Gjithsej
Janar	17	0	0	17
Shkurt	26	1	0	27
Mars	23	1	0	24
Prill	6	1	0	7
Maj	10	0	0	10
Qershor	9	0	0	9
Korrik	7	0	0	7
Gusht	7	0	0	7
Shtator	12	0	0	12
Tetor	10	0	0	10
Nëntor	13	1	0	14
Dhjetor	7	0	0	7
Totali	145	4	0	151

Nga lista e pagesave për mos riaplikim nuk ka familje të cilat nuk e vazhdojnë ndihmën sociale (në bazë të vendimeve siç janë Vendimi nr.17/2021 dhe vendimi 17/16 të Ministrisë pala nuk ka qenë e obliguar të bëjë ri-aplikimin, por kategoria II ka qenë e obliguar të lajmërohet në zyrën e punësimit), disa raste të kategorisë II nuk ka qenë e mundur të riaplikohen, për shkak të mos lajmërimit në Zyrën e Punësimit.

Muaji	Numri i familjeve
Janar	0
Shkurt	0
Mars	0
Prill	0
Maj	0
Qershor	0
Korrik	0
Gusht	3
Shtatore	2
Tetor	3
Nëntor	2
Dhjetor	4
Total	14

NUMRI I FAMILJEVE QË JANË VERIFIKUAR DHE RIVERIFIKUAR

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Totali
Janar	147	0	147
Shkurt	153	5	158
Mars	185	1	186
Prill	152	3	155
Maj	148	5	153
Qershor	78	7	85
Korrik	89	5	94
Gusht	121	8	129
Shtator	116	8	124
Tetor	128	7	135
Nëntor	136	5	141
Dhjetor	128	5	133
Totali	1581	59	1640

Gjatë riverifikimit nëpunësit e **S.N.S-së** kanë refuzuar - **42** - familje që nuk i plotësojnë kriteret sipas Ligjit të SAS-it 2003/15.

Prej familjeve që kemi riverifikuar janë aprovuar - **1189** - kërkesa të asistencës sociale.

Nëpunësit e **SNS-së** mesatarisht për çdo muaj kanë realizuar përafërsisht - **396** - ri aplikime, këtu hyjnë edhe lëndët e vjetra edhe të reja, ky numër i rasteve për një zyrtar është jashtëzakonisht i madh, por mungesa stafit tjetër gjatë kësaj periudhe na detyron t'i përgjigjemi palëve në nevojë.

Gjatë periudhës Janar-Mars-Qershor-Shtator-Dhjetor: janë dërguar 138 - Lëndë në komision mjekësor; 130 - kërkesa janë aprovuar nga komisioni mjekësor, kurse 0 - kërkesa janë kthyer për kompletim të dokumentacionit mjekësor. Nga komisioni mjekësor janë refuzuar 45 - lëndë.

Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmave sociale gjatë nëntëmujorit janë 28 - ankesa.

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (shkalla e dytë) janë refuzuar 27 - ankesa, ndërsa nga DNS-ja janë aprovuar 1 - ankesa, në shqyrtim janë - 0 - ankesa.

Lëndë që presin prej gjykatës kontestin gjyqësore janë - 0 - lëndë, kurse lëndë që janë shqyrtuar negativisht apo pozitivisht nga ana e gjykatës nuk kemi.

Janë lëshuar - 222 - vërtetime për familjet që janë dhe nuk janë shfrytëzues të asistencës sociale, e të cilat kanë shprehur dëshirën të konkurrojnë në komunat tjera për ndihmë dhe për rregullimin e dokumentacionit për bursës dhe për udhëtim (mujores) dhe në Komunë për ndihmë momentale si dhe për aplikim për banim.

DONATORËT

1. TiKa Turke 130 pako ushqimore dhe higjienike
2. DPSE-DNS-së - 125- pako me veshmbathje dhe 70 pako ushqimore
3. Donatori “Eli Abi” - 360 - familje me pako ushqimore
4. Donatori “Qatar Charity” - 400 -familje me pako ushqimore
5. Donatori Organizata “Islamic Relief - Kosova” - 250 - familje me pako ushqimore
6. KFORI Amerikan 10 pako ushqimore
7. UNDP ndihmoi 290 familje me kuponë në vlerë prej 60 deri në 70 euro varësish nga nr. anëtarëve të familjes
8. IOM ndihmoi 161 familje të komunitetit RAE me kuponë në vlerë prej 60 deri në 70 euro varësish nga nr. anëtarëve të familjes.
9. UNDP ndihmoi 85 familje me nga një kupon për muajin Nëntor në vlerë prej 60 deri në 70 euro varësisht nga nr. anëtarëve të familjes
10. UNDP ndihmoi 44 familje me nga 2.27m³ dru (lëndë djegëse)

RAPORTI VJETOR I SHPËRNDARJES SË NDIHMAVE SOCIALE
SIPAS KATEGORIVE

Muaji	Kateg.1	Kateg .2	Nr. i familjeve	Nr.i anëtarëve	Totali
Janar	591	399	990	4123	212,687.50 €
Shkurt	591	411	1002	4156	215,187.50 €
Mars	609	424	1033	4273	222,222.00 €
Prill	601	418	1019	4209	193,040.00 €
Maj	602	413	1015	4168	138,500.00 €
Qershor	600	414	1014	4161	138,349.00 €
Korrik	610	394	1004	4112	136,698.50 €
Gusht	610	388	998	4092	135,482.25 €
Shtator	605	399	1004	4098	136,237.50 €
Tetor	623	396	1019	4177	138,656.25 €
Nëntor	626	395	1021	4182	265,465.00 €
Dhjetor	624	409	1033	4211	268,297.25 €
Totali					2,200,822.75 €

Familjet shfrytëzuese të asistencës sociale të zëna nga ATK - ja, të cilat punojnë në firma të ndryshme dhe kanë përfituar ndihmën sociale pa bazë ligjore.

Muaji	Kateg -I-	Kateg -II -	Totali
Janar	1	0	1
Shkurt	1	1	2
Mars	1	0	1
Prill	0	2	2
Maj	4	5	9
Qershor	1	1	2
Korrik	2	3	5
Gusht	2	4	6
Shtator	0	0	0
Tetor	1	0	1
Nëntor	1	4	5
Dhjetor	1	3	4
Totali	15	23	38

Nga njoftimet me shkrim të DPSF/MFPT, në bashkëpunim me ATK-në, jemi të njoftuar se 38 familje si shfrytëzuese të ndihmave sociale, kanë anëtarë të familjeve të tyre të punësuar. Gjatë konsultimit me 38 shfrytëzuesit e SNS-së të cilët janë hasur duke punuar dhe njëherit duke i njoftuar me procedurat dhe pasojat që mund t'i kenë për mos kthimin e pagesave, kemi arritur që t'i bindim për kthimin e ndihmës sociale disa prej tyre. Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të nëpunësve të S.N.S-së , duke e parë gjendjen e rendë ekonomiko-sociale të familjeve të cilët janë në varfëri të skajshme, edhe përkundër kërkesave të mëdha (numrit të madh të popullatës) si dhe numrit të vogël të nëpunësve iu janë përgjigjur kërkesave të qytetarëve.

Nëpunësit e S.N.S-së gjatë verifikimit dhe riverifikimit të rasteve sociale i përcjellin probleme të shumta nga aplikantët të cilët nuk e gëzojnë asistencën sociale. Një numër i konsiderueshëm i rasteve sociale mendojnë se këto ndihma ju takojnë vetëm pse kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare, të tjerët pse kanë fëmijë të hendikepuar nën moshën 18 vjeçare, por tani ekziston Udhëzimi Administrativ Nr.03/2009 për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme.

SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDOR-FERIZAJ

RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN 01/01/2021- 20/12 /2021

- Gjendja shëndetësore e rezidentëve
- Furnizimi me ushqim, barna ,material higjienik,ujë,rrymë etj
- Aktivitetet me rezidentë
- Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve
- Sfidat dhe pengesat në punë

Gjendja shëndetësore e rezidentëve

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, pothuajse të gjithë rezidentët kishin shëndet të mirë dhe stabil, me përjashtim të rezidentes A.E e cila është përballur me trumbozë në të dy këmbët. Trajtimi i saj ka zgjatur për disa muaj rresht, momentalisht gjendja saj shëndetësore është më stabile. Gjatë muajit Mars dhe fillim të muajit Prill zakonisht në periudhën e kalimit nga sezona e dimrit në sezonën e pranverës disa nga rezidentët shfaqin një lloj agresiviteti të papërballueshëm ndaj stafit, ndaj rezidentëve dhe duke dëmtuar edhe inventarë apo gjësende në momentin e caktuar që ka para vetes. Falë angazhimit të stafit punonjës me masa preventive lehtë e kaluam këtë periudhë. Ajo e cila na vështirësoi situatën ishte pandemia Covid 19, mirëpo falë angazhimit shembull të stafit ne po ia dalim mirë. Më datë 19.04.2021 vlen të ceket vaksinimi kundër Covid 19 i rezidentëve i cili është kryer me sukses, në përjashtim të rezidentës (A.E- për arsye probleme shëndetësore të saj). Gjithashtu është realizuar edhe vaksinimi i pjesës së dytë të vaksinës me datë 07.07.2021. Stafi ynë ka qenë aktiv dhe në përkujdesje të rezidentëve gjatë gjithë kohës, ku kemi përcjellë gjendjen e tyre shëndetësore.

Furnizimi me ushqim,material higjienik, barna, ujë, rrymë, derivate etj.

Si zakonisht kompanitë e autorizuar e sjellin ushqimin nga fundi i javës së parë të muajit, ku së bashku me stafin që është në ndërrim përkujdesemi që malli i sjellur të jetë sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar paraprakisht dhe vazhdimisht duke kompletuar dokumentacioni e nevojshëm përcjellës siç janë fletëdërgesat dhe vendimet për pranimin e çdo furnizimi duke e nënshkruar nga stafi kujdestar.

Kur është fjala tek ushqimi duhet cekur gjithsesi një gjest bamirësie të qytetarit B.Avdiu i cili punon në Gjermani dhe kishte shprehur dëshirën që gjatë gjithë muajit të Ramazanit iftarin për 13 persona dhe për tri ditë festë (Bajram) ushqimin e drekës ka kontraktuar një gjelltoke nga qyteti për të dërguar në institucionin tonë.

Sa i përket furnizimit me barna dhe terapi të rregullt, prej muajit Janar 2021 kemi pasur mjaftueshëm. Pas përzgjedhjes së operatorit furnizimi është i rregullt dhe nuk kemi asnjë problem të furnizimit me barna esenciale, vlen të ceket se kemi vështirësi të nevojës për barna të paparashikuara.

Sa i përket shërbimeve komunale si ujë dhe rrymë nuk ka vërejte deri tani të gjitha pagesat janë në rregull. Në muajin Qershor si donacion kemi pranuar hapjen e pusit nga shoqata ”|Qatar Charity”.

Sa i përket furnizimit me ngrohje qendrore furnizimin e bëjmë me derivate të naftës dhe furnizimi ka qenë i rregullt.

Aktivitetet e stafit me rezidentë

Në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj asnjëherë nuk kanë munguar aktivitete të ndryshme me rezident por në muajt e fillimvitit kryesisht angazhohen në vizatime, lojëra me letra, vallëzim etj. Rezidentët kanë gëzuar një vizitë një javore në Prevallë.

Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve të rezidentëve

Vizitat e familjarëve me rezidentë realizohen varësisht nga kërkesat e familjarëve.

Tjera

Në fund të vitit ne kemi bërë kërkesë tek “Caritas”, të cilët na kanë furnizuar me veshmbathje të përdorura të cilat na kanë lehtësuar punën.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2021

Sabri Murseli
Drejt看 i Drejtorisë së Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e Komunës së Ferizajt:

Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

Në kuadër të kësaj kjo drejtori është e ndarë në tre sektor: Sektori i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me lëndët e pranuar dhe të administruara nga tre sektorët e Drejtorisë.

Sektori i Kadastrit është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

1 *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA*

1.1 Në sektorin e Kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- Kërkesa për Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit janë pranuar gjithsej 10943 kërkesa, të miratuara janë 10903, të refuzuara gjithsej janë 40 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim i Hipotekave janë pranuar 182 nga të cilat janë miratuar 182, kërkesa ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç’regjistrim i Hipotekave janë pranuar 166 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 166, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i Trashëgimeve janë pranuar 531 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 525, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë, në procedurë 6.
- Kërkesa për Regjistrim i Shitblerjeve janë pranuar 2199 kërkesa nga të cilat janë miratuar 2016, të refuzuara 52 kërkesa, në procedurë 131 lëndë.
- Kërkesa për Regjistrim i Faljeve janë pranuar 861 kërkesa nga të cilat janë miratuar 839, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë, në procedurë 22 lëndë.
- Kërkesa për Regjistrim i këmbimeve dhe ndarjeve fzikë janë pranuar 85 kërkesa nga të cilat janë miratuar 82, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë, në procedurë 3 lëndë.
- Kërkesa për Regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 43 nga të cilat janë miratuar 43 kërkesa, ndërsa nuk janë refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç’regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 28 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 28 kërkesa kurse nuk janë refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa Regjistrim i Masave Siguruese kemi pranuar 21 kërkesa, janë përfunduar 21, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç’regjistrim i Masave Siguruese kemi pasur gjithsej 19 kërkesa, janë përfunduar 19, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Vërtetime për Nevoja Personale i kemi pasur gjithsej 616 kërkesa, janë përfunduar 616 kërkesa ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për regjistrim i servitutit 2 lëndë.
- Kërkesa për vërtetimi qe nuk posedon paluajtshmëri 209 lëndë.

• **STATISTIKAT**

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Kadastrit gjatë vitit 2021	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit	10943	10903	40	/
Regjistrim i Hipotekave	182	182	/	/
Ç'regjistrim i Hipotekave	166	166	/	/
Regjistrim i Trashëgimive	531	525	/	6
Regjistrimi i Shitblerjeve	2199	2016	52	131
Regjistrim i Faljeve	861	839	/	22
Regjistrim i këmbimeve dhe ndarjeve fizike	85	82	/	3
Regjistrim i barrëve tatimore	43	43	/	/
Ç'regjistrim i barrave tatimore	28	28	/	/
Regjistrim i Masave Siguruese	21	21	/	/
Ç'regjistrim i Masave Siguruese	19	19	/	/
Vërtetime për Nevoja Personale	616	616	/	/
Kërkesa për regjistrim i servitutit	2	2	/	/
Kërkesa për vërtetimi qe nuk posedon paluajtshmëri	209	209	/	/
Totali	15905	15651	92	162

Totali i kërkesave ose lëndëve të pranuar në Sektorin e Kadastrit (RDPP-së), gjatë vitit 2021 ka qenë 15905 kërkesa, të përfunduara janë 15651 kërkesa, në procedurë janë 162 kërkesa, 92 kërkesa janë refuzuar për arsye të ndryshme.

SEKTORI I GJEODEZISË është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

• **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA**

1.1 Në Sektorin e Gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- Kërkesa për bashkim të parcelave janë pranuar 33 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 33.
- Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri janë pranuar 52 kërkesa nga të cilat janë miratuar 52.
- Kërkesa për ndërrim kulture janë pranuar 5 kërkesa nga të cilat janë miratuar 5, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrime të copëtimit kemi pranuar 1041 kërkesa, janë miratuar 1001, ndërsa janë refuzuar 22 kërkesa, 18 janë në procedurë.
- Kërkesa për Rregullim i kufirit janë pranuar 72 kërkesa nga të cilat janë miratuar 72 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim të Objektivit - legalizim janë pranuar 143 kërkesa nga të cilat janë miratuar 143 kërkesa.
- Kërkesa për modifikime dhe regjistrime është pranuar vetëm 5 kërkesa dhe janë përfunduara.
- Produkte kadastrale 1427, prej të cilave janë miratuar 1411, janë refuzuar 7, të terhequra 9.
- Kërkesa për kopje plani nga personat privat dhe institucionet shtetërore 2440.

• **STATISTIKAT**

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Gjeodezisë gjatë vitit 2021	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara -€
Modifikime	5	5	/	/	
Kërkesa për bashkim të parcelave	33	33	/	/	
Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri	72	72	/	/	
Kërkesa për ndërrim kulture	5	5	/	/	
Regjistrim i copëtimit	1041	1001	22	18	
Rregullim i kufirit	52	52	/	/	
Regjistrimi i Objektivit - legalizim	143	143	/	/	
Kopje të Planit	2170	2170	/	/	
Kopje të Planit Zyrtare	270	270	/	/	
Produkte kadastrale	1427	1411	16		
Të ndryshme	27	27	/	/	
TOTALI	5245	5189	38	18	

Totali i kërkesave ose lëndëve të pranuar në Sektorin e Gjeodezisë, gjatë vitit 2021 ka qenë 5245 kërkesa, të përfunduara janë 5189 kërkesa, në procedurë janë 18 kërkesa, 38 kërkesa janë refuzuar për arsye të ndryshme.

Sektori i Pronës merret me menaxhimin e pronave komunale, ku përfshihet mbajtja e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna, me zhvillimin e procedurës së shpronësimit, këmbimit të tokës në pronësi të Komunës me tokën e personave privat të planifikuar për interes publik, si dhe me trajtimin dhe zhvillimin e procedurave administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

1. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA -

1.1 Në Sektorin e Pronës janë pranuar kërkesat në vijim:

- Në lëmin e uzurpimeve janë pranuar gjithsej 71 kërkesa, të përfunduara janë 59, në procedurë 12 kërkesa.
- Në lëminë e destinimeve janë pranuar 404 kërkesa, janë përfunduar 343, në procedurë janë 61 kërkesa.
- Në lëminë e shpronësimeve janë pranuar 21 kërkesa, të përfunduara 14, në procedurë janë 7 kërkesa.

STATISTIKAT

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Pronës gjatë vitit 2021	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara-shpenzuara €
Uzurpime	71	59		12	
Destinime dhe përgjigje në kërkesa	404	343		61	
Shpronësime	21	14		7	
Totali	496	416		80	

Në lëminë e uzurpimeve bëjnë pjesë: inçizimet gjeodezike dhe caktimet e kufijve të rrugëve, lumenjve, objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, zyrave të gjendjes civile, institucioneve Fetare etj., të gjitha ato të cilat janë të poshtëshënuara.

- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numer 21-0 Z.K. Nikadin,
- Nikadin.Inçizimi i ngastrës kadastrale 890-12 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 719-0 Z.K. Mirosalë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1094-0, 1104-0 Z.K Jezerc,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 888-0 dhe 890-12 Z.K. Ferizaj,

- Inçizimi i ngastrës kadastrale 245-0 Z.K. Softaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1307-2 Z.K. Zaskok,
- Inçizimi i ngastës kadastrale 1111-1 Z.K. Zllatar,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1544-0 Z.K. Gaçkë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 768-0 Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 614- Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 260-0 Z.K. Greme,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1735-0 Z.K. Mirash,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 216-2 dhe 2116-3 Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 704-3, 704-1, 705-0, 706-0, 707 Z.K. Zllatar,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 57-0 dhe 54-1 Z.K. Koshare,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1094-6 Z.K. Jezerc,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 192-1 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastës kadastrale 1107-3 Z.K. Prelez i Jerlive,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3201-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 2994-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 535-0 dhe 754-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3277-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 3285-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 980-0 Z.K. Talinoc i Jerlive,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 3283-2 dhe 3283-1 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 969-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3119-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 103-1, 102-5 dhe 102-3 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3274-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3236-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3310-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3321-0 Z.K. Ferizaj,
- Inçizimi i ngastës kadastrale 1191-1 Z.K. Prelez i Jerlive,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1240-1 Z.K. Prelez i Jerlive,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 2181-7, 2181-9, 2181-11, 2182-6 dhe 2182-8 Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 806-2 Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 702-30 Z.K. Dardani,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 2155-8 Z.K. Mirosalë,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 2165-13 dhe 2165-7 Z.K. Mirosalë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 2164-7 Z.K. Mirosalë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3287-7 Z.K. Greme,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 755-8 Z.K. Pojatë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 298-4 Z.K. Muhoc,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 707-2 dhe 715-2 Z.K. Gaçkë,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 1147-46 dhe 42-7 Z.K. Kosinë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 767-10 Z.K. Sazli,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 757-2 dhe 758-19 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3608-2 Z.K. Jezerc,
- Inçizimi i ngastës kadastrale 298-4 Z.K. Jezerc,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 3579-10 Z.K. Jezerc,

- Inçizimi ingastrës kadastrale 549-11 Z.K. Bibaj,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 596-2, 597-2 dhe 967-5 Z.K. Nikadin,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 53-7 Z.K. Fshati i Vjetër,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 92-4 dhe 106-2 Z.K. Fshati i Vjetër,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 500-30, 500-32 dhe 500-35 Z.K. Fshati i Vjetër,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 1907-136 Z.K. Neredime e Epërme,
- Inçizimi i ngastrave kadastrale 2110-16 dhe 2110-18 Z.K. Pleshinë,
- Inçizimi i ngastrës kadastrale 538-0 Z.K. Pleshinë,
- Caktimi i pikave në fsh. Pleshinë ng.kad. 49-0 Z.K. Pleshinë,
- Caktimi i pikave në fshatin Balaj në ng.kad. 535-0 Z.K. Balaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 3277-0 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 5-0 Z.K. Doganaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 417-0 Z.K. Pojatë,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 399-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 997-0 dhe 996-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 967-3, 967-2 dhe 967-1 Z.K. Pleshinë,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 3025-1 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 903-0 Z.K. Prelez i Muhaxherëve,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 3506-0 Z.K. Jezerc,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 3507-0 Z.K. Jezerc,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 180-3 Z.K. Talinoc i Jerlive,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 1770-0 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive,
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 629-2 Z.K. Babush i Ri,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 693-3 Z.K. Softaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. të lumit 179-0 Z.K. Zaskok,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 318-2 Z.K. Lloshkobare,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 839-0 Z.K. Koshare,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 693-0 Z.K. Zllatar,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 1677-0 dhe 3485-0 Z.K. Jezerc,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 3090-0 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 11-1 Z.K. Prelez i Jerlive,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 95-0 Z.K. Nikadin,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 94-1 Z.K. Balaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 627-0 Z.K. Greme,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 2981-17 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 1041-0 Z.K. Ferizaj,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 1133-0 Z.K. Neredime e Epërme,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 2079-0 Z.K. Pleshinë,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 2112-0 Z.K. Komogllavë,
- Caktimi i pikave në ng.kad. 694-2 Z.K. Softaj,

Në lëmin e destinimeve: bëjnë pjesë propozim-vendimet për shpalljen e interesit të përgjithshëm, propozim - vendimet për Këmbimin e pronave komunale me pronat private, propozim-vendimet për destinimin e pronave komunale, propozim-vendimet për dhënie në shfrytëzim etj.

Kërkesat drejtuar Ministrisë së Financave- Departamentit të Tatimit në Pronë-ZVPP-së për parcelat të cilat janë në fazën e vlerësimit të tokave si në lëmin e shpronësimit ashtu edhe në lëmin e këmbimit të pronave, përgjegjet në kërkesa të ushtruar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit për parcelat të cilat janë në fazën e likuidimit, kërkesat të cilat kanë ushtruar qytetarët për ri-regjistrimin e parcelave, kërkesat e qytetarëve për faljen e paluajtshmerive të tyre për rrugë, varreza, etj, kërkesat brenda sektorëve drejtuar kadastrit dhe gjeodezisë për zbatim të vendimeve në RDPP, çertifikata të pronës, produkte, kërkesë për coptime etj.

Propozim-vendime për Kuvend të Komunës - 11

- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për ngastrën kadastrale 694-1 Zk. Prelez i Jerlive.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për ngastrën kadastrale 547-1 Zk. Pleshinë.
- Propozimi- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për ngastrën kadastrale 2665-0 Zk. Komogllavë.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshme për pjesët e ngastrave kadastrale 57-1, 57-2, 62-0, 63-0, 152-0 Zk. Sazli dhe të pjesëve të ngastrave kadastrale 260-0, 259-1 Zk. Papaz.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastës kadastrale 3148-0 Zk. Ferizaj.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 674-0 Zk. Rahovicë.
- Vendim për Dhënien në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale 570-1 dhe 3569-1 Zk. Ferizaj.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për ngastrat kadastrale 630-0, 632-0, 633-0, 634-0 Zk. Komogllavë.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 1091-10 Zk. Ferizaj.
- Propozim- Vendim për Dhënien në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale 629-1 Zk. Babush i Ri.
- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 1022-0 Zk. Gaçkë.
-

Në lëmin e shpronësimeve: bëjnë pjesë lëndet të cilat janë në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër Vendimeve Përfundimtare të Shpronësimit, respektivisht rritjes së shpërblimit për tokat e shpronësuara, lëndë të cilat janë për vlerësim në MF.

Deklarata për Falje 73

- Deklarat për fajle nga Minir Haxhimusa etj nga fsh. Doganaj e fal ngastren kadastrale 538/0 Zk. Pleshinë me sip. 3615m².
- Deklaratë për falje e Sadri Sejdiut etj nga fsh. Jezerc e fal ngastren kadastrale 3579/10 Zk. Jezerc me sip.897 m².

- Deklaratë për falje e Jetmir Mehmeti nga Ferizaj e fal ngastren kadastrale 3286/0 Zk. Ferizaj me sip.1010 m².
- Deklaratë për falje e Kushtrim Ferizit nga Ferizaj e fal ngastren kadastrale 3297/0 Zk. Ferizaj me sip. 508 m².
- Deklaratë për falje e Ali Ibishit nga fsh. P.i Jerlive e fal ngastren kadastrale 919/2 Zk. Jezerc me sipërfaqe prej 672 m².
- Deklaratë për falje e Hismet Mehmeti etj nga fsh. Pleshinë e fal ngastren kadastrale 492/13 Zk. Pleshinë me sipërfaqe prej 355 m².
- Deklaratë për falje e Gentrit Bytyqit nga fsh. Mirosalë e fal ngastren kadastrale 2164/7 Zk.Mirosalë me sip.214 m².
- Deklaratë për falje e Murat Bucaliut dhe Avni Halilit nga fsh. Fshati i Vjetër dhe Gaçkë e fal ngastren kadastrale 92/1 Zk. Fshati i Vjetër me sip. 222 m² dhe ng.kad. 106/2 Zk. Fshati i Vjetër me sip.220 m².
- Deklaratë për falje e Halil Berisha dhe Kimete Berisha nga fsh. Nikadin e fal ngastren kadastrale 597/2 me sip. 260 m² dhe ngastren kadastrale 596/2 Zk. Nikadin me sip. 349 m².
- Deklaratë për falje e Fahri Piraj nga fsh. Bibaj e fal ngastren kadastrale 549/11 Zk. Bibaj me sip. 1133 m².
- Deklaratë për falje e Naim Agushit nga fsh. Jezerc e fal ng.kad.298/4 Zk. Jezerc me sip.300 m².
- Deklaratë për falje e Sami dhe Enver Guta nga fsh. N.Eperme e fal ng.kad.3608/2 Zk. Jezerc me sip. 211 m².
- Deklaratë për falje e Mamut Maliqi nga fsh. Rahovicë e fal ng.kad. 758/3 Zk. T.Muhaxhereve me sip.67 m² dhe ng.kad. 757/0 Zk.T. i Muhaxhereve me sip.509 m².
- Deklaratë për falje e Basri Bytyqi e fal ng.kad.2165/7 Zk. Mirosalë me sip. 408 m² dhe ng.kad. 2165/13 Zk. Mirosalë me sip 327 m².
- Deklaratë për falje e Jajush Salih nga Ferizaj e fal ng.kad. 394/10 Zk. Ferizaj me sip. 84 m².
- Deklaratë për falje e Kemajl Ibrahimit etj nga fsh. Sazli e falin ng.kad. 767/10 Zk. Sazli me sip. 745 m².
- Deklaratë për falje e Fehmi Sejdiut nga fsh. Lloshkobare e fal ng.kad. 1147/46 Zk. Kosinë me sip. 1090 m² dhe ng.kad. 42/7 Zk. Lloshkobare me sip. 170 m².
- Deklaratë për falje e Mehdi Berisha nga fsh. Mirosalë e fal ng.kad. 2155/8 Zk. Mirosalë me sip. 505 m².
- Deklaratë për falje e Ajrush Ademit nga fsh Rakaj e fal ng.kad. 443/6 Zk. Rakaj me sip. 550 m².
- Deklaratë për falje e Bashkim Hajdinit nga fsh. P.i Jerlive e fal ng.kad. 1240/1 Zk. P. i Jerlive me sip.600 m².
- Deklaratë për falje e Behar Rexhepit etj nga fsh. Dardani if al ng.kad. 2181/7 me sip. 138 m², 2181/9 me sip. 22 m², 2181/11 me sip. 116 m², ng.kad. 2182/6 me sip. 55 m², ng.kad. 2182/8 me sip. 55 m² Zk. Dardani.
- Deklaratë për falje e Njazi Bytyqit nga fsh. Mirash e fal ng.kad. 3067/4 Zk. Mirash me sip. 399 m² dhe ng.kad. 3066/6 Zk. Mirash me sip. 655 m².
- Deklaratë për falje e Halil Sopaj nga fsh. Koshare e fal ng.kad. 3268/0 Zk. Ferizaj me sip. 142 m².
- Deklaratë për falje e Sherif Rexhepit nga fsh. Muhoc e fal ng.kad. 298/4 Zk. Muhoc me sip 107 m².

- Deklaratë për falje e Azem Halilit nga fsh. Gaçkë e fal ng.kad. 3013/7 Zk. Greme me sip.388 m² dhe ng.kad. 3282/7 Zk. Greme me sip.384 m².
- Deklaratë për falje e Ruzhdi Musliu nga fsh. Pleshinë e fal ng.kad. 892/12 Zk. Ferizaj me sip.322 m².
- Deklaratë për falje e Emri Alit nga fsh Bibaj e fal ng.kad. 755/8 Zk. Pojatë me sip. 1316 m².
- Deklaratë për falje e Isuf Palojes nga Ferizaj e fal ng.kad. 2981/17 Zk. Ferizaj me sip. 679 m².
- Deklaratë për falje e Kemajl Statovcit nga fsh. Cërnillë e fal ng.kad. 865/9 Zk. Cërnill me sip. 1243 m².
- Deklaratë për falje e Riad Bislimit etj nga Ferizaj e fal ng.kad. 1191/1 Zk. P. i Jerlive me sip. 1645 m².
- Deklaratë për falje e Ramadan Bekteshit nga Ferizaj e fal ng.kad. 53/7 Zk. F. i Vjetër me sip 410 m² dhe ng.kad. 53/9 Zk. F. i Vjetër me sip. 409 m².
- Deklaratë për falje e Gafurr Zeqirit nga fsh. Balaj e fal ng.kad. 890/12 Zk. Ferizaj me sip. 316 m².
- Deklaratë për falje e Bahri Xhaferit etj nga fsh. Mirosalë e fal ng.kad. 719/0 Zk. Mirosalë me sip. 177 m² dhe ng.kad. 708/0 Zk. Mirosalë me sip. 285 m².
- Deklaratë për falje e Qamil Ukzmajli dhe Nertil Zeka i falin ng.kad. 1094/2 Zk. Jezerc me sip. 38 m² dhe ng.kad. 1104/0 Zk. Jezerc me sip. 161 m².
- Deklaratë për falje e Muhamet Ferizi etj nga Ferizaj e fal ng.kad. 888/0 Zk. Ferizaj me sip. 153 m² dhe ng.kad. 890/12 Zk. Ferizaj me sip. 230 m².
- Deklaratë për falje e Bajram Krasniqit nga Fsh. Rahovicë e fal ng.kad. 245/0 Zk., Softaj me sip. 915 m².
- Deklaratë për falje e Isak Blenishtit nga Fsh. Zaskok e fal ng.kad. 1307/2 Zk. Zaskok me sip. 597 m².
- Deklaratë për falje e Abedin Topallit etj nga Fshati Zllatar e fal ng.kad. 1111/1 Zk. Zllatar me sip. 194 m².
- Deklaratë për falje e Basri Hasanit nga fsh. Gaçkë e fal ng.kad. 1544/0 Zk. Gaçkë me sip.142 m².
- Deklaratë për falje e Ahmed Sallahut etj nga fsh. Zllatar i falin ng.kad.768/0 Zk. Dardani me sip 321 m², ng.kad. 769/0 Zk. Dardani me sip. 518 m².
- Deklaratë për falje e Fatime Hajdini nga fsh. Dardani if al ng.kad. 614/0 Zk. Dardani me sip. 1674 m² dhe ng.kad. 613/0 me sip. 365 m².
- Deklaratë për falje e Alush Berishes nga Fsh. Nikadin e fal ng.kad. 992/4 Zk. Nikadin me sip.730 m².
- Deklaratë për falje e Afiz Veseli nga fsh. Greme e fal ng.kad. 260/0 Zk. Greme me sip. 74 m².
- Deklartë për falje e Vehat Hashani nga fsh. Mirash e fal ng.kad. 1735/0 Zk. Mirash me sip. 366 m² dhe ng.kad. 1732/1 Zk. Mirash me sip. 74 m².
- Deklaratë për falje e Deli Rexhepit nga fsh. Mirosal. E fal ng.kad. 2163/2 Zk. Dardani me sip. 244 m² dhe ng.kad. 2163/3 Zk. Dardani me sip. 208 m².
- Deklaratë për falje e Kurtesh Topallit etj nga fsh. Zllatar e falin ng.kad. 704/3 me sip, 63 m² 704/1 me sip. 83 m², 705/0 me sip 194 m² , 706/0 me sip. 162 m² dhe 707/0 me sip 290 m².
- Deklaratë për falje e Enver Çerkinit etj nga fsh. Koshare e falin ng.kad. 57/0 me sip. 1469 dhe ng.kad. 54/1 dy poarcelat në Zk. Koshare me sip. 174 m².

- Deklaratë për falje e Nertil Zeka nga Ferizaj e fal ng.kad. 1094/6 Zk. Jezerc me sip. 20 m².
- Deklaratë për falje e Qamil Jonuzit e fal ng.kad. 191/1 Zk. Ferizaj me sip. 887 m² dhe ng.kad. 193/1 Zk. Ferizaj me sip. 344 m².
- Deklaratë për falje e Sabri Bislimit nga fsh. Muhoc e fal ng.kad. 1107/3 Zk. P.i Jerlive me sip. 26 m².
- Deklaratë për falje e Rexhep Azemit etj nga Ferizaj e falin ng.kad. 3201/0 Zk. Ferizaj me sip. 295 m².
- Deklaratë për falje e Milaim Nebihut nga Ferizaj e fal ng.kad. 2994/0 Zk. Ferizaj me sip. 170 m².
- Deklaratë për falje e Avdush Alija nga fsh. Bibaj e fal ng.kad. 535/0 Zk. Bibaj me sip. 670 m² dhe ng.kad. 754/0 Zk. Bibaj me sip. 670 m².
- Deklaratë për falje e Altin Kosumit nga Ferizaj e fal ng.kad. 3277/0 Zk. Ferizaj me sip. 423 m².
- Deklaratë për falje e Labeat Shumolli nga Ferizaj e fal ng.kad. 3298/0 Zk. Ferizaj me sip. 2167 m².
- Deklaratë për falje e Arben Hasanit nga Ferizaj e fal ng.kad. 3285/0 Zk. Ferizaj me sip. 158 m².
- Deklaratë për falje e Arben Hasani nga Ferizaj e fal ng.kad. 980/0 Zk. Ferizaj me sip. 687 m².
- Deklaratë për falje e Nderim Blenishtit nga Ferizaj e fal ng.kad. 3283/2 Zk. Ferizaj me sip. 44 m² dhe ng.kad. 3283/1 Zk. Ferizaj me sip. 198 m².
- Deklaratë për falje e Jetmir Grainces nga Ferizaj për faljen e ng.kad. 3082/2 Zk. Ferizaj me sip. 1138 m².
- Deklaratë për falje e Faton Tërstena nga Ferizaj e fal ng.kad. 969/0 Zk. Ferizaj me sip. 333 m².
- Deklaratë për falje e Adonis Sejdiut nga Ferizaj për faljen e ng.kad 3119/0 Zk. Ferizaj me sip. 68 m².
- Deklaratë për falje e Egzon Sadikut etj nga Ferizaj për faljen e ng.kad. 103/1 Zk. Ferizaj me sip. 100 m² ng.kad. 102/5 Zk. Ferizaj me sip. 101 m², ng.kad. 102/3 Zk. Ferizaj me sip. 100 m².
- Deklaratë për falje e Arlinda dhe Rron Avdullahu për faljen e ng.kad. 3274/0 Zk. Ferizaj me sip. 543 m².
- Deklaratë për falje e Misret Llabjani etj Ferizaj për faljen e ng.kad. 3236/0 Zk. Ferizaj me sip. 165 m².
- Deklaratë për falje e Kreshnik Islamit nga Ferizaj për faljen e ng.kad. 3310/0 Zk. Ferizaj me sip. 648 m².
- Deklaratë për falje e Hajriz Halilit nga Ferizaj për faljen e ng.kad. 3321/0 Zk. Ferizaj me sip. 104 m².
- Deklaratë për falje e Valmir kamerit nga fsh. Slivovë për faljen e ng.kad. 1907/136 Zk. Neredime e Eperme 14382 m².
- Deklaratë për falje e Shaban Rekaj nga Fshati i Vjetër për faljen e ng.kad. 500/300 Zk. Fshati i Vjetër me sip. 122 m² ng.kad. 500/32 Zk. Fshati i Vjetër me sip. 107 m² dhe ng.kad. 500/35 me sip. 286 m²
- Deklaratë për falje e Shkodran Mehmeti nga fsh. Dardani e fal ng.kad. 702/30 Zk. Dardani me sip. 522 m².
- Deklaratë për falje e Hevzi Azizit për faljen e ng.kad. 806/2 Zk. Dardani me sip. 610 m².
- Deklaratë për falje e Ramiz Jasharit për faljen e ng.kad. 565/14 Zk. Ferizaj me sip. 555 m².

- Deklaratë për falje e Ibush Aliu nga fsh. Nga Ferizaj e falë ng.kad. 3226/3 Zk. Ferizaj me sip. 256 m².
- Deklaratë për falje e Isuf Qeli etj nga Fshati Zaskok e fal ng.kad. 2110/16 Zk. Pleshinë me sip. 431 m², dhe ng.kad. 2110/18 Zk. Pleshinë me sip.62 m².
- Gjatë periudhës një vjeçare Janar- Dhjetor 2021 në Sektorin e Pronës vullnetarisht pronarët e paluajtshmerive në zonën urbane dhe rurale kanë falur prona tyre për rrugë me sipërfaqe totale prej 61267 m² ose (06.12.67 ha).

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 në Sektorin e Pronës janë ushtruar 125 kërkesa për Dhënien e pëlqimit për asfaltimin e rrugës pa kompenzim, shpronësim dhe këmbim. Po ashtu janë kryer po aq Deklarata-Pelqime nga pronaret e paluatshmerive.

Spektori i Pronës gjatë periudhës një vjetore Janar-Dhjetor (2021) ka kryer edhe këto punë:

- Përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj në cilësinë e përfaqësuesit juridik 35.
- Përgjigje në padi, me paditë e ushtruar në Gjykatë lidhur me shpronësime 6
- Ankesa e ushtruar Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj 3
- Punë në terren me komisionin për regjistrimin e pronave të paluajtshme të KK Ferizaj.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 1243/0, 1244/0, 1245/0 dhe 498/1 Zk. Fshati i Vjetër.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 547/1 Zk. Pleshinë.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 2981/34 Zk. Ferizaj.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 2665/0 Zk. Komogllavë.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 1140/2 dhe 3280/ 0 Zk. Ferizaj.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 253/2 dhe 217/2 Zk. Varosh.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 225/3, 225/8, 225/9 Zk. Bablak.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 694/1 Zk. Prelez i Jerlive.
- Punë në terren me Komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 1055/5 Zk. Prelez i Jerlive.
- Punë në terren me komisionin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 314/1, 314/2, 314/3.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Burim Bajrami
Drejtore i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në kuadër të aktivitetit të saj ka në përbërje katër njësi:

- Njësinë e Lavërtarisë,
- Njësinë e Blegtorisë,
- Njësinë e Zhvillimit Rural,
- Njësinë e Pylltarisë,

Të gjitha këto njësi kanë në kuadër të tyre staf të përgatitur profesional dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë konform rregullave dhe ligjeve të parapara në këtë sektor.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar politikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të punës së drejtorisë të hartuar për vitin 2021,
- Planit zhvillimor komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave në lëmi të ndryshme të fermerëve.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë vitit 2021 ka zhvilluar këto aktivitete:

1.Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me fidane të perimeve - Fermerët janë subvencionuar për fidane të perimeve, fermerët përfitues furnizimin me fidane të perimeve apo kultivimin e tyre e kanë bërë vetë, ndërsa kompenzimin e pagesës apo shpenzimeve e ka bërë Drejtoria e Bujqësisë, përfituesve u janë pranuar nga 4 fidane/m² me çmim deri 0.25€/fidan. **Përfitues kanë qenë 53 fermerë, me gjithsej 60,000 fidane të perimeve që kultivohen në sipërfaqe prej 15000m² serrë.**

2.Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë Projekti i ngritjes së serrave është realizuar me pjesëmarrje të fermerëve me 25% , ndërsa 75% e vlerës është subvencionuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Janë ngritur 237 serra me sipërfaqe 50m², dhe 11 serra me sipërfaqe 300m².

Në këtë subvencionim është përfshirë konstruksioni i serrës, folija, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes.

3. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra- Me këtë subvencionim janë ngritur 10 ha me pemishte të arrave, përfitues kanë qenë 20 fermerë me nga 0.50ha. Subvencionimi ka qenë në sigurimin e fidaneve dhe të sistemit të ujitjes për pemishtet që do të ngriten.

4. Përkrahja e fermerëve me mekanizim bujqësor

Me realizimin e këtij projekti janë përkrahur 171 fermerë me nga një pajisje bujqësore varësisht nga veprimtaria e tyre. Fermerët janë përkrahur me këto paisje:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Plugj dyrendësh	copë	18
2	Kosa roto 165 me kardan	copë	35
3	Freza 1.8 m me kardan	copë	63
4	Trinat 4 krahëshe	copë	10
5	Spërkatëse 500 litra	copë	13
6	Shpërndarëse të plehut 350 litra	copë	20
7	Grabuja diellore	copë	12
	Gjithsej	copë	171

5. Rregullimi i dhomave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve – Komuna e Ferizajt është Komuna e parë që ka realizuar një projekt të tillë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë. Me realizimin e këtij projekti janë siguruar - rregulluar 4 dhoma ftohëse me kapacitet prej 165 m², për katër fermerët më të mëdhenj që janë kultivues të pemëve dhe perimeve.

6. Organizimi i trajnimeve për fermerët në lëmi të ndryshme – Gjatë implementimit të këtij projekti janë organizuar trajnime në dhjetë lëmi të ndryshme, janë mbajtur trajnime teorike, praktike dhe vizita në terren. Pjesëmarrës në të gjitha këto trajnime kanë qenë rreth 300 fermerë varësisht nga veprimtaria e tyre. Është organizuar një takim gjithëpërfshirës me shumë akterë që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë me temën: Sfidat dhe perspektiva e zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Ferizajt.

7. Trajtimi i lopëve të qumështit kundër endoparazitëve- Parazitët paraqesin problem të vazhdueshëm në shëndetin e këtyre kafshëve duke u përcjellë me humbje të mëdha ekonomike. Mbrojtja apo parandalimi kundër parazitëve përmes trajtimit me medikamente përbën një rëndësi të veçantë për faktin se humbjet ekonomike të fermerëve do të jenë shumë më të vogla. Drejtoria e Bujqësisë e ka realizuar projektin për trajtimin e lopëve të qumështit në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kundër endoparazitëve. Janë trajtuar 3800 krerë lopë të qumështit.

8. Trajtimi i bagëtive të imëta (dele,dhi) kundër endoparazitëve- Drejtoria e Bujqësisë e ka realizuar projektin për trajtimin e bagëtive të imëta në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kundër endoparazitëve. Janë trajtuar 13000 krerë dele, dhi.

9.Vaksinimi i fondit blegtoral - Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektin për vaksinimin gjedheve, deleve dhe dhive kundër sëmundjeve clostridiale në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale. Janë vaksinuar 5124 krerë gjedhe dhe bagëti të imëta (dele dhe dhi) 18153 krerë. Arsyeja e realizimit të këtij projekti është bërë nga se ky vaksinim parandalon sëmundjet infektive duke bërë që humbjet ekonomike në fermat e fermerëve të jenë shumë më të ulëta, rritjes së kualitetit të prodhimit dhe shëndetit të mirë të kafshëve me këtë edhe të njeriut duke konsumuar prodhime të shëndosha të mishit dhe qumështit të këtyre kategorive të kafshëve të imëta.

10.Vaksinimi i qenve me pronarë - Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka bërë imunizimin apo vaksinimin e qenve me pronarë kundër sëmundjes së tërbimit. Tërbimi është një sëmundje e rrezikshme dhe ne si Komunë e kemi mbështetur projektin „Vaksinimin e qenve me pronarë”. Ne kemi shërbimin (Therrjet) ndërsa vaksinat i ka siguruar AVUK. Përfitues të këtij projekti janë të gjithë pronarët e qenve shtëpiak. Janë vaksinuar 2970 qenë me pronarë.

11.Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore- Sëmundjet e thundrrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtoriale ku vjen deri te rënia prodhimtarisë e njëherit edhe te humbjet ekonomike në ferma. Është bërë rregullimi i thundrrave tek 2392 krerë lopë qumështore.

12.Repelimi i gjedheve - (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) kundër sëmundjeve virale e parazitare nga insektet e ndryshme- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka realizuar projektin repelimi i gjedheve (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale të Komunës së Ferizajt. Kjo masë preventive nënkupton trajtimin e kafshëve përmes repelentëve adekuat me qëllim parandalimin e bartjes së sëmundjeve nga insektet në gjedhe si atyre virale e parazitare. Me repelim bëhet sidomos parandalimi i babeziosës si sëmundje parazitare mjaft problematike duke shkaktuar humbje të mëdha ekonomike tek fermerët sepse një numër i tyre përfundon me fatalitet. Janë repeluar 3800 krerë gjedhe.

13. Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave -Që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës me këtë mundësohet kontrolli i sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Me material gjenetik do të mbarësohen të gjitha lopët dhe mëshqerrat e komunës sonë. Ky projekt është implementuar dhe ka pasur kontratë në kohëzgjatje 24 muaj dhe janë mbarësuar 12933 krerë.

14. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavor- është projekt trevjeçar. Në vitin 2021 është arritur të rregullohen disa rrugë në fshatin Zllatar, një rrugë në fshatin Prelez i Muhaxherëve dhe rrugës që lidh fshatin Prelez i Jerlive me fshatin Prelez i Muhaxherëve , me përmirësimin e kushteve atmosferike do të vazhdohet me rregullimin e rrugëve tjera të arave.

15. Rregullimi i Tregut të Kafshëve dhe ndërtimi i strehimores për qen endacak- është projekt trevjeçar, punët janë duke vazhduar sipas dinamikës së planifikuar.

16. Projekti i trajtimit të qenve endacak- Në trajtimin e qenve endacak përfshihet kontrolli klinik, mjekimi, vaksinimi, kastrimi , sterilizimi dhe eutanazia sipas vlerësimit të ekspertëve. Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 880 krerë qenë endacak. Ky projekt vazhdon edhe në vitin 2021.

Për shkak të problemeve me nënshkrimin e kontratave në zyrën e prokurimit nuk janë realizuar në vitin 2021 këto projekte:

- Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore- pleh artificial,
- Përkrahja e fermerëve me pajisje - sistem kundër breshërit,
- Subvencionimi i fermerëve me koshere të bletëve,
- Furnizimi i fermerëve me lopë të racës Simental,
- Ndërtimi i silloseve (baseneve) të sillazhit

Këto projekte do t'i realizojmë gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2021, Komunën e Ferizajt e përfshiu një rrebesh shiu përcjellur me erëra shumë të forta duke shkaktuar dëme të mëdha në kulturat bujqësore dhe duke shkaktuar dëme të mëdha në fermat bujqësore. Drejtoria e Bujqësisë ka pranuar shumë kërkesa nga fermerët për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut dhe erërat shumë të forta, është formuar një komision nga ekspertët e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë të cilët kanë bërë vlerësimin e këtyre dëmeve.

- Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kryhet në zyret e Drejtorisë së Bujqësisë. Kjo fazë ka zgjatë mbi dy muaj, ishte një punë shumë voluminoze, këtë vit për shkak të pandemisë ishte shumë e vështirë dhe me rrezikshmëri, tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ishte i angazhuar në kryerjen e këtyre punëve:

- *Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- *Përcaktimi i termineve të fermerëve,
- *Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,
- *Regjistrimi në Regjistrin e Fermës,
- *Digjitalizimi i parcelave në ELPIS,
- *Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2021 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 960 fermerë për këto subvencione: lopë 2061 krerë, Viça për majmëri 780 krerë, dele 7144 krerë, dhi 569 krerë, pula 62000 copë, bletë 9090 zgjoje, grurë 2228 ha, grur kokërr 3262422 kg, misër 1375 ha, elbi 22ha, thekër 46 ha, molla 51 ha, mjedra 8.49ha, kumbulla 15 ha, patate 15 ha, kunguj 75 ha, qepë 8 ha, shalqinjë 1.27 ha, lakra 6 ha , aronia 4 ha, arra 61.5 ha, vishnje 2.5 ha, lajthia 35.5 ha, dredhëza 17.6 ha, fasule 18 ha, domate 0.1 ha, specia 0.5 ha, marulla 0.13ha, bujqësia organike 29.6 ha, perime në serra 2.06 ha.

- Subvencionimi i fermerëve për sasi dhe cilësi të qumështit nga MBPZHR që bëhet për çdo 6 muaj, aplikimi me të gjitha procedurat është bërë në Drejtorinë e Bujqësisë, ku është aplikuar për 6 mujorin e dytë 2021 në sasi 644362 l.

Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Pagesat e participimit të fermerëve gjatë realizimit të subvencioneve,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore,
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje,
- Jemi të kyçur në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Njësia e Pylltarisë

Njësia e Pylltarisë Ferizaj	Objektivi	Aktivitetet	Rezultatet
	1. Mbrojtja e Pyjeve	<i>Rojet e pyjeve kanë ngritur</i>	Fletëparaqitje Penale –14 lëndë me vëllim 62.95 m ³ në vlerë 8537.42 €
			Fletëparaqitje për Kundërvajtje-119 lëndë me vëllim 196.52 m ³ në vlerë 25995.61 €.
			Gjithsej fletëparaqitje: Fletëparaqitje-133 copë Vëllimi – 259.47 m ³ Vlera –34533.03 € Nga ana e Policisë së Ferizajt janë ngritur (8) tetë kallëzime penale me vëllim 42.86 m ³ .
		<i>Konfiskimi i masës drusore</i>	Dru zjarri- 111.20 m ³ .
			Dru teknik–10.89 m ³
			Sipas marrëveshjes për konfiskimin e druve në treg apo në rrugë pyjor me KRM “Pastërtia” dhe NSH “Fati” si dhe ndihmë familjeve skamnore janë dhënë 26.54 m ³ . Ndërsa drutë teknik me vëllim prej 7.85 m ³ janë shitur përmes ankandit.
		<i>Janë zhvilluar – Janë zhvilluar 75 kontrole dhe monitorime të pyjeve publike në rrugët pyjore dhe jopyjore. Nga Policia e Kosovës në Ferizaj, janë ndërmarrë 27 aksione në tregun e druve si dhe në rrugët pyjore.</i>	

		<i>Takimet e mbajtura-</i> Është mbajtur një takim me përfaqësuesen e Bankës Botërore, për mënyrën e shërbimit të procedurave për qytetarëve për pyje private si dhe funksionimi i mbrojtjes së pyjeve. Poashtu është bërë një vizitë në terren, në rajonin e Pleshinës me inspektorë dhe me aktivistë të organizatës “Çohu”, lidhur me dëmin pyjor në Pleshina 1. Ndërkaq më datë 22.11.2021 është mbajtur tryezë për procedurat ligjore në rastet e veprës penale. Gjithashtu më datë 9 e 10.12.2021 është mbajtur trajnim për krimin mjedisor si krim i organizuar sipas modeleve të organizuar. Tryeza dhe trajnimi është organizuar nga OSBE-ja, ku kanë marrë marrë pjesë ekspertë të kësaj fushe nga OSBE-ja, prokurorë, gjyqtarë, policë, përfaqësues të Ministrisë së Ambientit, të Agjencionit Pyjor, si përfaqësues të institucioneve lokale të Komunës së Ferizajt, Kaçanikut dhe Shtërpçës në fushën e pylltarisë.
		Gjatë kësaj periudhe janë shfaqë tri zjarre në pyjet shtetërore të Pleshinës, Gremes dhe Burtnikut. Sipërfaqja e përhapjes së zjarrit ka qenë 2.55 ha. Lloji i drurit ka qenë kryesisht dushqë. <i>Seancat gjyqësore-</i> Gjatë këtij gjashtëmujori janë mbajtur 180 seanca në Gjykatën Themelore –Divizioni Penal në Ferizaj. Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata Themelore-Divizioni Penal. Gjithsej- 162 aktgjykime. Pozitive-96, Të pezulluara-65 dhe negative-1. Aktvendimet e pranuar nga Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje. Gjithsej-357 aktvendime Pozitive-260, Të pezulluara-95 dhe negative -2. Gjatë këtij nëntëmuji 302 aktvendime të plotfuqishme kundërvajtëse janë dërguar tek zyrtari juridik për kompensim të dëmit pyjor. Poashtu edhe 126 aktgjykime të plotfuqishme penale janë dërguar tek zyrtari juridik për kompensimin e dëmit pyjor. Nga përmbaruesi privat janë ekzekutuar në tërësi 12 lëndë në vlerën prej 4,187.73 €.
	2. Masat Silvikulturore	<i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve publike, damkimit, realizimin etj.</i> Sipas ankandit Nr.01K/174 në ngastrën 101 në rajonin Pleshina 1, operatorit ekonomik NPT “Meti Comerc” sipas kontratës ka realizuar këtë masë drusore: dru teknik- 613.65 m³ dhe dru zjarri-2158.80 m³. Nga ankandi i ngastrës 101 janë inkasuar 45799.21 €. Nga dëmtimet si pasojë e faktorëve natyror (bora, erërat) te Parku i Lirisë është realizuar kjo masë drusore (pishë) me vëllim: 17.10 m³ dru teknik dhe 4.0 m³ dru zjarri. Në rajonin e Dremjakut është realizuar kjo masë drusore (pishë) me vëllim: 1.79 m³ dru teknik dhe 0.31 m³ dru zjarri. Në rajonin Lumi i Vogël- ngastra 50 është realizuar kjo masë drusore (pishë) me vëllim: 27.70 m³ dru teknik dhe 4.52 m³ dru zjarri. Poashtu është realizuar edhe shitje me pakicë për banorët e zonave rurale për furnizim të ekonomive familjare: Ngastra 99 – janë realizuar 31.65 m³ dru zjarri.

		Ngastra 104-janë realizuar 31.65 m³ dru zjarri. Ngastra 53-janë realizuar 126.92 m³ dru zjarri. Nga shitblerja e pishave të thyera dhe shitjes së druve me pakicë janë inkasuar – 5308.19 €.
		<i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve private-</i> Gjatë këtij viti nga pronarët e pyjeve private kemi pranuar 30 kërkesa, të cilat nga APK-ja janë shqyrtuar 24 prej tyre. Poashtu nga pronarët e tokave (bujqësore, livadhe, oborr etj) kemi pranuar 7 kërkesa. Nga APK-ja është bërë damkimi i trungjeve me vëllim prej: dru teknik -9.91 m³, ndërsa dru zjarri 552.97 m³. Janë lëshuar 23 leje për prerje me vëllim: dru teknik-9.91 m³ dhe dru zjarri 723.51 m³. Janë vulosur dru zjarri-517.82 m³ dhe dru teknik-4.48 m³. Janë lëshuar 149 fletëpërcjellëse me vëllim prej 406.23 m³. Nga shërbimet për pyje private janë inkasuar- 1323.36 €.
	3. Aktivitetet tjera	<i>Angazhimet në komisione të ndryshme-</i>Kanë qenë këto komisione: Një komision ka qenë për dorëzimin e ngastrës 101 operatorit ekonomik, një komision ka qenë për regjistrim të jashtëzakonshëm në livadhe të Papazit, 7 komisione kanë qenë për verifikimin e masës drusore në prona private (tokë bujqësore, oborr etj), 8 komisione kanë qenë për verifikim të druve të kërkesave të vitit 2020 për pyje private. Poashtu kanë qenë 6 komisione për regjistrimin e dëmeve pyjore



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Arben Halili

Drejtore i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

HYRJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ka Sektorin e Shërbimeve Publike dhe Sektorin e Emergjencave.

Sektori i Shërbimeve Publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavor, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj, çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fundvitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2021 janë pranuar 1642 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluar	Kërkesa në proces, pezulluar
1642	1328	269	45

1. SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.

- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qellim të kontraktuara janë 2 operatorë ekonomik privat.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike. Vlen të përmenden reshjet e shiut, të përcjellura me stuhi ere në muajin Janar, ku pati dëme të konsideruara duke përfshirë dëme në ekonomitë familjare, biznese të ndryshme, si dhe dëme në sektorin e bujqësisë.
- Vendet që më së shumti pësuan dëme si pasojë e reshjeve të dendura të shiut janë: Fshatrat Tërrn, Sazli, Gërllicë, Koshare, Neredime, Pleshinë, Mirash, Talinoc i Muhaxherëve, Fshati i Vjetër, Rakaj, Nikadin, si dhe bizneset me lokacione magjistralja Prishtinë – Shkup dhe Ferizaj (Qytet). Si rezultat i reshjeve të shiut dhe vërshimeve në muajin Janar, kërkesa zyrtare për të dalë në terren ishin gjithsej 27, 23 kërkesa për ekonomi familjare, dhe 4 kërkesa për biznese afariste. Sipas vlerësimeve të dëmeve që janë shkaktuar si pasojë e reshjeve të shiut arrijnë shifrën rreth 125,035.59€, si dhe dëme në sektorin e bujqësisë për të cilën kanë përgatitur raport të veçantë Drejtoria e Bujqësisë (vlera e dëmeve në sektorin e bujqësisë 58,325€), gjithsej shuma totale e dëmeve është: 183,360.59€

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë, pas pranimi të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar këto raste:

- Rast zjarri në shtëpinë e Bashkim Ugzmajli – Ferizaj
 - Rast zjarri në stallën e Mehmet Murseli – fshati Rakaj
 - Rast zjarri në stallën e Zahir Topalli – fshati Zllatarë
 - Rast zjarri në shtëpinë e Xhavit Kashtanjeva – fshati Neredime e Epërme
 - Rast zjarri në shtëpinë e Imer Trshani – fshati Koshare
 - Rast zjarri në shtëpinë e Shefije Sahiti – fshati Papaz
 - Rast zjarri në shtëpinë e Leonora Hasani – Ferizaj
-
- Gjatë vitit 2021 janë mbjellur 42.488 copë lule verore dhe vjeshtore si dhe 2258 copë të drunjve dekorativ dhe fidanëve në hapësirat e gjelbëruara të qytetit përmes kompanisë publike NPL-AMBIENTI.
 - Është bërë rregullimi i ulëseve dhe shportave të mbeturinave nga kompania publike NPL-AMBIENTI.
 - Është bërë krasitja e drunjve dekorativ në sheshin e qytetit në mënyrë profesionale, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara si parqet, sheshet, lapidarët, varrezat e Dëshmorëve.
 - Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
 - Identifikimi i 48 deponive ilegale me materiale të ngurta dhe urbane në qytet dhe fshatra në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman si dhe eliminimi i tyre nga ana e kompanive publike K.R.M.,Pastërtia’’ dhe NPL,,Ambienti’.
 - Poashtu edhe gjatë vitit 2021 kemi vazhduar me pastrimin e varrezave të qytetit të të gjitha komuniteteve fetare si ato myslimane, katolike dhe ortodokse.
 - Mirëmbajtja e aparateve ultrasonike kundër shpezëve.
 - Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK-së dhe GIZ-i gjerman për menaxhimin e mbeturinave si dhe trajnimeve për kanalizime dhe ujësjellës.
 - Mbajtja e punëtorive me AME-në për menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

- Pajisja e Shërbimit të Zjarrfikjes me pompa të ujit, fshesa metalike, motor sharra, lopata për thyerjen e akullit, gjenerator, çekan të ndryshëm, set për vatër zjarri\çantë dhe mjete tjera të punës, si dhe furnizimi me veshmbathje.
- Ndërtimi i konstruksioneve për vendosjen e 13 hidrantëve me qëllim lehtësimin e furnizimit me ujë për nevojat e zjarrfikësve dhe kompanive publike është bërë në këto lokacione – fshatrat si: Balaj, Komogllavë, Prelez i Muhaxherëve, Muhoc, Varosh, Pleshinë, Greme, Softaj, Mirash, Slivovë, Gaçkë, si dhe te Parku “Iliria” në Ferizaj.

1.1 Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 12.858m gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve si dhe janë vendosur 59 m gjatësi të tubave dhe janë eliminuar 155 m-3 të shkurreve dhe drunjve 80 orë pune e punëtorëve fizik në pastrim të lumenjve nga mbeturinat e ndryshme.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Komogllavë, Prelez i Jerlive, Prelez i Muhaxherëve, Koshare, te Ura e Dudit Ferizaj, Zaskok, Bifurkacioni, Sazli, Fshati i Vjetër, Varosh dhe do të vazhdohet edhe në fshatrat tjerë.

1.2 Largimi i deponive ilegale, masat parandaluese dhe investimet në ndërmarrje publike

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastër, si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve.

- Kompania KRM,,Pastërtia’’ dhe kompania NPL,,Ambienti’’ ka eliminuar 2776 m³ mbeturina me materiale inerte dhe ato urbane.
- Gjatë vitit 2021, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar projekte të rëndësishme duke ndihmuar Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 50 kontejnerë mbitokësor 1.1 m³ dhe 750 kontejnerë shtëpiak 120 litërsh e të cilat janë shpërndarë në qytet dhe fshatra duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- Poashtu gjatë këtij viti është bërë edhe mirëmbajtja e kontejnerëve nëntokësor të vendosur në qytet me ç’rast është bërë mirëmbajtja dhe ndërimi i pjesëve apo elementeve të dëmtuara të kontejnerëve nëntokësorë si kapakët e shtyllave për hedhjen e mbeturinave, shtyllat për hedhjen e mbeturinave, platformat mbyllëse, rezervarët për

hedhjen e mbeturinave, rregullimi i kubëzave mbi platforma si dhe në dy lokacione në bashkëpunim me Operatorin ekonomik dhe K.R.M “Pastërtia” kontejnerët nëntokësor i kemi larguar tërësisht.

2. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2021, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor.

Gjatë vitit 2021 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për deblokime në bashkëpunim me kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë deblokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e tubave, dhe kyçje të reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

2.1 Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2021 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuara kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimeve fekale dhe atmosferike në zonat urbane dhe rurale të Komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 12,061.5 metra gjatësi.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 2422 metra gjatësi.

2.2 Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavor, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar, mbi 8824 metra katror të trotuareve me kubëza si dhe 41,284 metra katror të rrugëve me zhavor.

2.3 Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika

Në bazë të nevojave të paraqitura nga institucionet e ndryshme është punuar edhe në mirëmbajtjen dhe vendosjen e konstruksioneve metalike, rrethojave të oborreve të shkollave, rrjetave të fushave sportive, shportave të mbeturinave, ulëseve dhe në riparimin e mureve të objekteve institucionale etj. Këto punë janë kryer kryesisht në objekte arsimore –shkolla, fusha sportive, parqe, ura e objekte tjera komunale.

2.4 Njësia e ndriçimit publik

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar puna e vazhdueshme në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues si dhe është punuar intensivisht në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në rrugët dhe hapësirat ku nuk ka pasur ndriçim publik më parë.

Gjatë vitit 2021 në teritorin e Komunës së Ferizajt, janë vendosur gjithsej 2946 trupa ndriçues LED, me fuqi të ndryshme të ndriçimit si në vijim:

Trupa ndriçues LED 50V: 2314 copë

Trupa ndriçues LED 84V: 8 copë

Trupa ndriçues LED 100V: 537 copë

Trupa ndriçues LED 150V: 55 copë

Reflektorë LED 100V: 32 copë

Shtylla metalike: 546 copë

Shprehur në vijë gjatësore gjatë vitit 2021 janë realizuar 103 Km ndriçim publik.

Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2021 kemi bërë dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit duke i vendosur dritat dekorative, bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, në sheshin para objektit të Komunës dhe në sheshin “Hyrë Emini”.

2.5 Njësia e trafikut dhe transportit rrugor

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

2.5.1. Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është në një nivel të kënaqshëm, ku nga dyzet e pesë fshatra sa ka territori i Komunës së Ferizajt, dyzet e dy prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin publik të udhëtarëve dhe vazhdimisht inspektohet nga inspektori i transportit, gjithashtu gjatë këtij viti kemi bërë inspektime të rregullta të transportit të udhëtarëve auto-taksi.

Në kuadër të kësaj pike konkretisht në transportin publik të udhëtarëve kemi bërë edhe përmirësimin e infrastrukturës publike, ku në segmentin e rrugës Ferizaj – fshati Gaçkë janë rregulluar vend-ndaljet e autobusëve dhe kabinat për pritje të udhëtarëve si dhe në rrugën “Brahim Ademi”, “Ismet Ramadani” dhe në rrugën “Naim Beka”, pikërisht në fshatin Zaskok janë vendosur kabinat për pritje të udhëtarëve.

2.5.2 Trafiku rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik dhe ngritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Së bashku me njësinë e trafikut të Policisë kemi analizuar disa rrugë të qytetit dhe kemi dhënë disa ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt dhe ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më cilësore për qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve motorike.

Konkretisht po potencojmë ndërhyrjen në trotuare për rregullimin e pjerrinave për qasje më të lehtë të personave me aftësi të kufizuara në infrastrukturën publike, rregullimi i rreth-rrotullimit me shenja vertikale dhe horizontale në kryqëzimin e rrugëve “12 Qershori”, “Madeline Albright” dhe “Ramadan Rexhepi”, ku me këtë ndërhyrje është lehtësuar qarkullimi i mjeteve në trafik, është ngritur i niveli i shërbimit në kryqëzim duke e rritur edhe sigurinë në trafik për të gjithë pjesëmarrësit.

Gjithashtu në disa rrugë të qytetit kemi bërë ndryshime në rregullimin teknik të komunikacionit, konkretisht rrugën urbane “Njazi Bajraktari” dhe rrugën urbane “Bekim Osmani” kemi bërë ndryshime në qarkullimin në trafik, pikërisht në këto rrugë trafiku do të zhvillohet në një drejtim.

Me këto ndryshime jemi të mendimit se është krijuar një ambient më i sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor, meqenëse rrugët janë shumë të ngushta dhe nuk kanë plotësuar kriteret për zhvillimin normal të trafikut në dy drejtime, gjithashtu vlen të potencohet se në rrugën urbane “Njazi Bajraktari” mungojnë edhe trotualet për lëvizjen e këmbësorëve, kurse rruga urbane “Bekim Osmani” ka pjesërisht të rregulluar trotuarin.

2.5.3 Mirëmbajtja e rrugëve me shenja të trafikut

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto projekte në sinjalizimin e rrugëve me shenja ndriçuese, shenja horizontale dhe shenja vertikale trafikut, me qëllim të përmirësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

2.5.4 Shenjat ndriçuese të trafikut:

- Në rrugën urbane “Ramadan Rexhepi”, pikërisht në dy vendkalime të këmbësoreve janë vendosur panelet për ndriçimin e vendkalimit për këmbësorë.
- Në rrugën urbane “Vëllezërit Gërvalla”, pikërisht në dy vendkalime të këmbësoreve janë vendosur panelet për ndriçimin e vendkalimit për këmbësorë.
- Në rrugën urbane “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, pikërisht në dy vendkalime të këmbësoreve janë vendosur panelet për ndriçimin e vendkalimit për këmbësorë.
- Në rrugën “Reçaku”, pikërisht përball qendrës tregtare “Village” është vendosur një panel për ndriçimin e vendkalimit të shënuar për këmbësorë.

2.5.5 Shenjat vertikale të komunikacionit :

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

Rrugët në të cilat është intervenuar me shenja vertikale të trafikut:

- Rruga urbane “Uilliam Uoker”, kemi vendosur disa shenja vertikale të trafikut.
- Në rrugën urbane “Naim Beka”,
- Në rrugën urbane “Epopeja e Jezercit”,
- Në rrugën urbane “Tahir Sinani”,
- Në rrugën urbane “Beteja e Kaçanikut”, “Halim Spahija” dhe “Sander Prosi”.
- Në kryqëzimin e rrugës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” me rrugën “Fehmi Agani”, në rrugët “Ilir Konushevci”, “Qamil Ilazi”, “Shën Nënë Tereza”, “Fan Noli” dhe “At Nikë,
- Në rrugën urbane “Faik Konica” dhe kryqëzimin e rrugës “Qiraxhiu” me rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani”,
- Në rrugën urbane “Besnik Osmani”,
- Në kryqëzimin me rreth – rrotullim te kafiteria “Cosmo”.
- Në rrugën urbane “Uran Tinova”,
- Në rrugët urbane “Medeline Albright”, “Naim Beka”, “Ramadan Rexhepi”, “Ahmet Kaçiku”, “Dëshmorët e Kombit” dhe te Gorenja afër rrethit të madh Bashkimi i Qytetit,
- Në Rrugët e fshatit Sazli, Pojatë, Softaj, Rahovicë, Mirash, Cërnill, Surqinë, Balaj,

- Në fshatin Zaskok,
- Në fshatin Greme, Gaçkë, rrugën “Vezir Jashari”, rrugën “Luigj Gurakuqi”, rrugën “Gucia” rrugën “Zenun Beqa” dhe “Gursel dhe Bajram Sylejmani”,
- Në kryqëzimin e rrugëve anësore të cilat lidhin rrugën “Vëllezërit Gërvalla” me rrugën urbane “Emin Duraku”, janë ri-montuar disa shenja vertikale.

2.5.6 Shenjat horizontale të komunikacionit.

Në kuadër të shënimit të rrugëve me sinjalizim horizontal në rrugët e qytetit dhe fshatrave janë kryer këto punë

1. Rruga “Enver Topalli” dhe rruga “Shaban Viça” – konkretisht segmenti rrugor nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën “12 Qershori” deri te kryqëzimi me rrugën e fshatit Zaskok (fshati Doganaj te Shkolla).
 - Vija e aksit (plotë + ndërprerë) .
 - Vendkalimet e këmbësorëve
 - Vija e STOP
2. Fshati Zaskok – konkretisht segmenti rrugor nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën “Shaban Viça” deri te kryqëzimi me rrugën “Naim Beka” duke përfshirë edhe rrugën “Rilindja Kombëtare”.
 - Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
 - Vendkalimet e këmbësorëve
3. Rruga “Naim Beka” dhe rruga “Ismet Ramadani” – konkretisht segmenti rrugor nga rreth-rrotullimi (Bashkimi i Qytetit) deri te Shkolla Filllore në fshatin Pleshin e Epërme.
 - Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
4. Fshati Mirash – rrugët kryesore të fshatit.
 - Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
 - Vendkalimet e këmbësorëve
 - Vija e STOP
5. Rruga urbane “12 Qershori”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Agim Matoshi” deri te kryqëzimi me rrugën urbane “Madeleine Albright”.
 - Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
 - Vendkalimet e këmbësorëve
 - Vija e STOP

6. Rruga urbane “Madeleine Albright”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Dëshmorët e Kombit” me rreth-rrotullim deri te kryqëzimi me rrugën urbane “12 Qershori”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Vija e STOP

7. Rruga urbane “Agim Matoshi”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Dëshmorët e Kombit” deri te kryqëzimi me rrugën urbane “Ahmet Kaçiku”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Vija e STOP
- Shigjeta (një degësh + dy degësh)

8. Rruga urbane “Hamzë Jashari”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Dëshmorët e Kombit” deri te hyrja e projektit “Bashkimi i Qytetit” .

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Vija e STOP

9. Rruga urbane “Rexhep Bislimi”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Ahmet Kaçiku” deri te kryqëzimi me rrugën urbane “Shën Nënë Tereza”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Vija e STOP
- Shënimi i ishujve

10. Nënkalimi “Bashkimi i Qytetit”

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Shënimi i ishujve ndarës
- Shigjetat orientuese
- Shënimi logove BUS

11. Rreth-rrotullimi në kryqëzimin e rrugëve urbane “Ramadan Rexhepi”, “Uran Tinova” dhe “Ismet Ramadani”, konkretisht te ish shtëpia e pensionistëve.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Shënimi i ishujve ndarës
- Shigjetat orientuese

- Shënimi logove BUS
- Shënimi i logove TAXI

12. Fshati Gaçkë – konkretisht në afërsi të Shkollës Filllore “Imri Halili”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vija e parkingut e plotë
- Shënimi logove BUS

13. Rruga urbane “Besim Rexhepi”, konkretisht në kryqëzim me rrugën “Agim Matoshi”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve

14. Rruga urbane “Zenel Hajdini”, konkretisht në kryqëzim me rrugën “12 Qershori”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve

15. Rruga urbane “Sejdi Sejdiu”, konkretisht në kryqëzim me rrugën “12 Qershori”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve

16. Rruga urbane “Uilliam Ualker”, konkretisht në kryqëzim me rrugën “12 Qershori” dhe “Dëshmorët e Kombit”.

- Vendkalimet e këmbësorëve

17. Në rrugën e “Reçakut”, konkretisht brenda autoparkut të Stacionit Policor Ferizaj.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vija e parkingut e plotë
- Shënimi i ishujve ndarës
- Shigjetat orientuese
- Logo e parkingut për persona me aftësi të kufizuara
- Një vend-ndalje për autobus.

18. Rruga urbane “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, konkretisht segmenti nga kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën urbane “Rexhep Bislimi” deri te kryqëzimi me rrugën urbane “Qiraxhiu”.

- Vija e aksit (plotë + ndërprerë)
- Vendkalimet e këmbësorëve
- Vija e STOP
- Shigjetat orientuese

19. Rruga “Brahim Ademi” është bërë shënimi i shtegut të biçikletave në tërë gjatësinë e rrugës, konkretisht është ngjyrosur e tërë sipërfaqja e shtegut, janë shënuar vijat kufizuese të shtegut, shigjetat e orientimit dhe logot e biçikletave, gjithashtu janë shënuar edhe vendkalimet e këmbësorëve dhe biçikletave.

20. Rruga urbane “Ramadan Rexhepi”, nga rreh-rrotullimi te Teatri deri te rreth-rrotullimi i “Bashkimi i Qytetit”.

- Vija gjatësore e aksit dhe vijat anësore.
- Vijat e STOP-it
- Vijat e parkingut,
- Vendkalimet e këmbësorëve,
- Ishujt e ndryshëm për orientim.

21. Rruga urbane “Driton Islami”.

- Vija gjatësore e aksit.
- Vijat e STOP-it
- Vendkalimet e këmbësorëve dhe
- Ishujt e ndryshëm për orientim.

22. Rruga urbane “Sali Çeku” dhe për rreth Stacionit Policor.

- Vija gjatësore e aksit dhe vijat anësore.
- Vijat e STOP-it
- Vendkalimet e këmbësorëve,
- Ishujt e ndryshëm për orientim.

2.5.7 Shtyllat anti - parking

Në kuadër të këtij pozicioni janë vendosur shtylla anti - parking sistem në këto rrugë:

1. Në rrugën urbane “Rexhep Bislimi”, konkretisht në afërsi të institucioneve arsimore janë vendosur 152 copa shtylla anti – parking.
2. Në rrugën urbane “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, konkretisht ana e djathtë ka hekurudha shikuar në drejtim të fshatit Varosh janë vendosur 252 copa shtylla anti – parking.
3. Në rrugën urbane “Hasan Prishtina”, konkretisht në afërsi të shollës “Astrit Bytyçi” janë vendosur 38 copa shtylla anti – parking.
4. Në rrugën urbane “Remzi Hoxha”, konkretisht në afërsi QKMF 3 dhe në kryqëzimin e kësaj rruge me rrugën “Rexhep Bislimi” janë vendosur 72 copa shtylla anti – parking.
5. Në rrugën urbane “Ramadan Rexhepi”, te “Emërgjenca” janë vendosur 20 copa shtylla anti – parking.

6. Në rrugën urbane “Ramadan Rexhepi”, në oborrin e Emergjencës janë vendosur 19 copa shtylla anti – parking.

2.5.8 Monitorët dinamik digjital

Në kuadër të këtij projekti kemi bërë vendosjen e monitorëve digjital në rrugët më të frekuentuara të qytetit, ku me anë të këtyre ekraneve digjitale do të shfaqen mbishkrime të ndryshme e në veçanti ato mbishkrime me mesazhe që kanë për qëllim vetëdijesimin në ngritjen e sigurisë në komunikacion.

2.5.9 Pengesat rrugore për qetësimin e komunikacionit

Në kuadër të kësaj fushe kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore për qetësimin e komunikacionit në disa rrugë urbane të qytetit, ku prioritet i kemi dhënë rrugëve në afërsi të shkollave si dhe në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të fëmijëve duke analizuar edhe infrastrukturën përcjellëse (mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për ecje).

2.5.10 Kamerat e sigurisë

Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë vazhdimisht bënë mbikëqyrjen dhe instalimin e kamerave të sigurisë për nevojat e Stacionit Policor në Ferizaj. Këtë vit kemi bërë vendosjen e dhjetë kamerave të reja të sigurisë si dhe mirëmbajtën e njëqind e njëzet e tetë kamerave ekzistuese.

3.NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2021 Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit ka pasur **gjithsej 986 dalje** të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë paraqitura në pjesën e dytë të raportit pjesa grafike e intervenimeve.

Si sfida më të mëdha përpos intervenimeve të ndryshme që kemi marrë pjesë nga më të ndryshmet shërbimi ynë sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdrejt në punën tonë ka qenë **numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional**, që as përsëafërmi nuk i plotësojmë kriteret numerikisht për një shërbim me standarde të parapara me Ligjin Nr. 04/-L-049 dhe Rregulloren NR 16/2012 për numër të banorëve në Komunën tonë.

Po ashtu çështje me prioritet në zhvillim dhe ndikim në Shërbimin zjarrfikës është aktivizimi i njësisë varëse zjarrfikese në Rr. “Enver Topalli” ku objekti ri ka përfunduar me vite por vetëm duhet plotësuar me inventar shtesë, automjete dhe pranimin e punëtorëve zjarrfikës.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenime tjera Janar-Dhjetor 2021							
NJPZSH - FERIZAJ							
Daljet e përgjithshme	Numri i zjarreve	Intervenime teknike	Aksidente rrugore	Vërshime	Shërbime	Bombola gazi	Gjendje mobile
986	814	93	19	28	25	5	2

STRUKTURA E ZJARREVE DHE KLASIFIKIMI I TYRE GJATË

2021

NJPZSH - FERIZAJ

Zjarre në objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura fushore - malore	Zjarre në automjete	Zjarre në pajisje elektrike	Zjarre mbeturinash	Zjarre në oxhaqe	Zjarre në ushqime kafshëve	Alarme të rrejshme	Objekte tjera	Gjithsej
42	385	35	136	141	31	3	20	21	814

